|                                                                                                            |       |          |            |           |                             |  | 1316 | BRUNILDA |         | MUÇAJ   |     |        |        |      |            |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|                                                                                                            |       |          |            |           |                             |  | 1317 | EDMOND   |         | MUÇAJ   |     |        |        |      |            |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|                                                                                                            |       |          |            |           |                             |  | 1318 | FATMIR   |         | MUÇAJ   |     |        |        |      |            |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|                                                                                                            |       |          |            |           |                             |  | 1319 | NENKA    |         | XHEMALI |     |        |        |      |            |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|                                                                                                            |       |          |            |           |                             |  | 1320 | QAMIL    |         | MUÇAJ   |     |        |        |      |            |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|                                                                                                            |       |          |            |           |                             |  | 1321 | SAJMIR   |         | MULLAJ  |     |        |        |      |            |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|                                                                                                            |       |          |            |           |                             |  | 1322 | SELAME   |         | MULLAJ  |     |        |        |      |            |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <b>FIER</b>                                                                                                |       |          |            |           |                             |  |      |          |         |         |     |        |        |      |            |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <b>ZONA KADASTRALE 3230 FSHATI RRETH LIBOSHE, NJESIA ADMINISTRATIVE LIBOFSHE, BASHKIA FIER, QARKU FIER</b> |       |          |            |           |                             |  |      |          |         |         |     |        |        |      |            |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| GORI                                                                                                       | MIHAL | MISHTAKU | Nr. 237307 | 28.4.2015 |                             |  | 1323 | ZOICA    | VASIL   | GJERGJI | 188 | 1292   | 338.00 | 269  | 90,922.00  |  | ME VKM NR.279 DT.01.04.2015, KONFIRMIMI VJEN PA CF.P ME REFERENCE AKT 7879 TE PROG, DIG.TE PP LUAJTSHME                                                                                                                                                                        |
| <b>ZONAT E STIMULUARA</b>                                                                                  |       |          |            |           |                             |  |      |          |         |         |     |        |        |      |            |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <b>QARKU KAVAJË,GOLEM, ZONA KADASTRALE 1791</b>                                                            |       |          |            |           |                             |  |      |          |         |         |     |        |        |      |            |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| ALFRED                                                                                                     | JANI  | VASIL    |            |           |                             |  | 1324 | MUHAMED  | OSMAN   | LUGA    | 189 | 136/37 | 89.1   | 1970 | 175,527.00 |  | Kontratë sipërmarrie ndërmjet Arjan Merkja dhe firma "Emble Konstruktion" SHPK, Sipërfaqe e ndërtimit për porositësin 23%.                                                                                                                                                     |
| AURORA                                                                                                     | JANI  | ROZANI   | 704709     | 13.4.2019 | Tokë të vet/tokë të tretëve |  | 1325 | ARJAN    | MUSTAFA | MERKJA  | 190 | 136/46 | 70.9   | 1970 | 139,673.00 |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                |

**VENDIM****Nr. 849, datë 24.12.2019**

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË  
AFATMESME TË MENAXHIMIT TË  
BORXHIT, 2020–2022**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit, 2020–2022, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR****Edi Rama**

**STRATEGJIA AFATMESME E  
MENAXHIMIT TË BORXHIT**

**2020–2022****Dhjetor 2019****PËRMBAJTJA****PËRMBLEDHJE****MENAXHIMI I BORXHIT**

**I. SITUATA AKTUALE E BORXHIT TË  
QEVERISJES QENDRORE**

1. Ecuria e borxhit të qeverisjes qendrore
2. Realizimi i huamarrjes
  - 2.1 Huamarrja e brendshme
  - 2.2 Huamarrja e huaj
3. Portofoli i borxhit shtetëror
4. Portofoli i borxhit të garantuar
5. Menaxhimi i kostove dhe risqeve
  - 5.1 Kostot
  - 5.2 Risqet
6. Zhvillimet e tregut primar të titujve shtetërorë
  - 6.1 Ecuria e ankandëve dhe kërkesa për titujt shtetërorë
  - 6.2 Ecuria e normave të interesit

**II. STRATEGJIA E MENAXHIMIT TË  
BORXHIT**

**1. Supozimet bazë**

1.1 Zhvillimet aktuale dhe pritshmëritë në sektorin real, sektorin e jashtëm, atë financiar dhe sektorin fiskal

1.2 Vlerësime referuar borxhit ekzistues, tregjeve të instrumenteve financiare dhe faktorëve makroekonomikë

**1.3 Burimet e financimit****1.3.1 Burimet e brendshme****1.3.2 Burimet e huaja****2. Strategjia afatmesme****2.1 Menaxhimi/kontrolli i kostove dhe risqeve****2.1.1 Kostot****2.1.2 Menaxhimi i risqeve****2.2 Zhvillimi i tregut të titujve shtetërorë****2.2.1 Rritja e likuiditetit****2.2.2 Rritja e eficiencës****2.2.3 Rritja e transparencës****2.3 Menaxhimi i borxhit shtetëror të garantuar**

2.3.1 Kriteret bazë për emetimin e garancive shtetërore

**2.3.2 Niveli i garancive shtetërore**

2.4 Pritjet e treguesve bazë dhe analiza e ndjeshmërisë

**2.4.1 Niveli i borxhit të qeverisjes qendrore****2.4.2 Shërbimi i borxhit shtetëror****2.4.3 Analiza e ndjeshmërisë**

ANEKS I. Analiza e strategjive alternative të financimit

ANEKS II. Akronime dhe fjalor teknik

ANEKS III. Informacione shtesë

**PËRMBLEDHJE****Objektivat dhe qëllimi**

Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit (SAMB) është një plan afatmesëm, të cilin Ministria e Financave dhe Ekonomisë synon ta zbatojë duke pasur si objektiva parësorë:

- plotësimin e nevojave të qeverisë për financim, si edhe nevojave për të shërbyer borxhin aktual me kosto sa më të ulët dhe duke mbajtur nivele të pranueshme të ekspozimit ndaj risqeve;

- përmirësimin dhe ruajtjen e eficiencës së tregut primar, mbështetur nga zhvillimi i mëtejshëm i tregut sekondar të titujve shtetërorë vendës.

Në funksion të realizimit të objektivave të sipërpërmendur dhe në përputhje me bazën ligjore





në fuqi<sup>1</sup>, Ministria e Financave dhe Ekonomisë përgatit dhe përditëson, në bazë vjetore, dokumentin e SAMB-së, duke parashtruar planet e financimit me borxh dhe aktivitetet që do të ndërmerren në periudhën afatmesme.

SAMB-ja hartohet dhe përditësohet në linjë me ligjin vjetor të buxhetit, kuadrin makroekonomik dhe fiskal të qeverisë, si edhe me politikat monetare që Banka e Shqipërisë planifikon të zbatojë në periudhën afatmesme 2020–2022.

Qëllimi i SAMB-së është:

- të menaxhojë me efikasitet portofolin e borxhit të qeverisjes qendrore, në të cilin përfshihet borxhi shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas;
- të rrisë transparencën ndaj investitorëve dhe palëve të interesuara, në lidhje me planet e huamarrjes së qeverisë; si edhe
- të qartësojë dhe të kuantifikojë objektivat në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme.

#### Perspektiva afatmesme

Pavarësisht progresit në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj risqeve gjatë viteve të fundit, SAMB-ja 2020–2022, ashtu si edhe strategjia paraardhëse, do të vijojë të ketë në fokus reduktimin e mëtejshëm të riskut të rifinancimit dhe atij të normave të interesit të borxhit të brendshëm. Në këtë drejtim, prioritet do të mbetet zgjatja e jetëgjatësisë së borxhit nëpërmjet uljes së mëtejshme të përqendrimit të titujve afatshkurtër në portofol.

Niveli i financimit të brendshëm do të synohet të mbahet i qëndrueshëm, duke mos tejkaluar kapacitetet optimale të tregut. Nëpërmjet titujve afatshkurtër, kryesisht, do të synohet rifinancimi i titujve ekzistues që maturohen, menaxhimi aktiv i nevojave për likuiditet, si edhe përmirësimi profilit vjetor të maturimeve. Ndërkohë, nëpërmjet titujve afatgjatë do të synohet të mbulohet financimi i deficitit.

Në periudhën afatmesme, huamarrja e huaj planifikohet të mbulojë mesatarisht deri në 20% të nevojave të përgjithshme për hua të qeverisë dhe do të mbështetet, kryesisht, në: i. huat me terma pjesërisht të butë, të cilët do të financojnë projektet ekzistuese dhe projektet e reja të konsideruara si prioritare nga qeveria për zhvillimin e vendit; ii.

huat me terma të butë të akorduar nga institucionet ndërkombëtare financiare për të mbështetur politikat zhvillimore dhe reformat e ndërmarra nga qeveria; si edhe iii. instrumentet financiare të tregjeve të kapitalit mbi baza oportuniste, kryesisht për të mundësuar menaxhimin e detyrimeve të borxhit në valutë dhe për të optimizuar risqet e portofolit.

Zhvillimi i mëtejshëm i tregut primar vendës dhe hedhja e hapave për zhvillimin e tregut sekondar të titujve shtetërorë është një tjetër objektiv parësor i strategjisë afatmesme. Realizimi i suksesshëm i këtij objekti do të pasohej me kosto dhe risqe më të ulëta për të gjithë aktorët e tregut, duke përfshirë qeverinë, si edhe investitorët e titujve shtetërorë.

Procesi gjatë të cilit do të synohet të përmbushet ky objektiv do të shtrihet në periudhën afatmesme dhe afatgjatë dhe do të kalojë nëpërmjet hallkave të mëposhtme:

- zhvillimit të kurbës së *yield*-ve në drejtim të titujve shtetërorë afatmesëm dhe afatgjatë nëpërmjet krijimit dhe konsolidimit të madhësive *benchmark*, si edhe reduktimit të fragmentimit të kërkesës;
- përshtatjes së politikave të huamarrjes (përfshirë shitjen, parablerjen dhe shkëmbimin e titujve shtetërorë) me kushtet e tregut dhe kërkesën për tituj të caktuar;
- rritjes së transparencës nëpërmjet konsultimit të vazhdueshëm me aktorët kryesorë të tregut dhe raportimit e publikimit në kohë të rezultateve të ankandeve të titujve shtetërorë;
- përmirësimit të mëtejshëm të kuadrin ligjor dhe rregullator për emetimin e titujve shtetërorë;
- diversifikimit dhe zgjerimit të bazës së investitorëve.

#### MENAXHIMI I BORXHIT

Borxhi i qeverisjes qendrore gjatë viteve të fundit, përgjithësisht, është karakterizuar nga një ecuri pozitive, duke qenë në linjë me objektivat makrofiskalë, nevojat buxhetore për financim dhe objektivat strategjikë afatmesëm të menaxhimit të borxhit.

Në përputhje me objektivat makrofiskalë, niveli i borxhit të qeverisjes qendrore, në raport me

<sup>1</sup> Neni 6, i ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.



PBB<sup>2</sup>, ka hyrë në trajektore rënëse që prej vitit 2016. Vlerësimet për fundin e vitit 2019 tregojnë një rënie me rreth 2.5 pikë përqindje të borxhit të qeverisjes qendrore në raport me PBB-në.

Huamarrja u është përgjigjur nevojave buxhetore, duke mundësuar rifinancimin e borxhit ekzistues dhe financimin e deficitit të planifikuar. Nevojat për huamarrje kanë shënuar një rënie graduale, duke reflektuar përmirësimin e profilit të borxhit dhe reduktimin e riskut fiskal të qeverisë.

Gjatë pesëvjeçarit të fundit, burimet e brendshme të financimit kanë mbajtur peshën kryesore në mbulimin e nevojave për huamarrje në terma bruto. Megjithatë, gjatë viteve më të fundit ka spikatur roli i huamarrjes nga jashtë, në funksion të mirëmenaxhimit të likuiditetit dhe të shlyerjes së detyrimeve të borxhit në valutë për periudhën afatshkurtër dhe afatmesme. Kjo mënyrë huamarrjeje u diktua nga rënia e normave të interesit në tregjet ndërkombëtare, si edhe nga kushtet e favorshme të financimit nga institucionet financiare ndërkombëtare. Zhvillimin kryesor në këtë aspekt e ka mbartur emetimi i *Eurobond*-it, në shumën 500 milionë euro në fund të vitit 2018, i cili u shoqërua me procesin e parablerjes së pjesshme (*buyback*) të *Eurobond*-it ekzistues në vlerën prej 200 milionë eurosh.

Ky proces mundësoi jo vetëm plotësimin e nevojave për likuiditet të vitit 2018 dhe 2019, por edhe menaxhimin aktiv të detyrimeve të borxhit, duke mbajtur nën kontroll riskun e rifinancimit dhe atë të normave të interesit në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme.

Objektivat strategjikë afatmesëm të menaxhimit të borxhit, përgjithësisht, janë përmbushur, si në drejtim të arritjes së raporteve optimale ndërmjet kostos dhe risqeve, ashtu edhe në aspektin e zhvillimit të tregut të titujve shtetërorë.

Ekspozimi më i ulët ndaj risqeve është arritur nëpërmjet përqendrimit më të lartë të huamarrjes së brendshme te titujt afatgjatë me norma interesi fikse.

<sup>2</sup> PBB-ja e përdorur në raportet me të dhënat faktike deri në vitin 2018, i referohet kuadrit makroekonomik dhe fiskal (2020–2022), të miratuar me VKM-në nr. 4, datë 9.1.2019. Ndërkohë, PBB-ja e përdorur në raportet me të dhënat e projektuara u referohet të dhënave të draftkuadrit makroekonomik dhe fiskal (2021–2023).

Nga ana tjetër, rënia e normave të interesit shoqëruar me përdorimin më të lartë të burimeve të huaja të financimit me natyrë dypalëshe dhe shumëpalëshe, kanë ndikuar në optimizimin e kostos së përgjithshme të huamarrjes.

Në këtë aspekt, vlen të përmendet se gjatë viteve të fundit, kostot për njësi të borxhit janë ulur ndjeshëm, pavarësisht rritjes së stokut të borxhit në vlerë absolute.

Në funksion të arritjes së objektivit për përmirësimin e mëtejshëm të tregut primar të titujve shtetërorë, si edhe krijimin e kushteve për zhvillimin e tregut sekondar, janë ndjekur hapat e nevojshëm që kanë synuar rritjen e eficiencës, likuiditetit dhe transparencës.

Në këtë drejtim vlen të përmendet zbatimi i projektit pilot për emetimin e obligacioneve referencë, i cili ka filluar me obligacionin 5-vjeçar gjatë vitit 2018 dhe është shtrirë edhe në obligacionin 3-vjeçar gjatë vitit 2019.

Nga ana tjetër, baza e investitorëve për titujt shtetërorë, megjithëse mbetet ende jo shumë e diversifikuar dhe e përqendruar kryesisht te sektori bankar, ka shfaqur një shtrirje më të gjerë drejt institucioneve jofinanciare, financiare jobanka, si edhe drejt individëve.


Në periudhën afatmesme menaxhimi i borxhit do të vijojë të synojë përmirësimin e mëtejshëm të profilit të borxhit (kryesisht atë të portofolit të borxhit të brendshëm), si në terma të ekspozimit sa më të ulët ndaj risqeve, ashtu edhe në terma të mbajtjes nën kontroll të kostove të borxhit.

## I. SITUATA E BORXHIT TË QEVERISJES QENDRORE

### 1. Ecuria e borxhit të qeverisjes qendrore

Në përputhje me objektivat makrofiskalë për konsolidimin e financave publike, niveli i borxhit të qeverisjes qendrore në raport me PBB-në ka hyrë në trajektore rënëse që prej vitit 2016. Kjo tendencë pritet të vijojë edhe përgjatë vitit 2019, pasi parashikimet sinjalojnë një rënie të nivelit të borxhit me rreth 2.5 pp krahasuar me fundin e vitit të kaluar. Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në uljen e nivelit të borxhit, në raport me PBB-në, kanë qenë: konsolidimi fiskal, norma e rritjes ekonomike më e lartë se norma e rritjes së borxhit dhe mbiçmimi i monedhës vendëse, në raport me monedhat e tjera që përbëjnë portofolin e borxhit.


**Paraqitje grafike 1(a).** Borxhi i qeverisjes qendrore në vlerë absolute dhe relative ndaj PBB-së (2015–shtator 2019)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Gjatë viteve të fundit, nga pikëpamja e kompozimit të borxhit të qeverisjes qendrore, karakteristikë ka qenë rritja e peshës së instrumenteve të tregtueshme (bono thesari, obligacione, *Eurobond*) dhe huave në formën e mbështetjes buxhetore. Rritja e peshës së këtyre instrumenteve ka ardhur si rezultat i shfrytëzimit të kushteve të favorshme të tregjeve ndërkombëtare dhe shfrytëzimit të burimeve të favorshme të financimit të vendosura në dispozicion nga institucionet financiare ndërkombëtare.

**Paraqitje grafike 1(b).** Përbërja e borxhit të qeverisjes qendrore (2015–shtator 2019)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)


## 2. Realizimi i huamarrjes

Huamarrja gjatë viteve të fundit ka mundur sigurimin e likuiditetit për nevojat buxhetore dhe menaxhimin e detyrimeve të borxhit, si edhe ka financuar deficitin buxhetor të planifikuar, në përputhje me objektivat strategjikë për uljen e ekspozimit ndaj risqeve.

Nevojat për hua, në raport me PBB-në, janë ulur gradualisht duke reflektuar konsolidimin e strukturës së borxhit të brendshëm dhe reduktimin e riskut fiskal të qeverisë.

Burimi kryesor i huamarrjes vazhdon të mbetet tregu i brendshëm, megjithëse gjatë vitit 2018 ka pasur një rritje në drejtim të financimit të huaj si rezultat i emetimit të *Eurobond*-it.

Paraqitje grafike 2. Huamarrja bruto në vlerë absolute dhe relative ndaj PBB-së (2015–2019)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

## 2.1 Huamarrja e brendshme

Në linjë me objektivat për reduktimin e risqeve të portofolit të borxhit të brendshëm, nevojat për hua nëpërmjet burimeve të brendshme janë reduktuar ndjeshëm, duke mundësuar uljen e huamarrjes nëpërmjet titujve afatshkurtër.


Paraqitje grafike 2.1(a). Huamarrja e brendshme në vlerë absolute dhe në raport me PBB-në (2015–2019)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Huamarrja nëpërmjet titujve afatshkurtër, kryesisht ka shërbyer për të realizuar rfinancimin e këtyre titujve dhe menaxhimin e nevojave afatshkurtra për likuiditet, ndërkohë që financimi i deficitit (borxhi i ri) është siguruar kryesisht nëpërmjet titujve afatgjatë, duke qenë në linjë me objektivat për reduktimin e riskut të rfinancimit.

Paraqitje grafike 2.1(b). Huamarrja e brendshme neto, sipas jetëgjatësisë së titujve (2015–2019)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Ndërkohë, në linjë me objektivat për reduktimin e riskut të normave të interesit, si edhe duke shfrytëzuar prirjet rënëse të normave të interesit gjatë viteve të fundit, huamarrja nëpërmjet titujve



afatgjatë me norma interesi të ndryshueshme u reduktua gradualisht deri në tërheqjen e përkohshme të këtyre titujve nga tregu.

**Paraqitje grafike 2.1(c).** Huamarrja e brendshme bruto, sipas normës së interesit të titujve afatgjatë (2015–2019)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

## 2.2 Huamarrja e huaj

Gjatë pesë vjetëve të fundit huamarrja e huaj ka mbuluar mesatarisht rreth 15% të nevojave të përgjithshme të qeverisë për hua. Burimet kryesore të financimit mbeten burimet shumëpalëshe dhe ato dypalëshe, të cilat kryesisht janë përdorur për të financuar projektet prioritare, si edhe politikat zhvillimore dhe reformat e ndërmarra nga qeveria. Këto burime kanë pasur një ndikim të rëndësishëm, kryesisht në aspektin e optimizimit të kostove të borxhit dhe sigurimit të valutës së nevojshme për të shërbyer detyrimet e borxhit në valutë.

**Paraqitje grafike 2.2.** Huamarrja e huaj bruto, sipas koncesionalitetit (2015–9m 2019)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)


Gjithashtu, edhe huamarrja nëpërmjet burimeve private, në formën e *Eurobond*-it dhe PBG (në vitet 2015 dhe 2018) kanë luajtur një rol të rëndësishëm në plotësimin e nevojave për hua, si edhe në menaxhimin aktiv të likuiditetit dhe detyrimeve të borxhit. Emetimi i *Eurobond*-it në vlerën 500 milionë euro në vitin 2018, i cili u shoqërua me procesin e parablerjes së pjesshme (*buyback*) të *Eurobond*-it ekzistues në vlerën prej 200 milionë eurosh, mundësoi jo vetëm plotësimin e nevojave për likuiditet të vitit 2018 dhe të vitit pasardhës, por edhe menaxhimin aktiv të detyrimeve të borxhit për të mbajtur nën kontroll riskun e rifinancimit dhe atë të normave të interesit në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme.

## 3. Portofoli i borxhit shtetëror

Nga pikëpamja e kompozimit, sipas instrumenteve, titujt shtetërorë vendës vijojnë të dominojnë më shumë se gjysmën e portofolit të borxhit shtetëror. Ndërkohë, në portofolin e borxhit të jashtëm ka një

tendencë në drejtim të rritjes së përqendrimit të titujve ndërkombëtarë, duke reflektuar politikat e huamarrjes gjatë viteve të fundit, të cilat nisur edhe nga kufizimet e tregut të brendshëm, kanë pasur si qëllim uljen e presionit të huamarrjes së brendshme për të lehtësuar procesin e ristrukturimit të portofolit të borxhit të brendshëm dhe stimuluar kreditmin e sektorit privat


**Paraqitje grafike 3(a).** Kompozimi i portofolit të borxhit shtetëror, sipas instrumenteve (2015–shtator 2019)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Për sa i përket kompozimit të portofolit të borxhit shtetëror, sipas maturitetit (origjinal) të instrumenteve të huas, vërehet një reduktim gradual i përqendrimit të instrumenteve afatshkurtra, duke reflektuar politikat e ndërmarra në kuadër të menaxhimit të risqeve në portofolin e borxhit të brendshëm.


**Paraqitje grafike 3(b).** Kompozimi i portofolit të borxhit shtetëror, sipas maturitetit origjinal të instrumenteve të huas (2015–shtator 2019)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Mbi 70% e portofolit të borxhit shtetëror përbëhet nga instrumente me norma interesi fikse. Gjatë viteve të fundit ka pasur një tendencë në drejtim të uljes së përqendrimit të instrumenteve me norma interesi të ndryshueshme në portofolin e borxhit të brendshëm, duke reflektuar politikat e ndërmarra në kuadër të menaxhimit të riskut të normave të interesit.

**Paraqitje grafike 3(c).** Kompozimi i portofolit të borxhit shtetëror, sipas tipit të interesit të instrumenteve të huas (2015–shtator 2019)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Portofoli i borxhit shtetëror vazhdon të mbizotërohet në mbi 50% nga monedha vendëse, ndërkohë që ndiqet nga monedha euro dhe USD.

Portofoli i borxhit të brendshëm përbëhet tërësisht nga tituj të denominuar në monedhë vendëse, pasi gjatë dy vjetëve të fundit nuk ka pasur emetim të titujve vendës në valutë.

Portofoli i borxhit të jashtëm, pavarësisht diversifikimit të vjetëve të fundit, vazhdon të dominohet në mbi 65% nga monedha euro, duke e bërë të ndjeshëm ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit EUR/LEK. Megjithatë, përqendrimi i lartë i portofolit të borxhit të huaj në monedhën euro është në përputhje me objektivat strategjike, si edhe aspiratat e vendit për t'u integruar në Bashkimin Evropian.

**Paraqitje grafike 3(d).** Stoku i borxhit shtetëror sipas monedhave (shtator 2019)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

#### 4. Portofoli i borxhit shtetëror të garantuar


Në shtator 2019, portofoli i borxhit shtetëror të garantuar vlerësohet në rreth 3.9% të portofolit të borxhit të qeverisjes qendrore. Borxhi i garantuar gjatë vjetëve të fundit ka ardhur duke u reduktuar,

kryesisht, për shkak të nivelit relativisht më të lartë të ripagesave në raport me disbursimet e huave ekzistuese, si edhe për shkak të emetimeve në masë të kufizuar të garancive të reja.

Ndër vite, portofoli i borxhit të garantuar ka qenë i dominuar nga garancitë e emetuara në favor të tregut të brendshëm. Këto garanci kanë garantuar linjat e huave afatshkurtra të marra nga Korporata Elektroenergetike Shqiptare (KESH sh.a.) për të mundësuar aktivitetin e saj. Maturiteti afatshkurtër dhe normat e interesit tregtar kanë bërë që këto hua të paraqesin një risk rifinancimi relativisht të lartë për KESH sh.a. dhe, rrjedhimisht, edhe për qeverinë që është garant i tyre. Megjithatë, që prej vitit 2018, risku i qeverisë që buron nga këto garanci është reduktuar ndjeshëm, si rezultat i bërjes efektive të marrëveshjes së huas ndërmjet KESH sh.a. dhe BERZH-it. Kjo marrëveshje mundësoi reduktimin e më shumë se gjysmës së portofolit të garancive të brendshme, duke zbutur ndjeshëm riskun e rifinancimit që mund të buronte nga risku sistematik i sektorit bankar vendës ose ndryshimi i politikave investuese të bankave që kishin financuar huat e KESH sh.a. Në dallim nga garancitë e brendshme, garancitë e huaja paraqesin më pak risk, pasi garantojnë kryesisht hua afatgjata me norma interesi të favorshme.

Pavarësisht sa më sipër, garancitë shtetërore të huas vazhdojnë të paraqesin risqe, pasi më shumë se 80% e tyre i përkasin sektorit të energjisë, duke e bërë buxhetin e shtetit të ndjeshëm ndaj çdo risku që mund të paraqesë ky sektor.

**Paraqitje grafike 4.** Kompozimi i garancive shtetërore të huas (2015–shtator 2019)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

## 5. Menaxhimi i kostove dhe i risqeve

Gjatë vjetëve të fundit, portofoli i borxhit shtetëror është karakterizuar nga përmirësimi i raportit midis koston dhe risqeve. Kostoja e borxhit është ulur ndjeshëm dhe struktura e borxhit është përmirësuar, kryesisht në aspektin e reduktimit të ekspozimit ndaj riskut të rifinancimit dhe riskut të normave të interesit.

Përmirësimi i raportit ndërmjet koston dhe riskut ka ardhur jo vetëm si rezultat i mirëmenaxhimit në përputhje me objektivat strategjike, por edhe si rezultat i kushteve të favorshme të tregjeve dhe faktorëve makroekonomikë të vendit, të tillë si:

- ulja e normave bazë të interesit në tregun e brendshëm dhe atë të huaj, si rezultat i politikave monetare lehtësuese të bankave qendrore;
- disponueshmëria në nivele të konsiderueshme e burimeve të huaja të financimit me norma interesi të favorshme (koncesionale);
- kërkesa e kënaqshme për titujt shtetërorë afatgjatë me norma interesi fikse;
- ulja e kursit të këmbimit EUR/LEK dhe lëvizja e këtij kursi, përgjithësisht në drejtim të kundërt me kursin USD/LEK.




Pavarësisht përmirësimeve të mësipërme, niveli relativisht i lartë i borxhit shoqëruar me ndjeshmërinë nga faktorët e jashtëm, bëjnë që risqet të jenë ende të konsiderueshme dhe masat për reduktimin e mëtejshëm të jenë të nevojshme.

### 5.1 Kostot

Shpenzimet për interesa të borxhit shtetëror ndaj të ardhurave tatimore dhe PBB-së, gjatë vjetëve të fundit kanë ndjekur një trajktore rënëse, duke pasur një rritje gjatë vitit 2018, të ndikuar kryesisht nga rritja e stokut të borxhit në vlerë absolute dhe efekti i parablerjes së *Eurobond*-it që maturohet në vitin 2020.

**Paraqitje grafike 5.1(a).** Interesat e borxhit shtetëror në vlerë absolute dhe relative ndaj PBB-së dhe të ardhurave tatimore (2015–2019)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Kostoja mesatare e borxhit të brendshëm (norma mesatare e ponderuar) ka ardhur në rënie, megjithëse në portofolin e borxhit është rritur ndjeshëm përqendrimi i titujve afatgjatë, duke reflektuar një përmirësim në raportin ndërmjet koston dhe riskut. Ulja e koston mesatare ka ardhur për shkak të rënies së vazhdueshme të normave të interesit në tregun e brendshëm dhe zëvendësimit të borxhit që maturohet me borxh me norma interesi më të favorshme.

Në dallim nga borxhi i brendshëm, kostoja mesatare e borxhit të jashtëm ndër vite ka qenë më e qëndrueshme, ndërkohë që gjatë dy vjetëve të fundit paraqet një tendencë të moderuar rritëse, të ndikuar kryesisht nga rritja e stokut me instrumente të tregtueshme. Portofoli i borxhit të jashtëm ka kosto më të ulët se borxhi i brendshëm, pasi pothuajse gjysma e këtij portofoli përbëhet nga hua me terma koncesionale, ndërkohë që edhe instrumentet e tregtueshme, si *Eurobond*-i, emetohen në tregje shumë më konkurruese dhe likuide se tregu vendës.

**Paraqitje grafike 5.1(b).** Kostoja mesatare për njësi e borxhit të brendshëm dhe të jashtëm (2015–2019)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

## 5.2 Risqet

Ekspozimi i portofolit të borxhit ndaj risqeve është arritur të menaxhohet me sukses, në linjë me objektivat strategjike afatmesëm. Ulja e peshës së titujve afatshkurtër dhe të atyre me norma interesi të ndryshueshme në portofolin e borxhit të brendshëm, kanë qenë faktorët përcaktues në reduktimin e riskut të rifinancimit dhe të riskut të normave të interesit. Megjithatë, duke konsideruar bazën e investitorëve jo shumë të diversifikuar dhe mungesën e një tregu sekondar aktiv, borxhi i brendshëm mbetet ende i ekspozuar ndaj këtyre risqeve, duke e bërë të nevojshme vazhdimin e masave për ristrukturimin e mëtejshëm të portofolit dhe zhvillimin e tregut të titujve.


Ndërkohë, risku i kursit të këmbimit vijon të mbahet nën kontroll, duke qëndruar ndjeshëm nën kufirin strategjik.

### 5.2.1 Risku i rifinancimit

Një ndër objektivat kryesore të SAMB-së është reduktimi i riskut të rifinancimit, kryesisht në portofolin e borxhit të brendshëm, pasi borxhi i jashtëm paraqet më pak risk, duke qenë se është i përbërë nga instrumente me afat të gjatë maturimi dhe me profile amortizimi të shtrira gjatë në kohë.

Risku i rifinancimit në portofolin e borxhit të brendshëm është reduktuar ndjeshëm gjatë vjetëve të fundit. Treguesit që vlerësojnë këtë risk kanë evoluar në drejtim të objektivave strategjike. Ndikim në përmirësimin e riskut të rifinancimit të borxhit të brendshëm ka pasur ulja e peshës së instrumenteve afatshkurtra, me rreth 8.9 pp në harkun kohor të 5 vjetëve (nga 43.0% në fund të vitit 2015 në 34.1% në shtator 2019).

**Paraqitje grafike 5.2.1.** Ecuria e treguesve të riskut të rifinancimit (2015–shtator 2019)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

### 5.2.2 Risku i normave të interesit

Treguesit e riskut të normave të interesit janë përmirësuar ndjeshëm, duke qenë në linjë me objektivat strategjike. Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në uljen e ekspozimit të këtij risku kanë qenë ulja e peshës së titujve afatshkurtër<sup>3</sup> dhe të atyre me norma interesi të ndryshueshme në portofolin e borxhit të brendshëm, përkatësisht me rreth 8.92 pp dhe 8.93 pp në harkun kohor të pesë vjetëve. Përmirësimi i riskut të normave të interesit ka ulur ndjeshmërinë e borxhit nga goditjet e normave të interesit, duke reduktuar burimet që qeveria duhet të angazhojë në raste të tilla.

<sup>3</sup> Titujt afatshkurtër, nga pikëpamja e riskut të normave të interesit, konsiderohen si instrumente me norma interesi të ndryshueshme.

Paraqitje grafike 5.2.2. Ecuria e treguesve të riskut të normave të interesit (2015–shtator 2019)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

### 5.2.3 Risku i kursit të këmbimit

Ekspozimi ndaj riskut të kursit të këmbimit është mbajtur nën kontroll, pasi stoku i borxhit shtetëror në monedhë të huaj vazhdon të qëndrojë ndjeshëm nën kufirin strategjik dhe atë të qëndrueshmërisë së borxhit.


Paraqitje grafike 5.2.3(a). Borxhi shtetëror në monedhë të huaj (2015–shtator 2019)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Portofoli i borxhit shtetëror në monedhë të huaj gjatë vjetëve të fundit ka pasur tendencë diversifikimi në drejtim të uljes së peshës së monedhës euro dhe të rritjes së peshës së monedhave të tjera. Pavarësisht këtij zhvillimi, portofoli i borxhit të jashtëm vazhdon të jetë i përqendruar në mbi 60%<sup>4</sup> në monedhën euro, duke e bërë atë të ndjeshëm ndaj luhatjeve të kësaj monedhe. Megjithatë, përqendrimi i lartë i borxhit në monedhën euro nuk ka krijuar kosto shtesë për shkak të mbiçmimit të monedhës vendëse dhe për shkak të lëvizjes së kursit të këmbimit EUR/LEK, përgjithësisht në drejtim të kundërt me kursin USD/LEK<sup>5</sup>, duke neutralizuar efektet e njëri-tjetrit.

Paraqitje grafike 5.2.3(b). Ndryshimi në kursin e këmbimit mesatar mujor EUR/LEK dhe USD/LEK (2015–shtator 2019)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)


<sup>4</sup> Duke përfshirë edhe peshën që mban monedha EUR brenda shportës së monedhave SDR dhe ACU.

<sup>5</sup> Monedha USD zë rreth 22.7% të portofolit të borxhit të jashtëm, duke u vlerësuar si monedha e dytë më e rëndësishme dhe si një nga monedhat me kursin më të luhatshëm në portofol.

Raportet e borxhit në monedhë të huaj kundrejt eksporteve dhe rezervës valutore janë tregues të rëndësishëm, të cilët vlerësojnë aftësinë për të përmbushur detyrimet që lindin nga borxhi në valutë.

Gjatë vjetëve të fundit, ritmet e rritjes së borxhit në monedhë të huaj, përgjithësisht, kanë qenë në nivele të ngjashme me ritmet e rritjes së rezervës valutore. Ndërkohë, në raport me eksportet kanë qenë ndjeshëm më të larta, por duke shfaqur një përmirësim, duke filluar nga viti 2016.

**Paraqitje grafike 5.2.3(c).** Raporti i borxhit në valutë ndaj eksporteve dhe rezervës valutore (2014–2018)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019); INSTAT (2019); Banka e Shqipërisë (2019)

#### 5.2.4 Risku i likuiditetit


Risku i likuiditetit gjatë vjetëve të fundit tenton të zbutet, ndërkohë që nevojat e qeverisë për likuiditet janë menaxhuar me sukses, pa ushtruar presion në tregun e brendshëm.

Nga ana tjetër, që prej vitit 2017 është mundësuar krijimi i një rezerve monetare (*cash buffer*), e cila do të mbulojë pjesërisht nevojat për likuiditet të qeverisë në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme.

Në këtë drejtim rol të rëndësishëm ka luajtur edhe Komiteti i Menaxhimit të Borxhit dhe Likuiditetit, i cili mbledhet periodikisht për të analizuar dhe planifikuar gjendjen e likuiditetit në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme.

Treguesit që vlerësojnë riskun e likuiditetit kanë pësuar një përmirësim të ndjeshëm, kryesisht si rezultat i masave të marra në kuadër të reduktimit të riskut të rifinancimit. Raportet e shpenzimeve për interesa të borxhit shtetëror dhe të borxhit shtetëror afatshkurtër<sup>6</sup> ndaj të ardhurave tatimore janë reduktuar ndjeshëm, duke qenë në linjë me objektivat për konsolidimin e risqeve fiskale.

**Paraqitje grafike 5.2.4.** Shërbimi i borxhit në raport me të ardhurat tatimore (2014–2019)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

<sup>6</sup> I referohet borxhit shtetëror të brendshëm dhe atij të huaj me maturitet të mbetur deri në një vit.

## 6. Zhvillimet e tregut primar të titujve shtetërorë


Tregu primar i titujve shtetërorë ka shfaqur zhvillime pozitive, ndër të cilat mund të përmenden: i. kërkesa e tregut për tituj shtetërorë në nivele të kënaqshme, e cila ka arritur të mbulojë nevojat e qeverisë për huamarrje, në përputhje me objektivat strategjikë; ii. ndërmarrja e aktiviteteve në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës së tregut të titujve shtetërorë; dhe iii. zbutja e volatilitetit të normave të interesit.

### 6.1 Ecuria e ankandeve dhe kërkesa për tituj shtetërorë

Kërkesa për tituj shtetërorë, përgjithësisht vazhdon të jetë e ngjashme, duke mos paraqitur ndryshime të theksuara në vjetët e fundit. Ajo vazhdon të mbështetet tek investitorët vendës (rezident), ndërkohë që sektori bankar mbetet burimi kryesor i kërkesës.

Vërehet një përmirësim i dukshëm në raportin e mbulimit (kërkesë/ofertë), megjithëse vlen të theksohet se përmirësimi buron kryesisht nga reduktimi i nevojave të qeverisë për hua në tregun e brendshëm. Karakteristikat e kërkesës kanë qenë pozitive, pasi ka pasur një prirje të saj në drejtim të titujve afatgjatë duke i mundur qeverisë realizimin e huamarrjes në përputhje me objektivat strategjikë për reduktimin e risqeve të portofolit të borxhit të brendshëm.

**Paraqitje grafike 6.1 (b).** Treguesit e ecurisë së kërkesës dhe ofertës në tregun primar të titujve shtetërorë (2015–shtator 2019)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Karakteristikat e kërkesës, përgjithësisht reflektohen edhe në drejtim të mbajtësve të borxhit. Portofoli i borxhit të brendshëm vazhdon të jetë i përqendruar në mbi 60% te sektori bankar, duke e bërë atë të ndjeshëm ndaj risqeve sistematike të sektorit bankar dhe ndryshimeve në politikat investuese të bankave.

Banka e Shqipërisë, pavarësisht reduktimit të portofolit në terma relativë, vazhdon të mbajë të njëjtin volum titujsh (në vlerë absolute) të tregtuar në tregun primar, ndërkohë që ka rritur volumin e tregtuar në tregun sekondar për të stimuluar aktivitetin e këtij tregu.

**Paraqitje grafike 6.1 (c).** Mbajtësit e borxhit të brendshëm shtetëror (2015–shtator 2019)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)




Në kuadër të zhvillimit të infrastrukturës së tregut primar dhe stimulimit të tregut sekondar, kanë vazhduar të ndërmerren aktivitete të cilat kanë pasur si objektiv reduktimin e fragmentimit të kërkesës, si dhe krijimin dhe konsolidimin e madhësive *benchmark* për titujt afatgjatë.

Në drejtim të uljes së fragmentimit të kërkesës, që prej vitit 2016 janë tërhequr plotësisht obligacionet 7- dhe 10-vjeçare me norma interesi të ndryshueshme.

Në drejtim të krijimit të madhësive *benchmark* është vijuar me konsolidimin e numrit të ankandëve të titujve shtetërorë, duke ulur frekuencën e emetimeve të titujve të rinj dhe duke përdorur rihapjet e titujve ekzistues.

**Paraqitje grafike 6.1 (d).** Ecuria e ankandëve të titujve shtetërorë (2015–2019)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Gjithashtu, gjatë vitit 2018 është testuar projekti pilot për emetimin e obligacioneve 5-vjeçare referencë në formën e sistemit *Market Maker*. Rezultatet paraprake të këtij projekti kanë treguar se ka pasur rritje të volumit të tregtimit të këtij titulli në tregun sekondar dhe për më tepër edhe rritje të volumit të titujve me maturitet të mbetur 5 vite. Nisur nga këto rezultate, gjatë vitit 2019 ky projekt është shtrirë edhe tek obligacionet me afat maturimi 3 vite.

## 6.2 Ecuria e normave të interesit

Normat e interesit të titujve shtetërorë, gjatë vjetëve të fundit kanë pësuar rënie të vazhdueshme, duke u stabilizuar në periudhën 2017–2018. Megjithatë, gjatë vitit 2019 normat e interesit kanë vijuar sërish të shfaqin tendencë rënëse, duke reflektuar vazhdimin e politikave lehtësuese të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, si edhe reduktimin e nevojave për hua të qeverisë në gjysmën e parë të vitit, për shkak të likuiditetit të mjaftueshëm të siguruar nga emetimi i *Eurobond*-it në fund të vitit 2018.

**Paraqitje grafike 6.2.** Norma mesatare e ponderuar i titujve shtetërorë<sup>7</sup>



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

<sup>7</sup> Bazuar në normën mesatare të ponderuar të titujve shtetërorë të emetuar në tregun primar.



## II. STRATEGJIA E MENAXHIMIT TË BORXHIT

### 1. Supozimet bazë

Në këtë kapitull paraqiten pritshmëritë, si edhe supozimet bazë që janë përdorur, në lidhje me mjedisin makroekonomik dhe kushtet e tregut në të cilin do të menaxhohet borxhi në periudhën afatmesme 2020–2022.

*Supozimet e përdorura janë faktorë kyç dhe çdo ndryshim i tyre nga skenari bazë mund të ketë ndikim mbi nivelin e financimit dhe për rrjedhojë edhe mbi kostot e borxhit dhe realizimin e objektivave strategjike të përcaktuar në SAMB.*

### 1.1 Zhvillimet aktuale dhe pritshmëritë në sektorin real, sektorin e jashtëm, atë financiar dhe sektorin fiskal

*Rritja ekonomike* në pesëvjeçarin e fundit ka rezultuar në një trend rritës, me bazë të gjerë mbështetjeje në aspektin sektorial. Gjatë gjysmës së parë së vitit 2019, rritja ekonomike u ngadalësua krahasuar me një vit më parë, në rreth 2.4%. Në masën më të madhe ky ngadalësim i atribuohet goditjeve nga ana e ofertës, të ilustruara kryesisht nga prodhimi më i ulët i energjisë elektrike. Për vitin 2019, në tërësi pritët një rritje ekonomike më e ngadaltë se ajo e një viti më parë. Megjithatë, në mungesën e goditjeve të tjera, si në krahun e ofertës apo atë të kërkesës, ritmi i rritjes së aktivitetit ekonomik në vend pritët të jetë më i lartë, në rreth 4% në vitet në vijim.

*Inflacioni* është luhatur në interval vlerash të ulëta gjatë vjetëve të fundit, duke qëndruar nën objektivin e Bankës së Shqipërisë, prej 3%. Gjatë pjesës më të madhe të vitit 2019, inflacioni ka rezultuar i ulët, mesatarisht 1.4%, në reflektim të presioneve të dobësuar inflacioniste nga jashtë, si pasojë e normave më të ulëta të inflacionit në Eurozonë, çmimeve në rënie të lëndëve bazë, si edhe të vijimësisë së mbiçmimit të monedhës vendëse. Në vitin 2019, në tërësi, pritët një inflacion më i ulët se në 2018, megjithatë ky tregues pritët të njohë vlera në rritje gjatë vjetëve në vijim, por pa arritur objektivin pikësor të përcaktuar nga autoriteti monetar i vendit.

*Pozicioni fiskal* është përmirësuar në vjetët e fundit në sajë të sjelljes konsoliduese që ka shfaqur politika fiskale, në funksion të arritjes dhe të ruajtjes së qëndrueshmërisë fiskale në afatin e mesëm e më tej. Balanca primare për

vitin 2019, pritët të jetë pozitive, duke kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në rënien e borxhit publik në terma të PBB-së. Procesi i konsolidimit fiskal pritët të vijojë edhe në vjetët e ardhshëm, e si i tillë pritët të jetë një prej faktorëve që do të ndikojë në përmirësimin e trajektores afatmesme të borxhit publik.

*Pozicioni i jashtëm i ekonomisë* ka njohur një përmirësim të lehtë në vjetët e fundit, reflektuar në ngushtim të deficitit të llogarisë korrente në terma të PBB-së. Ky deficit u ngushtua, kryesisht si pasojë e përmirësimit të bilancit të shërbimeve, në reflektim të të hyrave më të larta nga turizmi. Nga ana tjetër, rezerva valutore ka qenë mjaftueshëm e lartë, si në terma të mbulimit në muaj importe, ashtu edhe të borxhit të jashtëm afatshkurtër (privat dhe publik), ndonëse ky i fundit është në nivel relativisht të lartë. Kështu, referuar treguesve për gjysmën e parë të vitit 2019, stoku i rezervës valutore rezultoi i mjaftueshëm për të mbuluar 6.6 muaj importe ose 160% të borxhit afatshkurtër të të gjithë agentëve ekonomikë. Këto raporte mbulimi vlerësohen të jenë adekuate në minimizimin e riskut të ekspozimit ndaj monedhës së huaj, risk i cili është prezent jo vetëm si pasojë e nivelit të lartë të borxhit (publik e privat) në monedhë të huaj, por edhe si rezultat i eurozimit të pjesshëm të ekonomisë.

*Normat e interesit në tregun primar* kanë njohur një trend rënës në vjetët e fundit, pavarësisht volatilitetit të përkohshëm që kanë pasur normat e interesit në titujt shtetërorë me afat të shkurtër maturimi. Në segmentin afatgjatë të titujve shtetërorë prirja rënëse ka qenë më e evidente, duke u bërë kështu një premisë të kostove më të ulëta shërbimi të borxhit në të ardhmen. Në periudhën e ardhshme normat e interesit pritët të ruajnë tendencën aktuale, duke qëndruar në të njëjtën linjë me kahun e pritur stimulues të politikës monetare. Bazuar në vlerësimet e Bankës së Shqipërisë normalizimi gradual i politikës monetare pritët të fillojë pas gjysmës së parë të vitit 2020.

Në tregun e jashtëm, lufta tregtare SHBA–Kinë dhe pasiguria për arritjen e një marrëveshjeje tregtare ndërmjet BE-së dhe Britanisë së Madhe (që pas daljes nga BE-ja të Britanisë së Madhe), kanë ndikuar në moderimin





e rritjes ekonomike globale, më e dukshme kjo në ekonominë kineze dhe atë evropiane.

Në reflektim të kësaj situatë, një sërë bankash qendrore kanë rishikuar politikën monetare, duke rritur edhe më tej ekspansionin monetar (përfshirë këtu BQE-në, Rezervën Federale, Bankën Popullore të Kinës etj.).

BQE-ja ka vijuar me shtimin e mëtejshëm të likuiditetit nëpërmjet një programi të ri blerjesh të titujve dhe kreditimi afatgjatë të sistemit bankar. Ndërkohë, Rezerva Federale, në fillim të vitit ndaloi ciklin rritës të interesave dhe uli me 50 pb normën bazë të interesit gjatë muajve korrik-shtator. Në këto kushte, pritshmëritë janë që normat e interesit do të vijojnë të qëndrojnë në nivele të krahasueshme me aktualet.

*Kursi i këmbimit* të monedhës vendëse kundrejt monedhës euro ka vijuar mbiçmimin edhe gjatë pjesës së parë të vitit 2019, duke kapur nivelin 121.4 lekë. Për të shmangur efektet negative në inflacion nga mbiçmimi i monedhës vendëse, Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë në tregun e brendshëm valutor, duke tërhequr ofertën e tepërt të valutës, të ndikuar edhe nga flukset e larta sezonale të verës. Pritshmëritë vlerësojnë një stabilizim të presioneve mbiçmuese të monedhës vendëse në periudhën afatshkurtër dhe një rritje të moderuar të kursit të këmbimit EUR/LEK në periudhën afatmesme, por duke qëndruar konsiderueshëm poshtë mesatares historike.

**Tabela 1.1.** Pritjet e treguesve kryesorë makroekonomikë e fiskalë (2019–2022)

| Treguesit                            | Mesatare<br>2010-2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 |
|--------------------------------------|-----------------------|------|------|------|------|------|
| Rritja reale ekonomike (në %)        | 2.7                   | 4.1  | 3.0  | 4.0  | 4.0  | 4.0  |
| Inflacioni mesatar vjetor (në %)     | 2.2                   | 2.0  | 1.8  | 2.0  | 2.4  | 2.8  |
| Balanca primare (në % të PBB)        | -0.5                  | 0.6  | 0.2  | 0.7  | 1.1  | 1.3  |
| Shpenzime për interesa (në % të PBB) | 2.9                   | 2.2  | 2.1  | 2.1  | 2.2  | 2.3  |

Burimi: FMN, WOE (tetor 2019); Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019); Banka e Shqipërisë (2019)

## 1.2 Vlerësime referuar borxhit ekzistues, tregjeve të instrumenteve financiare dhe faktorëve makroekonomikë

Gjatë vjetëve të fundit struktura e borxhit shtetëror është përmirësuar ndjeshëm në aspektin e ekspozimit ndaj risqeve. Megjithatë, borxhi shtetëror vijon të mbetet i ekspozuar, kryesisht kundrejt riskut të rifinancimit, riskut të normave të interesit dhe riskut të kursit të këmbimit.

Risku i rifinancimit dhe risku i normave të interesit vijojnë të jenë burimet kryesore të riskut në portofolin e borxhit të brendshëm, kryesisht për shkaqe strukturore të lidhura me tregun e brendshëm të titujve shtetërorë.

Ndërkohë, risku i kursit të këmbimit, megjithëse është brenda parametrave të vlerësuar në analizat e qëndrueshmërisë së borxhit<sup>8</sup>, mund të paraqesë problematika, duke qenë se pjesa dërrmuese e

portofolit të borxhit në valutë është e përqendruar në monedhën euro dhe aftësitë e shtetit për të gjeneruar valutë nga të ardhurat apo burime të tjera mbeten të kufizuara.

Referuar treguesve makroekonomikë dhe të riskut të kreditit, shteti shqiptar, aktualisht është në gjendje të marrë hua, si në tregun vendës, ashtu edhe në atë të huaj.

Huamarrja, nëpërmjet burimeve të tregut të brendshëm, është më e thjeshtë për t'u realizuar, për sa i përket anës procedurale; është më fleksibël në terma të përzgjedhjes së instrumenteve; shmang ekspozimin ndaj riskut të kursit të këmbimit, si edhe stimulon në përgjithësi zhvillimin e tregut financiar dhe, në veçanti, zhvillimin e tregut të titujve shtetërorë. Megjithatë, edhe huamarrja në tregun e brendshëm mund të shoqërohet me kufizime, të cilat rrjedhin, kryesisht nga:

- jetëgjatësia relativisht e shkurtër e borxhit të brendshëm (rreth 2.1 vjet) dhe niveli i lartë i borxhit që rifinancohet në harkun kohor të një viti (mbi 300 miliardë lekë);

<sup>8</sup> Referuar kufijve të përcaktuar në analizën e qëndrueshmërisë së borxhit të publikuar nga FMN-ja në raportin për Shqipërinë: Artikulli IV (janar, 2019): <https://www.imf.org/en/Publications/CR/Issues/2019/01/28/Albania-2018-Article-IV-Consultation-Press-Release-Staff-Report-and-Statement-by-the-46556>





- baza e kufizuar e investitorëve dhe përqendrimi i saj në më shumë se 60% të sektori bankar;

- tregu jo plotësisht i zhvilluar i titujve shtetërorë, për shkak të mungesës së një tregu sekondar të mirëfilltë;

- kufizimet e vendosura nga bankat mëma në drejtim të bankave vendëse, në lidhje me kufizimin e ekspozimit ndaj borxhit sovran dhe ruajtjen e raporteve të caktuara të likuiditetit.

Duke marrë në konsideratë faktorët e mësipërm, shoqëruar me borxhin në vlerë absolute në rritje, pritshmëritë për rënien e mëtejshme të nivelit të kredive me probleme dhe prirjet e sektorit bankar për rritur kreditimin ndaj sektorit privat, financimi i brendshëm rezulton të jetë i kufizuar dhe rritja vjetore e tij, përtej nivelit 20–25 miliardë lekë, mund të ushtrojë presion rritës mbi normat e interesit dhe në të njëjtën kohë të vërë në vështirësi realizimin e planeve të huamarrjes me instrumentet e targetuara për të reduktuar riskun e rifinancimit dhe atë të normave të interesit.

Shërbimi i borxhit në valutë vlerësohet në rritje gjatë gjithë periudhës afatmesme 2020–2022. Duke qenë se të ardhurat e vendit tonë janë kryesisht në monedhë vendëse dhe llogaria korrente në bilancin e pagesave është dhe pritet të jetë deficitare, aftësia për të siguruar valutë mbetet e limituar. Sigurimi i valutës nga burimet e brendshme (nëpërmjet titujve shtetërorë në valutë) është i kufizuar, kryesisht në aspektin e maturitetit të dëshiruar për të reduktuar rreziqet në përputhje me objektivat. Nga ana tjetër, përdorimi si instrument i tregut të këmbimit valutor është, gjithashtu, i kufizuar dhe mund të krijojë implikime në ruajtjen e qëndrueshmërisë së kursit të këmbimit të monedhës vendëse, kryesisht kundrejt monedhës euro.

Tregu i jashtëm, duke qenë se ofron burime të mirëdiversifikuara financimi dhe është i aksesueshëm nga shteti shqiptar, mund të shërbejë si një alternativë e mirë për të reduktuar konsumimin e burimeve të brendshme, për të siguruar valutën e nevojshme për të shërbyer borxhin e huaj, si edhe për të reduktuar kostot<sup>9</sup> e huamarrjes. Megjithatë, edhe huamarrja në tregjet e

huaja mund të paraqesë risqe, të cilat lidhen me faktorë të tillë si:

- mungesa e kontrollit dhe influencës së politikave fiskale dhe monetare të vendit tonë mbi normat e interesit dhe kursin e këmbimit, që influencohen, kryesisht, nga politikat fiskale të vendeve të tjera dhe politikat monetare të BQE-së dhe Rezervës Federale. Këta faktorë mund të përshkallëzojnë rritjen e kostove të borxhit, zgjerimin e deficitit dhe, si rrjedhojë edhe rritjen e pavullnetshme të borxhit;

- rritja e varësisë nga huamarrja e huaj dhe kufizimi i zhvillimit potencial të tregut të brendshëm të titujve shtetërorë;

- niveli i kufizuar i të ardhurave në valutë mund të krijojë mospërputhje ndërmjet aktiveve dhe pasiveve në bilancin e shtetit, duke rritur ndjeshëm kostot shtesë që burojnë nga një nënçmim i mundshëm i monedhës vendëse;

- rritja e detyrimeve afatshkurtra të borxhit në valutë, me ritme më të larta se niveli i eksporteve ose i rezervave valutore, mund të vendosë shtetin në vështirësi për të likuiduar detyrimet në valutë, duke rrezikuar qëndrueshmërinë e monedhës vendëse dhe treguesve të tjerë makroekonomikë.

### 1.3 Burimet e financimit

Në kuadër të shërbimit të borxhit ekzistues dhe në kuadër të plotësimit të nevojave të qeverisjes qendrore për huamarrje, paraprakisht janë vlerësuar kushtet e tregut të brendshëm dhe ato të tregjeve ndërkombëtare të kapitalit, duke përcaktuar burimet potenciale të financimit për vendin tonë.

Në tregun e brendshëm është mbajtur kontakt i vazhdueshëm, kryesisht me sektorin bankar, për të vlerësuar nivelin potencial të kërkesës dhe preferencën e saj për tituj shtetërorë. Ndërkohë, në tregun e jashtëm janë bërë vlerësime me qëllim evidentimin e termave dhe kushteve kundrejt të cilëve investitorët e huaj janë të gatshëm të kreditojnë vendin tonë. Mbi bazën e këtyre vlerësimeve janë përcaktuar burimet potenciale të financimit në periudhën afatmesme 2020–2022.

#### 1.3.1 Burimet e brendshme

Në periudhën afatmesme, tregu i brendshëm do të vazhdojë të mbetet burimi kryesor i financimit, i cili do të mbulojë shumicën e nevojave të qeverisjes qendrore për hua. Instrumentet kryesore që do të përdoren për sigurimin e financimit janë titujt shtetërorë. Burimet e brendshme të financimit do të vazhdojnë të mbështeten kryesisht te sektori

<sup>9</sup> Kostoja e borxhit të huaj për njësi është relativisht më e ulët se ajo e borxhit të brendshëm, por shoqërohet me rritje të ekspozimit ndaj riskut të kursit të këmbimit, materializimi i të cilit mund të rezultojë në kosto shtesë.



bankar, ndërkohë që ka pritshmëri pozitive për rritjen e aktivitetit në tregun e titujve shtetërorë nga institucionet jofinanciare dhe investitorët jorezident.

Sektori bankar do të tentojë më së shumti të orientohet drejt bonove të thesarit dhe titujve afatmesëm, për shkak të orientimit të bankave mëma, si dhe në kuadër të kufizimeve lidhur me raportet e likuiditetit, barrën e kapitalit dhe ekspozimin ndaj borxhit sovran. Gjithsesi, orientimi i sektorit bankar drejt titujve afatshkurtër pritet të kompensohet nga rritja e kërkesës në kategoritë e tjera dhe orientimi i tyre në drejtim të titujve afatgjatë.

### 1.3.2 Burimet e huaja

Burimet e huaja të financimit në periudhën afatmesme do të shërbejnë si një plotësues i mirë i burimeve të brendshme dhe do të shërbejnë, përveç të tjerash, edhe si optimizues i kostove të borxhit, duke qenë se këto burime paraqiten të mirëdiversifikuara dhe ofrojnë mundësi financimi jo vetëm me terma tregtarë, por edhe me terma koncensionalë. Instrumentet kryesore që planifikohen të përdoren në sigurimin e financimit të huaj janë:

a) huat për financimin e projekteve<sup>10</sup>, të siguruara kryesisht nga burime dypalëshe dhe shumëpalëshe; b) huat në formën e mbështetjes buxhetore<sup>11</sup> të akorduara nga institucionet ndërkombëtare financiare në kuadër të mbështetjes së reformave (megjithëse vlerësohen në rënie krahasuar me periudhat e mëparshme); dhe c) *Eurobond* dhe/ose instrumente alternative të siguruara nga burime private.

## 2. Strategjia afatmesme

Në periudhën afatmesme 2020–2022, Strategjia e Menaxhimit të Borxhit do të përqendrohet në dy objektiva kryesorë: a) në drejtim të optimizimit të kostove afatgjata të borxhit, duke mbajtur nivele të pranueshme të ekspozimit ndaj risqeve<sup>12</sup>; dhe b) në drejtim të zhvillimit të tregut primar të titujve shtetërorë.

<sup>10</sup> Kryesisht, përfshihen projekte zhvillimore, të cilat janë përcaktuar si prioritare nga qeveria, me qëllim zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të vendit.

<sup>11</sup> Burim financimi me terma të favorshëm (koncesionale).

<sup>12</sup> U referohet risqeve, të tilla si: 1. Risku i rifinancimit; 2. Risku i normave të interesit; 3. Risku i kursit të këmbimit; 4. Risku i likuiditetit; 5. Risku i kreditit etj.

Mbulimi i nevojave të përgjithshme për financim të qeverisjes qendrore, në terma bruto do të bazohet në mbi 80% të burimet e brendshme. Mbështetja e gjerë e huamarrjes, kryesisht në tregun e brendshëm do të ketë për qëllim të mbështesë zhvillimin e tregut vendës të titujve shtetërorë dhe, njëkohësisht të kufizojë implikimet e treguesve makroekonomikë që mund të shkaktohen nga rritja e borxhit në valutë, përtej kufijve të përcaktuar në analizat e qëndrueshmërisë së borxhit. Megjithatë, pavarësisht mbështetjes së gjerë në burimet e brendshme, ritmet e rritjes së borxhit të brendshëm do të synohen të jenë në përputhje me ritmet e rritjes reale të ekonomisë vendëse, për të shmangur efektet negative në ekonomi që mund të burojnë nga mbikëmbimi i burimeve të brendshme.

Nëpërmjet titujve afatshkurtër, kryesisht do të realizohet menaxhimi aktiv i nevojave për likuiditet dhe do të synohet përmirësimi i profilit vjetor të maturimeve. Ndërkohë, borxhi i ri, i destinuar për të mbuluar një pjesë të deficitit të përgjithshëm do të synohet të mbulohet nëpërmjet titujve afatgjatë. Titujt afatgjatë planifikohen të emetohen me norma interesi fikse, gjithsesi duke mos përjashtuar edhe emetimin e titujve me norma interesi të ndryshueshme në periudhën afatmesme, në varësi të kushteve të tregut të brendshëm (preferencat e kërkesës, ecurinë e normave të interesit etj.), për të garantuar optimizimin e kostove në përputhje me objektivat e vendosur për të menaxhuar risqet e portofolit të borxhit (kreu II, seksioni 2.1.2).

Në periudhën afatshkurtër (2019–2020) titujt shtetërorë planifikohen të emetohen, kryesisht në monedhën vendëse<sup>13</sup>. Ndërkohë, në periudhën afatmesme dhe afatgjatë planifikohet të ketë emetime të titujve shtetërorë në valutë, me qëllim sigurimin e valutës së nevojshme për të shërbyer detyrimet e borxhit në valutë. Madhësitë e këtyre emetimeve do të vlerësohen periudhë pas periudhe, duke konsideruar kushtet e tregut vendës në raport me tregjet e huaja dhe disponueshmërinë e financimeve të huaja nga burime shumëpalëshe dhe dypalëshe në formën e mbështetjes buxhetore.

Në periudhën afatmesme, huamarrja nëpërmjet burimeve të huaja në terma bruto do të plotësojë

<sup>13</sup> Nuk u referohet titujve afatshkurtër të cilët mund të emetohen dhe maturohen, brenda të njëjtit vit fiskal, me qëllim menaxhimin e likuiditetit në valutë.



mesatarisht deri në 20% të nevojave të përgjithshme për hua të qeverisjes qendrore.

Instrumentet kryesore të huamarrjes së huaj do të jenë huat nga kreditorët me natyrë shumëpalëshe dhe dypalëshe, të cilat do të financojnë projektet ekzistuese dhe projektet e reja zhvillimore, si edhe huat në formën e mbështetjes buxhetore të akorduara nga institucionet financiare ndërkombëtare, të cilat do të synojnë mbështetjen e reformave të ndërmarra nga qeveria.

Gjithashtu, edhe financimi me *Eurobond* dhe/ose instrumente të tjera alternative nga burime private janë burime potenciale të financimit të huaj në periudhën afatmesme. Megjithatë, madhësia dhe karakteristikat të tjera të këtyre instrumenteve do të përcaktohen vit pas viti në përputhje me nevojat për realizimin e objektivave të mëposhtëm:

- rifinancimin dhe/ose menaxhimin e detyrimeve të borxhit (*liability management*), me qëllim reduktimin e risqeve potenciale që mund të materializohen në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme;

- sigurimin e likuiditetit të nevojshëm (*liquidity management*) për të mundësuar ristrukturimin dhe zhvillimin e tregut të titujve shtetërorë;

- sigurimin e financimit të nevojshëm për rastet kur huamarrja e brendshme tejkalon kapacitetin e tregut (kreu II, nënkapitulli 1.2, paragrafi 3);

- Sigurimin e valutës së nevojshme për të shërbyer detyrimet e borxhit në valutë.

- uljen e presionit për hua në tregun e brendshëm për të mos kufizuar kreditimin e sektorit privat;

- shfrytëzimin e instrumenteve me terma të favorshëm që ofrojnë institucionet financiare ndërkombëtare, me qëllim optimizimin e kostove të portofolit;

- sigurimin e financimit të nevojshëm për të stabilizuar rastet e emergjencave të përkohshme në tregun e brendshëm;

- garantimin e pranisë së vendit në tregjet ndërkombëtare të kapitalit, për të reduktuar primet që mund të burojnë nga vlerësimi jo i saktë i instrumenteve të vendit në mungesë të titujve të tregtueshëm.

*Pavarësisht nga nevoja për realizimin e objektivave të mësipërm, niveli i borxhit në valutë do synohet të evoluojë në përputhje me objektivat për menaxhimin e riskut të kursit të këmbimit (kreu II, seksioni 2.1.2, paragrafi 4)*

## **2.1 Menaxhimi/kontrolli i kostove dhe i risqeve**

### **2.1.1 Kostot**

SAMB 2020–2022 do të ketë në fokus reduktimin e kostove të borxhit, kryesisht në terma afatgjatë. Ulja e ekspozimit ndaj risqeve në portofolin e borxhit do të kontribuojë në reduktimin e primeve të riskut, rrjedhimisht duke ulur kostot për njësi të shërbimit të borxhit. Gjithashtu, ndikim të rëndësishëm në reduktimin e kostove do të ketë edhe zhvillimi i tregut të titujve shtetërorë, që do të synojë të reduktojë primet që aktualisht burojnë nga niveli i ulët i likuiditetit të titujve shtetërorë.

### **2.1.2 Menaxhimi i risqeve**

Në kuadër të menaxhimit të risqeve të portofolit të borxhit, janë përcaktuar disa objektiva operacionalë, realizimi i të cilëve ka për qëllim reduktimin ose mbajtjen nën kontroll të risqeve në periudhën afatmesme.

#### **Risku i rifinancimit**

Është ndër risqet kryesore që mbart portofoli i borxhit të brendshëm, për shkak të nivelit relativisht të lartë të titujve që rifinancohen në periudhën afatshkurtër, të imponuar kryesisht nga kufizimet me natyrë strukturore të tregut të brendshëm. Në këtë aspekt, vlerësohet si i nevojshëm vazhdimi i masave të ndërmarra për reduktimin e mëtejshëm të ekspozimit ndaj këtij risku, duke pasur si objektiv: a) rritjen e përqendrimit të titujve afatmesëm dhe afatgjatë në portofolin e borxhit të brendshëm, nëpërmjet uljes graduale të financimit me tituj afatshkurtër në linjë me hapësirat që mundëson tregu vendës; dhe b) shpërndarjen sa më të njëtrajtshme të profilit të maturimeve, duke vlerësuar mundësinë edhe për përdorimin e ankandëve të parablerjes (*buyback*) dhe shkëmbimit (*exchange*).

**Tabela 2.1.2 (a).** Treguesit indikativë afatmesëm të riskut të rifinancimit

| Tipi i riskut        | Treguesi i riskut                                     | Treguesi 2018 | Objektivi (fondi i 2022-shit) |
|----------------------|-------------------------------------------------------|---------------|-------------------------------|
| Risku i rifinancimit | KMM borxhi i brendshëm                                | 2.2 vite      | 2.2–2.4 vite                  |
|                      | Borxhi i brendshëm i maturuar në 1 vit (% të totalit) | 49.4%         | maks. 45.0%                   |

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Risku i normave të interesit

Është një risk i cili duhet menaxhuar në vijimësi duke pasur parasysh nivelin ende të lartë të borxhit afatshkurtër. Në këtë aspekt, përveç masave për reduktimin e peshës së titujve afatshkurtër, do të synohet dhe mbajtja nën kontroll e peshës së titujve me norma interesi të ndryshueshme, në linjë me hapësirat e tregut dhe preferencat e investitorëve.

**Tabela 2.1.2 (b).** Treguesit indikativë afatmesëm të riskut të normave të interesit

| Tipi i riskut                | Treguesi i riskut                                        | Treguesi 2018 | Objektivi (fondi i 2022-shit) |
|------------------------------|----------------------------------------------------------|---------------|-------------------------------|
| Risku i normave të interesit | KMR borxhi i brendshëm                                   | 2.1 vite      | min. 2.2 vjet                 |
|                              | Borxhi i brendshëm i rivlerësuar në 1 vit (% të totalit) | 54.3%         | maks. 48.0%                   |

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Risku i kursit të këmbimit

Do të synohet të mbahet nën kontroll duke ndërmarrë aktivitete që kanë si objektivi: a) ruajtjen e raportit të stokut të borxhit shtetëror në valutë në raport me totalin e borxhit shtetëror; b) përqendrimin e huamarrjes së huaj në monedhën euro dhe në monedha të përbëra; c) rritjen e stokut të borxhit në valutë (në periudhën afatmesme) në linjë me rritjen e eksporteve dhe rezervës valutore; dhe d) vlerësimin e mundësisë për përdorimin e derivativëve financiarë për të kontrolluar këtë risk në rast se do të jetë e nevojshme.

**Tabela 2.1.2 (c).** Treguesit indikativë afatmesëm të riskut të kursit të këmbimit

| Tipi i riskut              | Treguesi i riskut                        | Treguesi 2018 | Objektivi (fondi i 2022-shit) |
|----------------------------|------------------------------------------|---------------|-------------------------------|
| Risku i kursit të këmbimit | Borxhi në monedhë të huaj (% të totalit) | 47.7%         | maks. 55.0%                   |

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)



### Risku i likuiditetit

Përveç aktiviteteve, në kuadër të reduktimit të riskut të rifinancimit dhe atij të normave të interesit që kanë ndikim mbi riskun e likuiditetit, do të ndërmerren hapa të cilët do të synojnë: a) një bashkëpunim me aktiv ndërmjet strukturës përgjegjëse për menaxhimin e borxhit dhe asaj për menaxhimin dhe parashikimin e të ardhurave në buxhet, me qëllim përmirësimin e menaxhimit të *cash*; b) rritjen e kontributit në drejtim të përmirësimit të menaxhimit të aktiveve dhe pasiveve; dhe c) krijimin gradual të një rezerve në llogarinë e unifikuar të qeverisë duke shfrytëzuar kushtet e favorshme të tregjeve në periudha të caktuara.

### Risku operacional

Reduktimi i riskut operacional lidhet me forcimin e njësisë menaxhuese të borxhit publik që të vazhdojë përpjekjet, në drejtim të: a) mirëpërcaktimit të funksioneve në njësinë e menaxhimit të borxhit; b) standardizimit dhe formalizimit të procedurave në aktivitetet e menaxhimit të borxhit; dhe c) shtimit të burimeve njerëzore, në përputhje me strukturën e miratuar dhe rritjen e kapaciteteve menaxhuese.

### 2.2 Zhvillimi i tregut të titujve shtetërorë

Zhvillimi i tregut të titujve shtetërorë do të synohet të realizohet nëpërmjet aktiviteteve të cilat do të kenë si objektiv: a) rritjen e likuiditetit; b) rritjen e eficiencës; dhe c) rritjen e transparencës.

Realizimi i objektivave të mësipërm është një synim afatgjatë, ndërkohë që zhvillimi i aktiviteteve dhe marrja e masave të ndryshme është një proces i cili ka filluar dhe do të vijojë të kryhet në vazhdimësi.

#### 2.2.1 Rritja e likuiditetit

Marrja e masave dhe zhvillimi i aktiviteteve me fokus rritjen e likuiditetit do të kontribuojnë në eliminimin e primeve të riskut që burojnë nga niveli i kufizuar i likuiditetit të titujve shtetërorë. Gjithashtu, këto aktivitete do të kontribuojnë edhe në rritjen e kërkesës nga ajo pjesë e investitorëve që kanë interes të investojnë në aktive likuide dhe jo në mbajtjen e tyre deri në maturim. Faktorët e mësipërm në periudhën afatmesme dhe afatgjatë pritet të ndikojnë në reduktimin e primeve të normave të interesit, duke ulur rrjedhimisht koston për njësi të borxhit.

Aktivitetet kryesore që planifikohen të ndërmerren në këtë drejtim gjatë periudhës afatmesme janë:

- krijimi i madhësive *benchmark*<sup>14</sup> në kuadër të zhvillimit të kurbës së *yield*-it në drejtim të titujve shtetërorë afatmesëm dhe afatgjatë nëpërmjet rihapjes periodike;

- eliminimi i titujve të cilët kanë karakteristika të ngjashme dhe konkurrojnë njëri-tjetrin me qëllim reduktimin e fragmentimit të kërkesës;

- përshtatja e politikave të huamarrjes (përfshirë shitjen, parablerjen dhe shkëmbimin e titujve shtetërorë) me kushtet e tregut dhe kërkesën për tituj të caktuar.

*Pavarësisht faktit që proceset e mësipërme tashmë konsiderohen aktive, në periudhën afatmesme do të synohet të hartohet një plan veprimi, në të cilin do të mirëpërcaktohen instrumentet e targetuara dhe vlerat indikative, si edhe do të formalizohen rregullat në proceset që kanë të bëjnë me menaxhimin e titujve shtetërorë në tregun primar.*

#### 2.2.2 Rritja e eficiencës

Rritja e eficiencës në tregun e titujve shtetërorë synon uljen e kostove të huamarrjes. Realizimi i këtij objektivi do të përfshijë masa të cilat do të kenë ndikim jo vetëm mbi tregun primar të titujve shtetërorë, por edhe mbi atë sekondar. Masat dhe aktivitetet që planifikohen të ndërmerren do të përfshijnë:

- analizimin e rezultateve të projektit pilot për emetimin e obligacioneve 5-vjeçare dhe 3-vjeçare referencë dhe shqyrtimin e mundësisë për shtrirjen e tij edhe tek titujt e tjerë afatgjatë, në bashkëpunim me aktorët kryesorë të tregut;

- heqjen e kufizimeve teknike dhe përmirësimin e bazës ligjore në tregun e titujve;

- mbajtjen e kontakteve me investitorët për të shkëmbyer informacion dhe për t'u konsultuar në lidhje me iniciativat që do të planifikohen të ndërmerren;

- zgjerimin e mëtejshëm të bazës së investitorëve jo vetëm në drejtim të investitorëve vendës, por edhe në drejtim të investitorëve të huaj, me qëllim ndërtimin gradual të marrëdhënieve dhe promovimin e tregut vendës të titujve shtetërorë;

- pjesëmarrjen aktive në konferenca, në të cilat janë të pranishëm investitorët kryesorë;

<sup>14</sup> Proces në vazhdimësi.



- krijimin e kanaleve të komunikimit elektronik dhe fizik me investitorët vendës dhe të huaj.

### 2.2.3 Rritja e transparencës

Masat dhe aktivitetet e ndërmarra në kuadër të realizimit të këtij objekti do të kontribuojnë në reduktimin e paqartësive dhe rritjen e parashikueshmërisë në tregun e titujve shtetërorë, duke përfshirë:

- komunikimin transparent dhe në kohë të planeve të huamarrjes mujore, tremujore dhe vjetore;

- publikimin e rezultateve të ankandëve në një kohë sa më të shkurtër;

- publikimin në kohë dhe në formate të përpunueshme të informacioneve të nevojshme për kryerjen e parashikimeve të çmimeve në tregun e titujve.

## 2.3 Menaxhimi i borxhit shtetëror të garantuar

### 2.3.1 Kriteret bazë për emetimin e garancive shtetërore

Me qëllim mbajtjen nën kontroll ose reduktimin e riskut që buron nga emetimi i garancive shtetërore, si edhe njëkohësisht shfrytëzimin e avantazheve që burojnë nga përdorimi i këtyre instrumenteve si politika ekonomike shtetërore, në periudhën afatmesme do të zbatohen kriteret e mëposhtme:

- garancitë shtetërore do të emetohen në drejtim të mbështetjes së projekteve me natyrë zhvillimore dhe që mbështesin ngritjen e infrastrukturës, zhvillimin rajonal, mbrojtjen mjedisore dhe krijimin e vendeve të reja të punës;

- garancitë shtetërore mund të emetohen edhe me qëllim që të mbështesin masat që mund të ndërmerren në rastet e ndonjë krize të sistemit financiar;

- ristrukturimi i portofolit të garancive shtetërore nëpërmjet reduktimit ose shkëmbimit të huave të garantuara me nivel të lartë risku potencial (p.sh. garancitë e brendshme që janë emetuar në favor të sektorit të energjisë).

### 2.3.2 Niveli i garancive shtetërore

Niveli vjetor i garancive shtetërore do të përcaktohet në ligjet vjetore të buxhetit. Ndërkohë, në periudhën afatmesme niveli i garancive shtetërore planifikohet të qëndrojë nën 5% të totalit të borxhit të qeverisjes qendrore.

## 2.4 Pritjet e treguesve bazë dhe analiza e ndjeshmërisë

Implementimi i SAMB-së, në përputhje me objektivat e vendosur dhe në linjë me supozimet makrofikale në skenarin bazë, në fund të periudhës afatmesme do të gjenerojë treguesit si më poshtë:

### 2.4.1 Niveli i borxhit të qeverisjes qendrore

Referuar supozimeve sipas të cilave: a) financat publike do të vazhdojnë të ndjekin rrugën e konsolidimit fiskal, duke i dhënë mundësi vendit të mbajë ose përmirësojë vlerësimin e riskut të kreditit; b) ritmet e rritjes ekonomike do të përshpejtohen deri në 4.0% në periudhën afatmesme; dhe c) kursi i këmbimit të monedhës vendëse ndaj monedhës euro do të tentojë të rikthehet drejt vlerave të mesatares historike, rezulton se niveli i borxhit të qeverisjes qendrore në raport me PBB do të vazhdojë të ndjekë trajektoren rënëse që ka nisur që nga viti 2016. Në këto kushte, niveli i borxhit të qeverisjes qendrore në raport me PBB-në parashikohet me rënie duke qenë në linjë me objektivat makrofikale.


Niveli i borxhit në valutë në raport me totalin e borxhit të qeverisjes qendrore gjatë periudhës afatmesme pritet të shoqërohet me një rritje, por duke qëndruar nën kufirin strategjik prej 55%.

### 2.4.2 Shërbimi i borxhit shtetëror

Referuar parashikimeve sipas të cilave: a) normat e interesit gjatë periudhës afatmesme do të shoqërohen me një rritje të moderuar; dhe b) stoku i borxhit në terma bruto do të shoqërohet me rritje në përputhje me nevojat fiskale, rezulton se kostot e borxhit shtetëror<sup>15</sup> në vlerë absolute mund të shkojnë deri në rreth 44.0 miliardë lekë, në fund të vitit 2022. Pavarësisht vlerave në terma absolutë, kostot e borxhit në terma relativë ndaj PBB-së dhe ndaj të ardhurave në buxhet priten të jenë të qëndrueshme dhe nën nivelin mesatar të 5 vjetëve të mëparshëm, duke mbajtur nën kontroll riskun fiskal dhe stabilizuar aftësinë paguese të qeverisë.

<sup>15</sup> U referohet pagesave të interesave të borxhit shtetëror dhe të atyre të borxhit shtetëror të garantuar që paguhen nga buxheti i shtetit, në pamundësi për t'u paguar nga subjektet për të cilat është emetuar garanci.

**Paraqitje grafike 2.4.2.** Pritjet e shpenzimeve për interesa të borxhit shtetëror në terma absolutë dhe relativë ndaj PBB-së dhe të ardhurave tatimore (2019–2022)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

#### 2.4.3 Analiza e ndjeshmërisë


Parashikimet në lidhje me nivelin dhe kostot e borxhit në skenarin bazë mund të jenë objekt ndryshimi, në rast se supozimet makrofiskale dhe ato të treguesve të tregut do të paraqesin ndryshime.

Analiza e mëposhtme paraqet ndjeshmërinë e treguesve kryesorë të borxhit ndaj ndryshimeve të treguesve të tregut, ndërkohë që ndjeshmëria ndaj indikatorëve makrofiskalë është objekt trajtimi i analizave të qëndrueshmërisë së borxhit.

Nënçmimi i mundshëm i monedhës vendëse përtej pritshmërive, kundrejt monedhës euro ose monedhave të tjera që përbëjnë portofolin e borxhit të huaj, do të kishte ndikim mbi trajektoren e nivelit të borxhit, duke ngadalësuar ritmet e uljes së planifikuar. Përveç sa më sipër, nënçmimi i monedhës vendëse do të kishte ndikim edhe mbi koston e borxhit.


Më konkretisht, një nënçmim i monedhës vendëse me 15% ndaj të gjitha monedhave që përbëjnë portofolin e borxhit të jashtëm, duke filluar nga viti 2020, do ta rriste nivelin e borxhit në raport me PBB-në maksimalisht me 4.2 pp dhe në të njëjtën kohë kostot e borxhit mesatarisht me rreth 1.8 miliardë lekë në vit.

**Paraqitje grafike 2.4.3 (a).** Ndjeshmëria e nivelit të borxhit të qeverisjes qendrore në raport me PBB-në ndaj goditjeve në kursin e këmbimit valutë/lekë (2019–2022)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

**Paraqitje grafike 2.4.3 (b).** Ndjeshmëria e kostos së borxhit shtetëror ndaj goditjeve të kursit të këmbimit valutë/lekë (2019–2022)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Në rastin e nënçmimit të monedhës vendëse me 15% vetëm kundrejt monedhës euro (duke përjashtuar efektet e monedhave të tjera që përbëjnë portofolin e borxhit të qeverisjes qendrore), efektet mbi nivelin e borxhit të qeverisjes qendrore në raport me PBB-në dhe koston e tij do të ishin më të moderuara, përkatësisht me rritje deri në 2.7 pp dhe rreth 1.2 miliardë lekë në vit.

Nisur nga niveli i borxhit, si edhe niveli i ekspozimit të riskut, norma e interesit në tregun vendës dhe atë të huaj vlerësohet të jetë një faktor me ndikim të lartë në anën e shpenzimeve të buxhetit të shtetit.

Nga analiza e ndjeshmërisë rezulton, se një rritje e njëkohshme e normave të interesit në tregun vendës dhe atë të huaj me 2 pp mbi normat e pritshme, duke filluar nga viti 2020, mund të rrisë shpenzimet për interesa nga 0.8 miliardë lekë në vitin 2020 deri në 15 miliardë lekë në vitin 2022.

**Paraqitje grafike 2.4.3 (c).** Ndjeshmëria e kostos së borxhit shtetëror ndaj goditjeve të normave të interesit në tregun vendës dhe të huaj (2019–2022)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)


Efekti në rritjen e kostove të borxhit që buron nga rritja e normave të interesit në tregun e brendshëm vlerësohet të jetë rreth 10% më i lartë se ai i normave të interesit në tregjet e huaja, kryesisht për shkak të nivelit relativisht më të lartë të instrumenteve që rifiksojnë normën e interesit në portofolin e borxhit të brendshëm.



**Paraqitje grafike 2.4.3 (d).** Ndjeshmëria e kostos së borxhit të brendshëm shtetëror ndaj goditjeve të normave të interesit (2019–2022)



**Paraqitje grafike 2.4.3 (e).** Ndjeshmëria e kostos së borxhit të jashtëm shtetëror ndaj goditjeve të normave të interesit (2019–2022)



## ANEKS I

### ANALIZA E STRATEGJIVE ALTERNATIVE TË FINANCIMIT

*Analiza e strategjive alternative të financimit është realizuar duke marrë parasysh analizën sasiore (kosto/risk), si edhe vlerësimet dhe kufizimet e parashtruara në nënkapitullin 1.5.*

#### 1. Metodologjia e përdorur në analizën sasiore

##### 1.1 Modeli i përdorur

Analiza sasiore (kosto/risk) e strategjive alternative të financimit është realizuar bazuar në përdorimin e modelit analitik për Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit (MTDS *analytical tool*), i konceptuar nga Banka Botërore dhe FMN për t'i ardhur në ndihmë Menaxhimit të Borxhit të vendeve në zhvillim.

Modeli i përdorur është një model *determinues*, *output*-et e të cilit varen nga vlerat dhe gjendja fillestare e parametrave (parametrat ekzistues të borxhit). Modeli është i ndërtuar në mënyrë të tillë që të projektojë flukset e borxhit në periudhën afatmesme në varësi të *input*-ve që i injektohen modelit në secilën prej strategjive të analizuar. *Output*-i i modelit është vlerësimi i kostos dhe riskut përkatësisht për secilën prej strategjive të analizuar.

##### 1.1.1 *Input*-et

*Input*-et kryesore të përdorura në model janë: i. flukset e borxhit (interesat dhe principli) ekzistues në fundin e vitit 2018; ii. treguesit makrofiksal (balanca primare, PBB, rezerva valutore, eksportet), të cilat orientojnë nevojat për financim të qeverisë dhe paraqesin raporte të caktuara të borxhit; iii. strategjitë alternative të financimit; dhe iv. treguesit e



tregut të tillë si normat e interesit dhe kursi i këmbimit.

*Input*-et për flukset e borxhit ekzistues injektohen në model, pasi paraprakisht grupohen sipas karakteristikave të riskut. Në rastin konkret, flukset e borxhit ekzistues janë grupuar në 15 grupe, përkatësisht 9 grupe për instrumentet në monedhë vendëse (borxhi i brendshëm) dhe 6 grupe për instrumentet në monedhë të huaj (borxhi i jashtëm).

Strategjitë alternative të financimit dallojnë nga njëra-tjetra nga: i. raporti i financimit ndërmjet borxhit të brendshëm dhe të jashtëm; dhe ii. raportet e financimit ndërmjet grupeve me karakteristika risku të ngjashme, përkatësisht për borxhin e brendshëm dhe të jashtëm.

#### 1.1.2 *Output*-i

*Output*-i i modelit të përdorur konsiston në kuantifikimin e kostos dhe të riskut për secilën strategji të analizuar. Modeli ilustron rezultatet që ka secila nga strategjitë e marra në shqyrtim nën efektin e skenarëve të treguesve të tregut, si edhe jep informacion për risqet që do të mbartë struktura e borxhit në fund të periudhës afatmesme për secilën nga strategjitë e konsideruara.

#### 1.1.3 Skenarët

- skenari bazë, përcaktohet si skenari me probabilitetin më të lartë të ndodhisë (skenari më shumë i pritshëm) për secilën nga strategjitë dhe përdoret për të përcaktuar kostot (borxhi/PBB, interesa/PBB etj.);

- skenarët e stresit, përcaktohen si skenarë alternativë dhe krijohen nga goditjet që aplikohen mbi treguesit e tregut (normat e interesit dhe kursin e këmbimit).

Devijimi i kostove në skenarët e stresit nga kostot e skenarit bazë të secilës strategji përcakton nivelin e riskut.

Teorikisht mund të aplikohet një pafundësi skenarësh stresi, ndërkohë që në rastin konkret janë aplikuar dy skenarë stresi për normat e interesit, dy skenarë stresi për kursin e këmbimit dhe një skenar stresi për normat e interesit dhe kursin e këmbimit njëkohësisht. Për skenarët e stresit të normave të interesit janë aplikuar: a) goditje uniforme për të gjitha instrumentet financiare (zhvendosje paralele e kurbës së *yield*-it); dhe b) goditje e diversifikuar

(zhvendosje dhe rritje e pjerrësisë së kurbës së *yield*-it).

#### 1.1.4 Kohështirja

Kohështirja e analizës është marrë 5 vite, me qëllim që secila nga strategjitë e konsideruara të japë efekte të dukshme mbi risqet e strukturës dhe kostot e borxhit. Në periudha më të shkurtra kohore diferencimi i *output*-ve për secilën prej strategjive të analizuar është relativisht i ulët, duke kufizuar identifikimin e ndryshimeve ndërmjet kostove dhe risqeve për secilën nga strategjitë respektive.

### 2. Strategjitë alternative

Në procesin e hartimit të strategjive alternative të financimit, përveç kufizimeve dhe supozimeve të sipërcituara (kreu I, kapitulli 1) është konsideruar edhe materializimi i risqeve sistematike në tregun e brendshëm dhe tregjet ndërkombëtare.

Në këto kushte, janë vlerësuar tri strategji të mundshme financimi, të cilat praktikisht janë të ngjashme në periudhën afatshkurtër, ndërkohë që diferencohen në periudhën afatmesme. Më konkretisht, strategjitë paraqiten si më poshtë:

#### 2.1 Strategjia 1 (bazë)

Supozimet bazë:

- nevojat për financim në periudhën afatmesme janë projektuar në përputhje me bilancin primar të përcaktuar në draftkuadrin makroekonomik dhe fiskal 2021–2023;

- tregu i brendshëm i titujve shtetërorë dhe tregu i jashtëm i kapitaleve supozohet të jenë të qëndrueshëm, duke i mundësuar Republikës së Shqipërisë në periudhën afatmesme akses për huamarrje nëpërmjet burimeve private të financimit qoftë në tregun e brendshëm ashtu edhe atë të jashtëm.

- normat e interesit supozohet të jenë të qëndrueshme në periudhën afatshkurtër, ndërkohë që pritet të rriten në mënyrë të moderuar duke filluar nga viti 2021.

Financimi:

- Financimi i brendshëm, në terma bruto do të plotësojë rreth 80% të nevojave për huamarrje. Nëpërmjet këtij financimi do të mundësohet rifinancimi i titujve ekzistues që maturohen dhe mbulimi i pjesshëm i deficitit buxhetor, duke qenë në përputhje me kapacitetet e tregut. I gjithë financimi i

brendshëm planifikohet të realizohet nëpërmjet burimeve private, ku si instrumente huaje do të përdoren titujt shtetërorë.

Mesatarisht rreth 60% e huamarrjes së brendshme planifikohet të realizohet nëpërmjet titujve afatshkurtër dhe do të shërbejë kryesisht për të rifinancuar maturimin e titujve ekzistues, për të menaxhuar likuiditetin afatshkurtër dhe për të përmirësuar strukturën vjetore të maturimeve.

Pjesa e mbetur e huamarrjes së brendshme (mesatarisht rreth 40%) do të sigurohet nëpërmjet titujve afatgjatë, karakteristikat e të cilëve do të vlerësohen vit pas viti në varësi të realizimit të objektivave strategjikë, kushteve të tregut dhe preferencave të kërkesës.

- Financimi huaj, në terma bruto do të plotësojë deri në 20% të nevojave për huamarrje. Nëpërmjet këtij financimi do të synohet të plotësohet pjesa e mbetur e deficitit buxhetor, si edhe të mundësohet menaxhimi i

detyrimeve të borxhit në valutë. Burimet kryesore të financimit të huaj planifikohen të jenë burimet me natyrë shumëpalëshe, dypalëshe dhe private.

Mesatarisht rreth 60% e financimit të huaj planifikohet të realizohet nëpërmjet kredive nga burimet me natyrë shumëpalëshe dhe dypalëshe. Këto kredi kryesisht do të financojnë projektet me natyrë zhvillimore dhe do të mbështesin buxhetin për reformat e ndërmarrja nga qeveria.

- Rreth 40% e financimit të huaj planifikohet të realizohet nëpërmjet burimeve private, ku si instrument huaje planifikohet të përdoret *Eurobond*-i. Huamarrja nëpërmjet këtyre burimeve do të përdoret kryesisht për të mundur rifinancimin e *Eurobond*-it që maturohet në vitin 2020, si edhe për të menaxhuar detyrimet e borxhit në valutë për të paktën deri në vitin 2021.

#### Paraqitje grafike 2.1. Huamarrja indikative në periudhën afatmesme 2020–2022

|                                             | Huamarrja bruto 2020–2022<br>(në % të totalit të huamarrjes) |
|---------------------------------------------|--------------------------------------------------------------|
| <b>Huamarrja e brendshme</b>                | <b>min 80%</b>                                               |
| - tituj shtetërorë afatshkurtër             | rreth 50%                                                    |
| - tituj shtetërorë afatgjatë, nga të cilët: | rreth 30%                                                    |
| <i>Tituj në monedhë vendëse</i>             | rreth 27%                                                    |
| <i>Tituj në valutë</i>                      | rreth 3%                                                     |
| <b>Huamarrja e huaj</b>                     | <b>max 20%</b>                                               |
| - hua për financim projektësh               | rreth 8%                                                     |
| - hua për mbështetje buxhetore              | rreth 4%                                                     |
| - <i>Eurobond</i>                           | rreth 8%                                                     |
| - instrumente të tjera                      | -                                                            |

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Çfarë pritet të përmbushë strategjia

Implementimi i strategjisë 1 në linjë me indikacionet e mësipërme do të rezultonte, në:

- përmbushjen e nevojave për financim të qeverisë qendrore në përputhje me projeksionet e draft Kuadrit Makroekonomik dhe Fiskal 2021–2023 (kreu II, nënkapitulli 1.1);

- reduktimin e riskut të rifinancimit dhe riskut të normave të interesit të borxhit të brendshëm shtetëror në përputhje me objektivat strategjikë (kreu II, nënkapitulli 2.1);

- mbajtjen nën kontroll të riskut të kursit të këmbimit në përputhje me objektivin strategjik për

të ruajtur nivelin e borxhit në valutë brenda kufijve indikativ (kreu II, nënkapitulli 2.1);

- sigurimin e burimeve të nevojshme në valutë për të shërbyer detyrimet e borxhit të huaj;

- raport kosto/risk relativisht më të favorshëm krahasuar me strategjitë e tjera alternative, për shkak të mirëdiversifikimit të burimeve të financimit;

- mbajtjen e nivelit të huamarrjes së brendshme brenda kapaciteteve që disponon tregu i brendshëm, duke i dhënë hapësirë kreditimit të sektorit privat.



- krijimin e hapësirës së nevojshme për zhvillimin e mëtejshëm të tregut primar të titujve shtetërorë.

#### Risqet

- Kjo strategji është e ekspozuar ndaj risqeve sistemike të tregjeve ndërkombëtare, materializimi i të cilave do të shoqërohej me rritje të kostove të huamarrjes.

### 2.2 Strategjia 2 (alternative)

#### Supozimet bazë

Kjo strategji supozon materializimin e risqeve sistemike të tregjeve ndërkombëtare të kapitalit, duke kufizuar dhe shtrenjtuar sigurimin e financimit nëpërmjet burimeve të huaja. Në këto kushte, financimi në periudhën 2020–2022 në dallim nga Strategjia 1 (bazë) do të mbështetej më shumë në burimet e brendshme (dhe/ose në ndonjë burim alternativ të akorduar nga institucionet ndërkombëtare financiare), duke tejkaluar ndjeshëm kapacitetet e tregut të brendshëm.

#### Financimi

- Financimi nëpërmjet burimeve të brendshme do të mundësojë rëfinancimin e titujve ekzistues që maturohen dhe do të financojë për periudhën 2020–2022 në terma neto rreth 10–15 miliardë lekë mbi kapacitetin optimal të tregut.

- Financimi i huaj do të mbështetet tek burimet shumëpalëshe dhe dypalëshe të planifikuara, të cilat do të financojnë projektet dhe mbështesin reformat e qeverisë.

#### Avantazhet

- Ka një ekspozim më të ulët ndaj riskut të kursit të këmbimit krahasuar me Strategjinë 1 (bazë).

#### Risqet

- Rrit ndjeshëm ekspozimin ndaj riskut të rëfinancimit, riskut të likuiditetit, riskut të normave të interesit, si edhe risqeve sistemike të tregut të brendshëm, duke ndikuar negativisht në realizimin e objektivave strategjike për përmirësimin e strukturës së borxhit të brendshëm.

- Niveli i lartë i huamarrjes në tregun e brendshëm do të ushtrojë presion rritës mbi normat e interesit të titujve shtetërorë. Kostot e borxhit tentojnë të jenë në nivele të krahasueshme<sup>16</sup> me Strategjinë 1 (bazë) në

periudhën afatshkurtër, ndërkohë në periudhën afatmesme kjo strategji tenton të bëhet më e kushtueshme, për shkak të primeve që burojnë nga niveli në rritje i risqeve në portofolin e borxhit të brendshëm.

- Nuk krijon burime të mjaftueshme në valutë për të shërbyer detyrimet e borxhit të huaj.

- Rrit ndërhyrjen e shtetit në tregun e këmbimit valutor, duke qenë se të hyrat në valutë nëpërmjet huamarrjes së huaj janë të kufizuara.

- Akumulon burimet e brendshme të financimit duke kufizuar kreditimin e sektorit privat.

### 2.3 Strategjia 3 (alternative)

#### Supozimet bazë

Kjo strategji supozon materializimin e risqeve sistemike në tregun e brendshëm<sup>17</sup>, duke e ulur aftësinë e qeverisë për të marrë hua në tregun e brendshëm, si edhe duke rritur kostot e huamarrjes së brendshme. Në këto kushte, në periudhën 2020–2022 financimi i huaj, nëpërmjet burimeve me terma tregtarë, do të rritej duke tejkaluar ndjeshëm kufijtë referencë.

#### Financimi

- Financimi nëpërmjet burimeve të brendshme do të mundësojë rëfinancimin e pjesshëm të titujve ekzistues, që maturohen duke krijuar një hendek financimi në tregun e brendshëm nga 30 deri në 50 miliardë lekë.

- Financimi i huaj, përveç burimeve të planifikuara që do të financojnë projektet dhe mbështesin reformat, do të plotësohet me emetimin e një ose më shumë instrumenteve financiare në tregjet ndërkombëtare për të mundësuar: 1. Plotësimin e hendekut të krijuar në tregun e brendshëm; 2. Shërbimin e detyrimeve të borxhit në valutë; si edhe 3. Menaxhimin e nevojave për likuiditet në periudhën afatmesme.

#### Avantazhet

- Praktikisht, kjo është një strategji e imponuar nga kushtet e tregjeve dhe nuk ofron asnjë avantazh krahasuar me strategjitë e tjera.

#### Risqet

- Ka kosto relativisht të larta të imponuara nga kufizimi i kërkesës në tregun e brendshëm, si edhe

---

huamarrja shtesë në tregun e brendshëm do të realizohet, pjesërisht me instrumente afatshkurtra, ndërkohë që në Strategjinë 1 (bazë) realizohet tërësisht me instrumente afatgjata, në përputhje me objektivat strategjike.

<sup>17</sup> P.sh., një krizë e një ose disa bankave të cilat zotërojnë një pjesë të konsiderueshme të titujve shtetërorë.

<sup>16</sup> Kostoja jo shumë e lartë e kësaj strategjie në raport me Strategjinë 1 (bazë) është e lidhur me faktin që Faqe|14892



nga primet e riskut që mund të perceptohen nga investitorët e huaj.

- Rrit ndjeshëm varësinë e financimit nga tregjet e huaja, si edhe rrit ekspozimin ndaj riskut të rfinansimit dhe riskut të normave të interesit në portofolin e borxhit të huaj.

- Ul aftësinë për të vijuar me procesin e ristrukturimit të portofolit të borxhit të brendshëm dhe realizimin e objektivave strategjikë në kuadër të reduktimit të riskut të rfinansimit dhe riskut të normave të interesit.

- Rrit nivelin e borxhit në valutë dhe ekspozimin ndaj riskut të kursit të këmbimit përtej kufijve strategjikë duke rrezikuar qëndrueshmërinë e borxhit publik në periudhën afatgjatë.

## ANEKS II

### AKRONIME DHE FJALOR TEKNIK

AMFAutoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

**ASPA**Albanian School of Public Administration  
(Shkolla Shqiptare e Administratës Publike)

**BB**Banka Botërore

**BE**Bashkimi Evropian

**BKT**Banka Kombëtare Tregtare

**BQE**Banka Qendrore Evropiane

**BSH**Banka e Shqipërisë

**EUR**Monedha e Bashkimit Evropian

**FMN**Fondi Monetar Ndërkombëtar

**INSTAT**Instituti i Statistikave

**KMM**Koha Mesatare në Maturim

**KMR**Koha mesatare në rivlerësim

**LEK**Monedha vendëse

**NPL**Non Performing Loans (kredi me probleme)

**PBB**Prodhimi i Brendshëm Bruto

**PBG**Policy Based Guarantee (Garanci e bazuar në politikë)

**PB**Pikë bazë

**PP**Pikë përqindje

**SAMB**Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit

**US**Monedha kombëtare e Shteteve të Bashkuara të Amerikës

**YEN**Monedha kombëtare e Japonisë

**YMP**Yield-i mesatar i ponderuar

**“Ankande shkëmbimi (exchange auctions)”**, parablerja e titujve shtetërorë përpara datës së maturimit, ndërkohë që transaksioni kryhet duke e paguar mbajtësin e titullit të parablerë me një titull të emetuar rishtazi.

**“Borxh”**, referuar si “borxh total” ose “totali i detyrimeve të borxhit”, konsiston në të gjitha detyrimet që janë instrumente borxhi.

**“Borxh afatgjatë”**, borxh me afat maturimi më të lartë se një vit.

**“Borxh i brendshëm”**, detyrimet e borxhit të rezidentëve të një vendi ndaj rezidentëve të po atij vendi.

**“Borxh i jashtëm”**, detyrimet e borxhit të rezidentëve të një vendi ndaj jorezidentëve.

**“Borxhi publik i garantuar”**, detyrimet e borxhit të sektorit publik dhe privat, shërbimi i të cilit është i garantuar me marrëveshje nga njësitë e sektorit publik.

**“Buyback”** është forma e ndërsjellë e emetimit të titujve shtetërorë, e cila mundëson maturimin e parakohshëm të një titull shtetëror.

**“Disbursim”**, transaksioni i vënies në dispozicion të burimeve financiare.

**“Eurobond”**, një obligacion (titull financiar) me afat maturimi më shumë se një vit i emetuar dhe tregtuar në tregjet ndërkombëtare financiare, jashtë kufijve të vendit që e emeton atë.

**“Kreditor dypalësh”**, tipi i kreditorëve si qeveritë dhe agjencitë e tyre.

**“Kredi koncesionale”**, kredi me terma më të favorshëm se ato të tregut.

**“Kreditor shumëpalësh”**, tipi i kreditorëve që përfshinë institucionet financiare, si: Banka Botërore, FMN etj.

**“Kreditorë privatë”**, kreditorët që nuk janë as qeveri dhe as agjenci të sektorit publik. Këta përfshijnë mbajtësit privatë të titujve shtetërorë, bankat private dhe institucionet e tjera financiare.

**“KMM”**, Tregues i riskut të rfinansimit për borxhin. KMM-ja është periudha mesatare e shprehur në ditë ose në vite, që i duhet portofolit të borxhit për t’u maturuar. Sa më larg në kohë të jetë e projektuar data e maturimit të një instrumenti, aq më i ulët është risku i rfinansimit dhe aq më e lartë është vlera e këtij treguesi. KMM-ja për instrumentet financiare të borxhit përllëgaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$KMM = \frac{\sum_{t \in T} t Nt}{\sum_{t \in T} Nt}$$

Nga ku:

t – data e maturimit;

T – bashkësia e të gjitha datave të maturimit;



Nt – Vlera nominale që do të paguhet në datën t.

**“KMR”**, tregues i riskut të normave të interesit për borxhin. Jep informacion lidhur me ekspozimin e portofolit të borxhit kundrejt ndryshimit të normave të interesit. KMR-ja interpretohet si koha mesatare (në vite) që i duhet portofolit të borxhit për të ripërcaktuar normën e interesit. Sa më e madhe të jetë sasia e instrumenteve afatshkurtra dhe sasia e instrumenteve me norma interesi të ndryshueshëm në portofolin e borxhit, aq më i madh është risku i normave të interesit dhe aq më i vogël ky tregues dhe anasjelltas. KMR-ja për instrumentet financiare të borxhit përllogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$KMR = \frac{\sum_{r \in R} r N_r + \sum_{t \in T} t N_t}{\sum_{r \in R} N_r + \sum_{t \in T} N_t}$$

Nga ku:

r – data e pagesës së kuponit të instrumentit me norma interesi të lëvizshme;

t – data e maturimit të instrumentit me norma interesi fikse;

Nr – vlera nominale e instrumentit me norma interesi të lëvizshme;

Nt – vlera nominale e instrumentit me norma interesi fikse;

R – bashkësia e të gjitha datave të maturimit për instrumente me norma interesi të lëvizshme;

T – bashkësia e të gjitha datave të maturimit për instrumente me norma interesi fikse.

**“PBG”** është garanci e emetuar nga Banka Botërore, e cila garanton vlerën e plotë ose të pjesshme të një huaje, me qëllim mundësimin e saj me kosto më të favorshme se ajo e ofruar nga tregu.

**“Raport mbulimi”**, raporti ndërmjet shumës së kërkuar (nga investitorët) dhe shumës së ofruar (nga shteti) në ankandet e titujve shtetërorë. Shërben për të vlerësuar nivelin e plotësimit të ankandëve dhe gjendjen e likuiditetit.

**“Risku i kursit të këmbimit”** i referohet ndikimit të lëvizjes së kursit të këmbimit të një monedhe, mbi nivelin e borxhit dhe shërbimin e tij në një masë të caktuar mbi pritshmëritë. P.sh., “Mbiçmimi ose nënçmimi i monedhës vendëse kundrejt një monedhe të huaj, e cila është pjesë

përbërëse e portofolit të borxhit, mund të rezultojë në rënie ose rritje proporcionale të volumit të borxhit ose shërbimit të tij (të denominuar në monedhë vendëse)”.

**“Risku i likuiditetit”**, risku që lidhet me humbjen e aftësisë së buxhetit të shtetit për të likuiduar detyrimet korrente dhe ekzekutimin në kohë të shpenzimeve buxhetore. Me qëllim minimizimin e këtij risku, shteti duhet të ketë akses mbi një sasi të caktuar asetesh likuide me qëllim garantimin e fondeve në raste krizash të përkohshme, gjatë të cilave bëhet e vështirë ose me kosto të lartë, sigurimi i tyre.

**“Risku i normave të interesit”**, risku që pagesat e shërbimit të borxhit të ndryshojnë si rrjedhojë e lëvizjes së normave të interesit. Ky risk krijohet nga nevoja për të shërbyer borxhin që maturohet dhe pagesat e kuponëve të instrumenteve me norma interesi të ndryshueshme në të ardhmen.

**“Risku operacional”**, risku që ka të bëjë me rritjen e kostonë së menaxhimit të borxhit ose me rritjen e nivelit të risqeve të tjera si rezultat i gabimeve njerëzore, dëmtimit të pajisjeve elektronike, dëmeve natyrore etj. Risku operacional është një risk relativisht i vështirë për t’u matur dhe vlerësuar. Ulja e ekspozimit të riskut operacional mund të arrihet nëpërmjet integritetit të procedurave të menaxhimit të borxhit në një strukturë organizative, duke pasur strukturën, infrastrukturën dhe procedurat të drejtuara nga aktivitete operationale eficiente për menaxhimin e administratës shtetërore dhe tregjeve financiare.

**“Risku i rifinancimit”**, risku që lidhet me aftësinë për të emetuar instrumente ose marrë hua, me qëllim rifinancimin dhe shërbimin e borxhit aktual. Sa më i madh të jetë volumi i shumave që maturohen dhe sa më i afërt në kohë, aq më i lartë është risku i rifinancimit dhe anasjelltas. Risku i rifinancimit ndikohet nga niveli i borxhit ekzistues dhe profili i amortizimit. Rritja e maturitetit të borxhit dhe shpërndarja në kohë e maturimeve ndikon në reduktimin e riskut të rifinancimit.

**“Stoku i borxhit”**, balanca e principalit të borxhit në një moment të dhënë të kohës.

**“Shërbim borxhi”**, pagesat e principalit dhe interesit në përputhje me termat e përcaktuar në marrëveshje.

**“Sistemi Primary Dealer”** është një marrëveshje institucionale ndërmjet strukturës





përgjegjëse për menaxhimin e borxhit dhe disa ndërmjetësve financiarë (që kanë funksione të specializuara në tregun e titujve shtetërorë), me qëllim zbatimin e një strategjie që ka për funksion sigurimin e nevojave për financim të qeverisë dhe zhvillimin e tregut të titujve.

**“Tregu primar”** është hapësira fizike ose funksionale në të cilin shteti shqiptar emeton për herë të parë titujt.

**“Tregu sekondar”** është hapësira fizike ose funksionale ku kryhen transaksionet me titujt pasi janë emtuar në tregun primar.

**“Tituj afatmesëm”**, u referohet titujve të borxhit shtetërorë me afat maturimi nga 2 deri në 5 vite.

**“Tituj afatgjatë”** u referohen titujve të borxhit shtetërorë me afat maturimi mbi 5 vjet.

**“Tituj referencë (benchmark)”** është emetimi më i fundit i titujve të shtetit shqiptar për një maturitet të caktuar. Ankandi për titullin referencë mund të rihapet periodikisht deri në arritjen e një vlere të paracaktuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Ky titull përdoret si pikë referimi për vlerësimin e titujve të tjerë shtetërorë me maturitet, shumë emetimi dhe normë kuponi të ngjashëm.

Përgjithësisht, titujt referencë gëzojnë likuiditet më të lartë se emetimet e zakonshme, për shkak të detyrimit që kanë zhvilluesit e tregut për të kuotuar çmime blerjeje/shitjeje në tregun sekondar, sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e lidhur me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

**“Tituj shtetërorë”** janë bonot e thesarit dhe obligacionet shtetërore të emtuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në përputhje me ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjin nr. 9879, datë 21.2.2008, “Për titujt”; si edhe aktet nënligjore.

### ANEKS III INFORMACIONE SHITESË

1. Baza ligjore dhe aktet nënligjore në kuadër të menaxhimit të borxhit publik:

- ligji nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 181/2014, datë 24.12.2014;

- ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012, datë 7.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016;

- ligji nr. 9869, datë 4.2.2008, “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”, i ndryshuar me ligjin nr. 68/2017, datë 27.4.2017;

- ligji nr. 43/2016, datë 21.4.2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”;

- ligji nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

- ligji vjetor i buxhetit;

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 775, datë 24.9.2010, “Për administrimin e financimeve të huaja në Republikën e Shqipërisë”;

- udhëzimi i ministrit të financave nr. 22, datë 5.10.2011, “Për publikimin e të dhënave të borxhit të qeverisjes së përgjithshme dhe hartimin e raportit të tij”;

- udhëzimi i ministrit të financave nr. 30, datë 26.12.2013, “Për emetimin nga qeveria e Republikës së Shqipërisë, të bonove të thesarit në formë regjistrimi”;

- udhëzimi i ministrit të financave nr. 31, datë 26.12.2013, “Për emetimin nga qeveria e Republikës së Shqipërisë, të obligacioneve në formë regjistrimi”, i shtuar me udhëzimin e ministrit të financave dhe ekonomisë nr. 21, datë 22.6.2018;

- udhëzimi i ministrit të financave nr. 35, datë 5.11.2008, “Për zbatimin e ligjit nr. 9869, datë 4.2.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”;

- udhëzimi i ministrit të financave nr. 36, datë 10.8.2009, “Për hartimin e regjistrit të borxhit shtetëror dhe garancive shtetërore të huas”;

- marrëveshja ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, datë 20.1.2015, “Për organizimin e ankandëve të titujve të shtetit shqiptar, shlyerjen e veprimeve dhe mbajtjen e regjistrit të këtyre titujve”, ndryshuar në datën 6.7.2018 (BSH: nr. 3632 prot., MFE: nr. 12981 prot.).

2. Publikime periodike të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në lidhje me borxhin

- Buletini i Borxhit Publik:  
<http://www.financa.gov.al/al/raportime/borxhi/treguesit-e-borxhit>



- Regjistri i Emetimeve të Borxhit Publik:  
<http://www.financa.gov.al/al/raportime/borxhi/registri-i-borxhit>

- Informacion mbi ankandet e emetimit të titujve shtetërorë të qeverisë:  
<http://www.financa.gov.al/al/raportime/borxhi/ankandet-e-emetimit-te-letrave-me-vlere-te-qeverise>

## VENDIM

Nr. 860, datë 24.12.2019

### **PËR FUNKSIONIMIN, KOHËZGJATJEN, ORGANIZIMIN DHE DETYRAT E KOMISIONIT PËR SKEMAT E CILËSISË SË PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE USHQIMORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 8/2019, “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

### **I. Organizimi i Komisionit të Skemave të Cilësisë**

1. Anëtarët e Komisionit të Skemave të Cilësisë (KSC) së produkteve bujqësore dhe ushqimore emërohen dhe shkarkohen me urdhër të ministrit. Emërimi i anëtarëve të KSC-së bëhet për një periudhë 3-vjeçare, me të drejtë riemërimi. Propozimet për ministrin, lidhur me emërimin e anëtarëve të KSC-së, bëhen në vijim të një procedure konkurrimi, bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët në ministri, si më poshtë vijon:

- a) kërkesë për kandidim si anëtar i KSC-së;
- b) dokumenti i identifikimit;
- c) master shkencor ose të barasvlershëm me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- d) librezë, e cila vërteton eksperiencën në punë;
- dh) certifikata trajnimit dhe çdo dokument tjetër që provon kontributin dhe njohuritë në fushën e skemave të cilësisë të produkteve bujqësore e ushqimore.

Dokumentacioni duhet të shoqërohet me informacion mbi adresën, si dhe çdo mjet tjetër kontakti.

Dokumentet e përcaktuara në shkronjat “b”, “c” “ç” dhe “dh”, të kësaj pike, duhet të jenë origjinale ose të noterizuar.

2. Në rast të mungesës së ndonjë dokumenti, struktura përgjegjëse për skemat e cilësisë (më poshtë struktura përgjegjëse) në ministri, njofton kandidatin, i cili brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e njoftimit, plotëson kërkesën. Nëse edhe pas kërkesës për plotësim ka mungesa në dokumentacion, kërkesa nuk do të shqyrtohet.

3. Struktura përgjegjëse përgatit një raport për kandidatët për anëtarë të KSC-së, që plotësojnë kërkesat e pikës 1, të këtij vendimi, dhe ia dërgon për miratim ministrit, i cili miraton me urdhër anëtarët e KSC-së.

4. Shkarkimi i anëtarit të KSC-së, përpara mbarimit të mandatit, bëhet me urdhër të ministrit, për një nga arsyet e mëposhtme:

a) nëse nuk paraqitet në tre mbledhje të njëpasnjëshme të KSC-së dhe nuk paraqet justifikime të provuara për këto mungesa;

b) kur i është ndaluar ushtrimi i profesionit me vendim gjyqësor të formës së prerë.

5. Mandati i anëtarit të KSC-së mbaron kur:

- a) përfundon mandati;
- b) jep dorëheqjen.

6. Anëtar i KSC-së që jep dorëheqjen është i detyruar të paraqesë kërkesën me shkrim për dorëheqje dhe arsyet e dorëheqjes, të paktën një muaj përpara datës së shkarkimit nga detyra, përveç rastit kur provon ose vërtetohet se kjo nuk ka qenë e mundur.

7. Struktura përgjegjëse merr masa për zëvendësimin sa më shpejt të anëtarit të shkarkuar nga detyra, duke bërë njoftimin në faqen e internetit të ministrisë. Për këtë qëllim, kjo strukturë përgatit një raport për kandidatët për anëtarë të KSC-së, që plotësojnë kërkesat e pikës 1 të këtij vendimi, dhe ia dërgon për miratim ministrit. Mandati i anëtarit të ri është trevjeçar, me të drejtë riemërimi.

### **II. Funksionimi i Komisionit të Skemave të Cilësisë**

1. Mbledhjet e KSC-së thirren nga kryetari, si rregull 1 herë në muaj, në bazë të informacionit të marrë nga struktura përgjegjëse. Komisioni mund të mbledhet edhe kur shumica e anëtarëve paraqesin kërkesë me shkrim duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje.





2. Kryetari dhe sekretari zëvendësohen përkohësisht, përkatësisht, nga anëtari më i vjetër dhe nga anëtari më i ri në detyrë, që të dy me të drejtë vote.

3. Anëtarët e KSC-së njoftohen nga sekretari i KSC-së, nëpërmjet postës elektronike, për datën dhe agjendën paraprake të mbledhjes, të paktën 7 (shtatë) ditë pune përpara ditës së mbledhjes.

4. Në raste urgjente dhe të jashtëzakonshme, kryetari mund të thërrasë një mbledhje të KSC-së brenda një periudhe më pak se 7 (shtatë) ditë pune nga dita e mbledhjes së KSC-së.

5. Kryetari mund të paraqesë në rendin e ditës të mbledhjes çështje të tjera që nuk janë të përfshira në agjendën e paraqitur paraprakisht, nëse të gjithë anëtarët janë të pranishëm.

6. Kuorumi i nevojshëm për realizimin e mbledhjes së KSC-së realizohet kur marrin pjesë të paktën 4 prej anëtarëve, përfshirë dhe kryetarin.

7. Mbledhjet e KSC-së nuk janë publike.

8. Kryetari dhe anëtarët janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e informacionit rreth kërkesave për regjistrim, kërkesave për ndryshimin e specifikimeve, vërejtjeve dhe kundërshtimeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

9. Vendimet e KSC-së i dërgohen ministrit për miratim, sipas afateve të përcaktuara në ligj.

10. Procedura për mbledhjen e KSC-së është si më poshtë vijon:

a) Çelet nga kryetari, i cili kërkon aprovimin e agjendës paraprake me ndryshimet (nëse ka);

b) Sekretari paraqet verbalisht përpara KSC-së një pasqyrë të përmbledhur të kërkesave të palëve, të fakteve dhe të provave të depozituara, para fillimit të shqyrtimit të çështjeve dhe mban procesverbalin e mbledhjes dhe të diskutimeve të anëtarëve;

c) KSC-ja, nën drejtimin e kryetarit, shtron për diskutim, me radhë, të gjitha çështjet që janë vendosur në agjendë;

ç) Kryetari i fton anëtarët të votojnë, në përfundim të të gjithë procedurës së shqyrtimit dhe të shkëmbimit të opinioneve. Asnjë nga anëtarët nuk mund të abstenojë nga vendimmarrja. Votimi është i hapur në të gjitha rastet. Mendimi i anëtarit të mbetur në pakicë, i parashtruar me shkrim, bashkohet me vendimin dhe nënshkruhet me fjalën “kundër”;

d) Vendimet e KSC-së miratohen me shumicë të thjeshtë të votave, të anëtarëve të pranishëm;

dh) Në rast se rreth një çështjeje votimi është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare;

e) Vendimi i KSC-së bëhet publik në faqen e internetit të ministrisë;

ë) Kryetari merr masa që në fund të takimit të përgatisë vendimin e arsyetuar, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në votimin e tij. Një kopje e vendimit i dorëzohet sekretarit për t’ia bashkëlidhur dosjes së çështjes;

f) Procesverbalin, mbasi u bëhet i ditur anëtarëve të KSC-së, firmoset nga kryetari dhe sekretari, brenda dy ditëve nga data e mbledhjes;

g) Dokumentacioni i prodhuar gjatë gjithë procedurës i nënshtrohet rregullave në fuqi për arkivin.

### III. Detyrat e Komisionit të Skemave të Cilësisë

1. Detyrat e kryetarit të KSC-së (më poshtë kryetari), përfshijnë:

a) organizimin dhe drejtimin e punës së KSC-së;

b) thirrjen e mbledhjeve të KSC-së;

c) kryesimin e mbledhjeve të KSC-së;

ç) përcaktimin e agjendës paraprake të mbledhjeve të KSC-së;

d) monitorimin e afateve procedurale dhe në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse, monitorimin e afateve lidhur me aplikimet në zbatim të ligjit dhe të këtij vendimi;

dh) përfaqësimin e KSC-së.

2. Detyrat e anëtarëve të KSC-së përfshijnë:

a) vlerësimin e aplikimeve për regjistrim të emërimit STG;

b) vlerësimin për aplikimet për ndryshimin e specifikimeve të produktit me emërtimin STG;

c) vlerësimin për kundërshtimet e aplikimeve, për regjistrim për emërtimin STG dhe kundërshtimet për specifikimet e produktit, për emërtimet EOM, TGJM;

ç) vlerësimin e përputhshmërinë me specifikimet e produktit, për kërkesat për regjistrim të EO-ve dhe TGJ-ve, për produktet bujqësore dhe ushqimore.

d) vlerësimin për kundërshtimet e ndërsjella në BE;

dh) pjesëmarrjen në mbledhjet e KSC-së;

e) pjesëmarrjen në diskutimin e çështjeve, sipas agjendës së paraqitur në njoftimin e mbledhjes;

ë) marrjen e vendimeve.

3. Struktura përgjegjëse, në zbatim të këtij vendimi, me qëllim mbarëvajtjen e KSC-së, përveç



detyrave të përcaktuara në ligj, kryen edhe detyrat, si më poshtë vijon:

a) merr masat për sigurimin e logistikës së nevojshme për realizimin e mbledhjeve të KSC-së;

b) ndjek ekzekutimin e vendimeve të KSC-së dhe dërgimin zyrtar të vendimeve në adresat përkatëse, duke njoftuar KSC-në, lidhur me dërgimin zyrtar të vendimeve në destinacion;

c) përgatit njoftimet e KSC-së, që nënshkruhen nga kryetari për palët, lidhur me paraqitjen e argumenteve, prapësimeve dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm të përcaktuar në ligj dhe në këtë vendim.

4. Mbledhjet e KSC-së asistohen nga sekretari, i cili është anëtar i komisionit dhe ushtron këto detyra:

a) është përgjegjës për dosjet e kërkesave të depozituara nga struktura përgjegjëse, për shqyrtim pranë Komisionit, si kërkesat për regjistrim, kërkesat për të ndryshuar specifikimet, për vërejtjet ose kundërshtimet;

b) u komunikon anëtarëve me *e-mail*, orën dhe datën e mbledhjes, së bashku me rendin e ditës;

c) mban procesverbalin e mbledhjes dhe kryen detyra të tjera të ngarkuara nga KSC-ja;

ç) mban të gjithë dokumentacionin e KSC-së, ku përfshihen edhe kërkesat për regjistrim, kërkesat për të ndryshuar specifikimet, për vërejtjet ose kundërshtimet.

#### IV. Dispozitë e fundit

Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**

#### VENDIM

Nr. 862, datë 24.12.2019

### PËR KËRKESAT MINIMALE TË MBROJTJES SË SHËNDETIT DHE TRAJTIMIN MJEKËSOR NË BORDIN E MJETEVE LUNDRUESE<sup>18</sup>

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 23, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

#### I. Qëllimi dhe fusha e zbatimit

1. Ky vendim rregullon kërkesat minimale të mbrojtjes së sigurisë dhe të shëndetit, si dhe të ofrimit të kujdesit shëndetësor për punëmarrësit në bordin e mjeteve që lundrojnë me flamur shqiptar ose që janë të regjistruara në Regjistrin e Mjeteve Lundruese Shqiptare.

2. Kërkesat e këtij vendimi nuk zbatohen për mjetet e lundrimit të listuar, si më poshtë vijon:

a) anijet luftarake;

b) mjetet e kënaqësisë për qëllime jotregtare dhe që nuk drejtohen nga një ekuipazh i kualifikuar;

c) mjetet lundruese për shërbime portuale;

ç) anijet që lundrojnë në ujërat e brendshme.

3. Për qëllime të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

a) “Mjet lundrimi”, përfshin çdo mjet që lundron me flamur shqiptar ose është regjistruar nën juridiksionin e tij të plotë, me përjashtim të mjeteve lundruese të listuar në pikën 2, të seksionit I, të këtij vendimi. Mjetet lundruese klasifikohen në tri kategori, të përcaktuara në shtojcën I, të këtij vendimi.

b) “Punëmarrës”, përfshin çdo person që ka një detyrë në bordin e mjetit lundrues, duke përfshirë kursantët dhe stazhierët, por me përjashtim të pilotit portual dhe të personelit në tokë, që kryen punë në bordin e një mjeti lundrues në mol.

c) “Pronar”, përfshin pronarin e regjistruar të

<sup>18</sup> Ky vendim i Këshillit të Ministrave përafuron pjesërisht direktivën e Këshillit 92/29 /EEC, të datës 31 mars 1992, në lidhje me kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit, për përmirësimin e trajtimit mjekësor në bordin e mjeteve të lundrimit.



një mjeti lundrues, përveç rasteve kur mjeti është marrë me qira apo menaxhohet, tërësisht apo pjesërisht, nga një person fizik apo juridik, i ndryshëm nga pronari i regjistruar, sipas parashikimeve të marrëveshjes së menaxhimit. Në këtë rast pronari është marrësi me qira, personi fizik apo juridik, që menaxhon mjetin lundrues.

ç) “Materiale për konsum mjekësor”, përfshin barnat, pajisjet mjekësore dhe kundërhelmet. Një listë joshteruese e materialeve për konsum mjekësor përcaktohet në shtojcën II, të këtij vendimi.

d) “Kundërhelm”, përfshin çdo substancë të përdorur për parandalimin apo trajtimin e efektit apo të efekteve të dëmshme, të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë, të një apo më shumë substancave të përfshira në listën e substancave të rrezikshme, të përcaktuara në shtojcën III, të këtij vendimi.

dh) “Mjet shpëtimi”, përfshin zadrat dhe barkat e shpëtimit që ndodhen në bordin e mjetit lundrues, që shërbejnë për evakuimin e personave në bordin e mjetit lundrues, në raste rreziku.

e) “Tepricat nga ngarkesat”, përfshin tepricat nga ngarkesat detare, përfshirë mbetjet e çdo lloji të ngarkesës në bord, nga mbajtëset e ngarkesave ose cisternat, të cilat teprojnë pas përfundimit të procedurave të shkarkimit dhe pastrimit.

ë) “*GT-Gross Tonnage*”, përfshin tonazhin bruto të mjetit lundrues, sipas Konventës Ndërkombëtare të Tonazhit, aderuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8989, datë 23.1.2003.

f) “Kontrolli shtetëror i flamurit”, strukturë në përbërje të administratës detare, në zbatim të ligjit për administratën detare.

## **II. Materialet për konsum mjekësor dhe trajtimi mjekësor**

1. Çdo mjet që lundron me flamur shqiptar ose është i regjistruar në Regjistrin e Mjeteve Lundruese Shqiptare, mban gjithmonë në bord materiale mjekësore, të cilat përmbushin, të paktën, nga pikëpamja cilësore, specifikimet e përcaktuara në shtojcën II, seksionet I e II, sipas kategorisë së mjetit lundrues që i përket.

2. Sasia e nevojshme e materialeve mjekësore, që disponohen në bordin e mjeteve lundruese, përcaktohen nga:

- a) natyra e lundrimit;
- b) portet e destinacionit;
- c) kohëzgjatja e lundrimit;

ç) lloji i ngarkesës;

d) lloji i punës që do të kryhet gjatë udhëtimit;

dh) numri i punëmarrësve dhe/ose numri i pasagjerëve.

3. Përmbajtja e listës së materialeve për konsum mjekësor në bordin e mjetit lundrues hartohet sipas formatit të përcaktuar në shtojcën II, të këtij vendimi.

4. Lista miratohet nga kapiteni i mjetit lundrues dhe afishohet në një vend të dukshëm të mjetit lundrues dhe mbahet e disponueshme në çdo kohë.

5. Materialet për konsum mjekësor mbahen të disponueshme për përdorim dhe, nëse është e nevojshme, zëvendësohen e plotësohen sipas nevojës.

6. Çdo mjet shpëtimi në bordin e mjetit lundrues, që mban flamurin shqiptar apo është regjistruar në Regjistrin e Mjeteve Lundruese Shqiptare, pajiset me një kuti të ndihmës së parë, të papërshkueshme nga uji.

7. Kjo kuti përmban, të paktën, materiale të destinuara për konsum mjekësor që përfshihen në kutinë e ndihmës së parë, të përcaktuara sipas shtojcës II, seksionet I e II, të këtij vendimi, për kategorinë e mjeteve lundruese të tipit C.

8. Çdo mjet lundrues, që transporton ngarkesa të rrezikshme, të përcaktuara në Kodin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme Detare (IMDG), pavarësisht tipit të ngarkesës, duke përfshirë transportimin e tyre si teprica ose teprica nga ngarkesa, pajiset me materiale të konsumit mjekësor.

9. Lista, sasia dhe cilësia e materialeve të konsumit mjekësor, përfshirë edhe kundërhelmet që disponohen në bordin e mjetit lundrues që transporton ngarkesa të rrezikshme, përcaktohen në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme Detare (IMDG) dhe shtojcën III, të këtij vendimi.

10. Çdo mjet lundrues me flamur shqiptar apo i regjistruar në Regjistrin e Mjeteve Lundruese Shqiptare, me peshë bruto më tepër se 500 GT, me një ekuipazh jo më pak se 15 punëmarrës dhe që kryen një lundrim më të gjatë se tri ditë, duhet të ketë në dispozicion një zonë të posaçme dhe të përshtatshme për ofrimin e kujdesit shëndetësor, të shenjuar dhe të dallueshme qartë. Kjo zonë përmbush standardet e cilësisë dhe të ofrimit të shërbimit të kujdesit shëndetësor, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për kujdesin



shëndetësor dhe detarinë në Republikën e Shqipërisë.

11. Çdo mjet lundrues me flamur shqiptar apo i regjistruar në Regjistrin e Mjeteve Lundruese Shqiptare, me ekuipazh jo më pak se 100 detarë dhe që ndërmerr një lundrim ndërkombëtar më të gjatë se tri ditë, duhet të ketë në bord një mjek të licencuar nga Urdhri i Mjekut të Shqipërisë, i cili është përgjegjës për kujdesin shëndetësor në punë të punëmarrësve.

### III. Kundërhelmet

1. Institucionet përgjegjëse marrin masat e nevojshme për të siguruar që:

a) çdo mjet lundrues, që mban flamurin shqiptar ose që është i regjistruar në Regjistrin e Mjeteve Lundruese Shqiptare dhe transporton ndonjë prej substancave të rrezikshme të listuara në shtojcën III, duhet të mbajë në bord materiale për konsum mjekësor, duke përfshirë, të paktën, kundërhelmet e listuar në pikën 2, të shtojcës II;

b) çdo mjet lundrues i tipit traget, që mban flamurin shqiptar ose që është i regjistruar në Regjistrin e Mjeteve Lundruese Shqiptare, kushtet e funksionimit të të cilit jo gjithmonë lejojnë që të dihet paraprakisht natyra e substancave të rrezikshme që transporton, duhet të ketë në bord materiale të konsumit mjekësor, duke përfshirë, të paktën, kundërhelmet e listuar në shtojcën II, të këtij vendimi;

c) në rastet kur udhëtimi parashikohet të zgjasë më pak se dy orë, kundërhelmet mund të përfshijnë vetëm ato që duhet të administrohen në raste urgjence ekstreme, brenda një periudhe kohe, që nuk tejkalojnë kohëzgjatjen normale të udhëtimit;

ç) përmbajtja e listës së materialeve për konsum mjekësor lidhur me kundërhelmet hartohet sipas një formati që korrespondon, të paktën, me kornizën e përgjithshme të përcaktuar në shtojcën IV, seksionet I, II e III, të këtij vendimi.

### IV. Ndarja e detyrave dhe e përgjegjësi

1. Pronari i mjetit lundrues është përgjegjës për sigurimin e materialeve për konsum mjekësor në mjetet e lundrimit dhe zëvendësimin e tyre. Kostot financiare për furnizimin dhe zëvendësimin e materialeve mjekësore, që disponohen në bordin e mjetit lundrues, përballohen nga pronari i mjetit lundrues.

2. Pronari i mjetit lundrues siguron që udhëzuesit e përdorimit të materialeve për konsum mjekësor të disponohen bashkëlidhur paketimit, në

gjuhën shqipe ose në një nga gjuhët e përdorura nga punëmarrësit e mjeteve lundruese.

3. Kapiteni i mjetit lundrues është përgjegjës për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e barnave, të kundërhelmeve dhe të materialeve mjekësore që disponohen në bordin e mjetit lundrues.

4. Kapiteni i mjetit lundrues mund të delegojë përgjegjësinë për përdorimin dhe mirëmbajtjen e materialeve mjekësore të një ose disa punëmarrësve, të caktuar posaçërisht për shkak të kompetencës së tyre.

5. Kapiteni i mjetit lundrues dhe/ose punëmarrësit të cilëve iu është deleguar përgjegjësia e ruajtjes dhe e mirëmbajtjes së materialeve për konsum mjekësor, i nënshtrohen një formimi profesional të posaçëm të kujdesit shëndetësor në mjetet e lundrimit, sipas Konventës Ndërkombëtare mbi Standardet e Trajnimit, Kualifikimit dhe Vrojimit për Detarët, 1978 (STCW 78).

6. Materialet për konsum mjekësor mirëmbahen sipas kërkesave specifike të përcaktuara në fletëudhëzuesit e tyre dhe plotësohen dhe/ose zëvendësohen sa më shpejt që të jetë e mundur dhe, në çdo rast, si pjesë prioritare e procedurave normale të rishikimit.

7. Në çdo kohë dhe veçanërisht pas çdo rasti emergjence në bordin e mjetit lundrues, kapiteni, me sugjerim të mjekut, siguron plotësimin dhe zëvendësimin, sa më shpejt të jetë e mundur, të materialeve mjekësore që mungojnë.

### V. Trajnimi dhe konsultimet mjekësore

1. Materialet mjekësore, që disponohen në bordin e mjetit lundrues dhe në mjetet e shpëtimit, janë të shoqëruara me udhëzuesit e përdorimit të tyre, duke përfshirë edhe udhëzimet për përdorimin e, të paktën, atyre kundërhelmeve të listuara në pikën 2, të shtojcës II, të këtij vendimi.

2. Të gjithë personat, të cilët kanë formim profesional detar dhe që synojnë të punojnë në bordin e mjeteve lundruese, duhet të kenë marrë një trajnim të përgjithshëm mbi dhënien e ndihmës së parë dhe kujdesin shëndetësor në rast të aksidenteve, incidentit dhe/ose ngjarjeve në bordin e mjetit lundrues.

3. Kapiteni dhe çdo detar të cilit i është deleguar përgjegjësia e ruajtjes dhe e mirëmbajtjes së materialeve mjekësore paraprakisht, trajnohen në mënyrë të rregullt, çdo pesë vjet, në përputhje me rreziqet dhe nevojat specifike sipas klasifikimit të



mjeteve lundruese. Trajnimi i kapitenit dhe i detarëve për kujdesin shëndetësor në bordin e mjeteve të lundrimit përcaktohen në shtojcën V, të këtij vendimi.

4. Ministri përgjegjës për shëndetësinë përcakton qendrën ose qendrat e konsultimit mjekësor, që do të ofrojnë konsultime lidhur me ndihmën mjekësore për punëmarrësit e mjetit lundrues në det. Mjekët në këto qendra konsultimi duhet të jenë të formuar mbi çështjet të kujdesit shëndetësor në det.

5. Qendrat e konsultimit mjekësor që do të kryejnë vizita ndaj punëmarrësve që punojnë në bordin e mjeteve lundruese, në zbatim të Konventës Ndërkombëtare mbi Standardet e Trajnimit, Kualifikimit dhe Vrojtimit për Detarët, 1978 (STCW 78), do të lidhin një aktmarrëveshje me administratën detare për njohjen e dokumentacionit të lëshuar pas vizitave mjekësore.

6. Qendrat e konsultimit mjekësor mbajnë regjistra mjekësorë të punëmarrësve që punojnë në bordin e mjeteve lundruese, me pëlqimin e tyre dhe në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të dhënave mjekësore.

7. Sigurimi i kujdesit shëndetësor për punëmarrës, në rastet e emergjencës, përfshin masat e mëposhtme:

a) Krijimin e një apo më shumë qendrave të specializuara për këshillimin shëndetësor, nëpërmjet mjeteve të komunikimit në distancë;

b) Profesionistët e kujdesit shëndetësor që punojnë pranë qendrave të përcaktuara në shkronjën “a”, të kësaj pike, paraprakisht janë formuar për ofrimin e kujdesit shëndetësor në rastet e emergjencave dhe urgjencave në bordin e mjeteve lundruese.

8. Dokumentacioni për këshillimin dhe kujdesin shëndetësor, nëpërmjet mjeteve të komunikimit në distancë, ruhet në përputhje me parimet e konfidencialitetit, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë.

## **VI. Inspektimi i materialeve për konsum mjekësor**

1. Kontrolli shtetëror i flamurit merr masat e nevojshme për të kryer inspektimin vjetor, me qëllim verifikimin nëse materialet për konsum mjekësor në bordin e mjeteve lundruese dhe të mjeteve të shpëtimit:

a) përmbushin kërkesat minimale të përcaktuara në këtë vendim;

b) janë në përputhje me listat e përcaktuara në shtojcat e këtij vendimi;

c) ruhen sipas përcaktimeve ligjore në fuqi për barnat dhe pajisjet mjekësore dhe fletëudhëzuesit e përdorimit;

ç) janë brenda afatit të përdorimit.

2. Inspektimet e materialeve të konsumit mjekësor, të destinuara për përdorim në mjetet e shpëtimit, kryhen në të njëjtën kohë me mirëmbajtjen vjetore të tyre, në përputhje me përcaktimet e Konventës SOLAS.

3. Në kushte të jashtëzakonshme (në rast të forcave madhore) inspektimi i materialeve mjekësore në bordin e mjetit lundrues mund të shtyhet deri në 5 muaj nga koha e inspektimit vjetor.

## **VII. Dispozitë përfundimtare**

Ngarkohen ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe ministria përgjegjëse për infrastrukturën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2021.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**

## **SHTOJCA I KATEGORITË E MJETEVE LUNDRUESE**

1. Mjetet lundruese ndahen sipas këtyre kategorive:

1. Kategoria A përfshijë mjete lundruese detare apo të peshkimit në det, pa kufizime të kohëzgjatjes së udhëtimit.

2. Kategoria B përfshin:

a) mjete lundruese detare apo të peshkimit në det, të cilat kryejnë udhëtime më të shkurtra se 150 milje detare nga porti më i afërt me pajisjet e duhura mjekësore;

b) mjetet lundruese detare, të cilat kryejnë udhëtime më të shkurtër se 175 milje detare nga porti më i afërt, me pajisjet e duhura mjekësore dhe që qëndrojnë në mënyrë të vazhdueshme brenda hapësirës së mbuluar nga shërbimi i shpëtimit me helikopter. Për këtë qëllim, Administrata detare vë në dispozicion informacion të rifreskuar në lidhje me zonat ku ofrohet shërbim rutinë shpëtimi si dhe rrethanat në të cilat ato operojnë:



i. Ndaj vendeve fqinje

ii. tek kapitenet e mjeteve lundruese që mbajnë flamurin shqiptar, apo janë regjistruar nën juridiksionin e tij të plotë dhe të cilët janë, apo ka të ngjarë të jenë, të përfshirë nga aplikimi i paragrafit të parë.

Ky informacion vihet në dispozicion në mënyrë

më të përshtatshme, nëpërmjet qendrave të konsultimit me radio, qendrave të koordinimit të operacioneve të shpëtimit apo stacionet e radiove bregdetare.

3. Mjete lundruese portuale, anije apo mjete që përdoren shumë pranë bregut apo pa kabinë akomodimi përveç timonerisë.

## SHTOJCA II

### LISTË JO-SHTERUESE E MATERIALEVE PËR KONSUM MJEKËSOR

#### 1. Barnat

| Barnat                                                                            | Kategoritë e mjeteve lundruese |             |             |
|-----------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------|-------------|-------------|
|                                                                                   | Kategoria A                    | Kategoria B | Kategoria C |
| 1. Kardiovaskulare                                                                |                                |             |             |
| a) Analeptikë kardio-qarkullues-Simpatomimetikë                                   | x                              | x           |             |
| b) Preparate anti-anginale                                                        | x                              | x           | x           |
| c) Diuretike                                                                      | x                              | x           |             |
| d) Anti-hemorragjikë, përfshirë uterinikë nëse ka gra në bordin e mjetit lundrues | x                              | x           | x           |
| e) Anti-hipertension                                                              | x                              |             |             |
| 2. Gastro-intestinale                                                             |                                |             |             |
| a) Barnat për çrregullime të gastritit dhe zonës duodenale                        |                                |             |             |
| i. Antagonistët anti-ulçerë të receptorit histamine H2                            | x                              |             |             |
| ii. Veshjet mukoze anti-acid                                                      | x                              | x           |             |
| b) Antiemetikë                                                                    | x                              | x           | x           |
| c) Laksativë lubrifikues                                                          | x                              |             |             |
| d) Barna kundër diarrrisë                                                         | x                              | x           | x           |
| e) Antiseptikë për zonën intestinale                                              | x                              | x           |             |
| f) Preparate për kurimin e hemorrhoideve                                          | x                              | x           |             |
| 3. Analgjezikë dhe antispazmodikë                                                 |                                |             |             |
| a) Analgjezikë, preparate anti-pirretikë dhe anti-inflamator                      | x                              | x           | x           |
| b) Analgjezikë të fuqishëm                                                        | x                              | x           |             |
| c) Spazmolitikë                                                                   | x                              | x           |             |
| 4. Sistemi Nervor                                                                 |                                |             |             |
| a) Anksiolitikë                                                                   | x                              | x           |             |
| b) Neuroleptikë                                                                   | x                              | x           |             |
| c) Barna për kurimin e sëmundjes së detit                                         | x                              | x           | x           |
| d) Anti-epileptikë                                                                | x                              |             |             |



|                                                                                        |   |   |   |
|----------------------------------------------------------------------------------------|---|---|---|
| 5. Anti-alergjikë dhe anti-anafilaktikë                                                |   |   |   |
| a) H <sub>1</sub> Anti-histaminikë                                                     | x | x |   |
| b) Glukokortizoid intravenoz                                                           | x | x |   |
| 6. Sistemi respirator                                                                  |   |   |   |
| a) Barna për kurimin e bronkospasmave                                                  | x | x |   |
| b) Anti-tusivë                                                                         | x | x |   |
| c) Barna që përdoren për kurimin e të ftohurit apo sinozitit                           | x | x |   |
| 7. Anti-infektivë                                                                      |   |   |   |
| a) Antibiotikë (të paktën dy lloje)                                                    | x | x |   |
| b) Sulfamid antibakterial                                                              | x | x |   |
| c) Antiseptikë Urinarë                                                                 | x |   |   |
| d) Anti-parazitikë                                                                     | x | x |   |
| e) Antinfektivë për zonën intensinale                                                  | x | x |   |
| f) Vaksina anti-tetanoz dhe imunoglobina                                               | x | x |   |
| 8. Përbërjet që shërbejnë për rihidratimin, marrjen e kalorive dhe zgjerimin e plazmës |   |   |   |
| 9. Barna të destinuara për përdorim të jashtëm                                         |   |   |   |
| a) Barna për lëkurën                                                                   |   |   |   |
| i. Solucione antiseptike                                                               | x | x | x |
| ii. Preparate antibiotike                                                              | x | x |   |
| iii. Preparate antinflatore dhe analgjezike                                            | x | x |   |
| iv. Kremra anti-mykotikë                                                               | x |   |   |
| v. Preparate për kurimin e djegieve                                                    | x | x | x |
| b) Barna për sytë                                                                      |   |   |   |
| i. Pika antibiotike                                                                    | x | x |   |
| ii. Pika antibiotike dhe antinflatore                                                  | x | x |   |
| iii. Pika anestetike                                                                   | x | x |   |
| iv. Pika hipotonike miotike                                                            | x | x |   |
| c) Barna për veshët                                                                    |   |   |   |
| i. Solucion antibiotik                                                                 | x | x |   |



|                                                        |   |   |  |
|--------------------------------------------------------|---|---|--|
| ii. Solucion anestetik dhe antinflamator               | x | x |  |
| d) Barna për infeksionet orale dhe infeksionet e fytit |   |   |  |
| e) Antibiotikë dhe shpëlarës gojë antiseptikë          | x | x |  |
| f) Anestetikë lokalë                                   | x | x |  |
| i. Anestetikë lokalë të cilat përdorin ngrirje         | x | x |  |
| ii. Anestetikë lokalë me injektim                      | x | x |  |
| iii. Anestetikë dentare dhe preparate antispitike      | x | x |  |

## 2. Pajisje Mjekësore

| Pajisje Mjekësore                                                                                                                                  | Kategoritë e mjeteve lundruese |             |             |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------|-------------|-------------|
|                                                                                                                                                    | Kategoria A                    | Kategoria B | Kategoria C |
| 1. Pajisjet e ringjalljes                                                                                                                          |                                |             |             |
| a) Pajisjet e ringjalljes manuale                                                                                                                  | x                              | x           |             |
| b) Pajisje për dhënie të oksigjenit me anë të zvogëlimin e presionit të tillë që mund të përdoret oksigjeni industrial i anijes, ose enë oksigjeni | x                              | x           |             |
| c) Aspirator mekanik për të pastruar rrugë të sipërme të frymëmarrjes                                                                              | x                              | x           |             |
| d) Cannula për ringjalljen gojë më gojë                                                                                                            | x                              | x           | x           |
| 2. Pajisjet e veshjes dhe suturës                                                                                                                  |                                |             |             |
| a) Makinë qepëse njëpërdorimëshe ose çantë suture me gjilpëra                                                                                      | x                              | x           |             |
| b) Fasho elastike me ngjitëse                                                                                                                      | x                              | x           | x           |
| c) Rrotulla garzash                                                                                                                                | x                              |             |             |
| d) Garzë tubulare për fashat e gishtërinjve                                                                                                        | x                              |             |             |
| e) Kompresa garzash sterile                                                                                                                        | x                              | x           | x           |
| f) Pambuk                                                                                                                                          | x                              | x           |             |
| g) Fletë sterile për djegiet e viktimave                                                                                                           | x                              | x           |             |
| h) Mbajtëse krah                                                                                                                                   | x                              | x           |             |
| i) Doreza polietileni njëpërdorimëshe                                                                                                              | x                              | x           | x           |
| j) Veshje adezive                                                                                                                                  | x                              | x           | x           |
| k) Garzë parandaluese për rrjedhjen e gjakut sterile                                                                                               | x                              | x           | x           |
| l) Sutura adezive ose fashë prej oksid zinku                                                                                                       | x                              | x           | x           |
| m) Sutura jo të përthithshme me gjilpëra                                                                                                           | x                              |             |             |
| n) Fasho e veshur me vazelinë                                                                                                                      | x                              | x           |             |
| 3. Mjete                                                                                                                                           |                                |             |             |
| a) Bisturi njëpërdorimëshe                                                                                                                         | x                              |             |             |
| b) Kuti çeliku të papërshkrueshme nga ndryshku për mbajtjen e instrumenteve                                                                        | x                              | x           |             |
| c) Gërshërë                                                                                                                                        | x                              | x           |             |
| d) Piskatore mjekësore                                                                                                                             | x                              | x           |             |
| e) Kllapa hemostatike                                                                                                                              | x                              | x           |             |





|                                                             |   |   |  |
|-------------------------------------------------------------|---|---|--|
| f) Mbajtëse gjilpëre                                        | x |   |  |
| g) Brisqe njëpërdorimëshe                                   | x |   |  |
| 4. Pajisje për ekzaminim dhe monitorim                      |   |   |  |
| a) Lugë për kontrollin e rrugëve trakeo-bronkiale           | x | x |  |
| b) Shirita reaktivë për analizën e urinës                   | x |   |  |
| c) Monitruues për temperaturë                               | x |   |  |
| d) Fletë për evakuimin mjekësor                             | x | x |  |
| e) Stetoskop                                                | x | x |  |
| f) Spifigmomanometër aneroid                                | x | x |  |
| g) Termometër Mjekësor Standart                             | x | x |  |
| h) Termometër hipotermik                                    | x | x |  |
| 5. Pajisjet për injeksion, perfuzion, shpim dhe kateterizim |   |   |  |
| a) Pajisje për kullimin e fshikëzës                         | x |   |  |
| b) Set i rrjedhjes rektale                                  | x |   |  |
| c) Infuzor i disponueshëm i filtrit                         | x |   |  |
| d) Pajisje për kullimin e urinës                            | x |   |  |
| e) Shiringa dhe age të disponueshme                         | x | x |  |
| f) Kateter                                                  | x |   |  |
| 6. Pajisje mjekësore të përgjithshme                        |   |   |  |
| a) Uturak                                                   | x |   |  |
| b) Shishe për mbajtjen e ujit të nxehtë                     | x |   |  |
| c) Shishe për urinimin                                      | x |   |  |
| d) Pako me akull                                            | x |   |  |
| 7. Imobilizimi dhe vendosja e pajisjeve                     |   |   |  |
| a) Mbajtëse e përkulshme për gishtin                        | x | x |  |
| b) Mbajtëse e përkulshme për krahun dhe dorën               | x | x |  |
| c) Mbajtëse e përkulshme e fryshme                          | x | x |  |
| d) Mbajtëse për kofshën                                     | x | x |  |
| e) Qafore për mbajtjen drejt të qafës                       | x | x |  |
| f) Dyshek i përkulshëm ose mbajtëse këmbë                   | x |   |  |
| 8. Dezinfektimi, disinfektimi dhe profilaksia               |   |   |  |
| a) Përbërje dizinfektimi me përbajtje uji                   | x |   |  |
| b) Insekticid në formë likuide                              | x |   |  |
| c) Insekticid në formë pluhuri                              | x |   |  |

### 3. Kundërhelmet

#### A. Barna:

- a) të përgjithshme;
- b) kardio-vaskulare;
- c) sistem gastrointensial;
- d) sistem nervor;
- e) sistem i frymëmarrjes;
- f) anti-infektivë;
- g) për përdorim të jashtëm.

#### B. Pajisje mjekësore

- a. Pajisje të nevojshme për dhënien e oksigjenit (përfshirë dhe pajisjet për mirëmbajtjen)



### SHTOJCA III SUBSTANCA TË RREZIKSHME

1. Substancat e përmendura në këtë shtojcë i referohen cilësdo formë që ato mbahen në bord, qoftë mbetjeje apo ngarkese.

2. Substanca të rrezikshme konsiderohen:

- a) substancat dhe objektet shpërthyes;
- b) gazrat: i ngjeshur, i lëngshëm ose i tretur nën presion;
- c) lëngjet e ndezshme;
- d) solidë të ndezshëm;
- e) substancat që i nënshtrohen djegies spontane;
- f) substancat të cilat, gjatë kontaktit me ujin, lëshojnë gazra të ndezshëm;
- g) substancat e djegshme;
- h) peroksidet organike;
- i) substancat toksik;
- j) substancat infektive;
- k) substancat radioaktive;
- l) substancat gjeryese.

3. Substanca të tjera të rrezikshme, menaxhimi i të cilave rrezikon shëndetin e punëtorëve në bordin e mjeteve lundruese sipas seksionit III, të këtij vendimi.

### SHTOJCA IV

#### FORMAT I MBAJTJES SË PROCESVERBALIT TË INSPEKTIMIT VJETOR TË MJETIT LUNDRUES

I. Format i mbajtjes së procesverbalit të inspektimit vjetor të mjetit lundrues të kategorisë A

Seksioni 1:

Të dhënat për mjetin lundrues

Emri:

Flamuri:

Porti ankorues:

Seksioni 2: Materialet për konsum mjekësor

Nënseksioni 1: Barnat

| Barnat                                                                            | Sasia e nevojshme | Sasia aktuale në bord | Komente |
|-----------------------------------------------------------------------------------|-------------------|-----------------------|---------|
| 1. Kardiovaskulare                                                                |                   |                       |         |
| a) Analeptikë kardio-qarkullues-Simpatomimetikë                                   |                   |                       |         |
| b) Preparatë anti-anginale                                                        |                   |                       |         |
| c) Diuretikë                                                                      |                   |                       |         |
| d) Anti-hemorragjikë, përfshirë uterinikë nëse ka gra në bordin e mjetit lundrues |                   |                       |         |
| e) Anti-hipertension                                                              |                   |                       |         |
| 2. Gastro-intestinale                                                             |                   |                       |         |
| a) Barnat për çrregullime të gastritit                                            |                   |                       |         |



|                                                                                        |  |  |  |
|----------------------------------------------------------------------------------------|--|--|--|
| dhe zonës duodenale                                                                    |  |  |  |
| i. Antagonistët anti-ulçerë të receptorit histamine H2                                 |  |  |  |
| ii. Veshjet mukoze anti-acid                                                           |  |  |  |
| b) Antiemetikë                                                                         |  |  |  |
| c) Laksativë lubrifikues                                                               |  |  |  |
| d) Barna kundër diarrrhesë                                                             |  |  |  |
| e) Antiseptikë për zonën intensinale                                                   |  |  |  |
| f) Preparatë për kurimin e hemorrhoideve                                               |  |  |  |
| Neni                                                                                                                                                                                                                                                                                               | Teksti                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | Referenca                                                                                                                                                                                                                                                                     | Neni         | Teksti                                                                                                                                                                  | Përputhshmëria | Shënime                                  |
| Aneksi V, I                                                                                                                                                                                                                                                                                        | Trajnimi Mjekësor i kapitenit dhe punëtorëve të caktuar për ofrimin e kujdesit shëndetësor<br><br>1. Njohuri bazike të fiziologjisë, simptomatologjisë dhe terapeutikë.<br><br>2. Njohuri në elementet e mjekësisë parandaluese, veçanërisht higjienës individuale dhe kolektive, dhe elementët e masave të mundshme profilaktike.<br><br>3. Aftësi për të kryer format themelore të |                                                                                                                                                                                                                                                                               | Shtojca V, I | Trajnimi Mjekësor i kapitenit dhe punëtorëve të caktuar për ofrimin e kujdesit shëndetësor<br><br>1. Njohuri bazike të fiziologjisë, simptomatologjisë dhe terapeutikë. | E pjesshme     | Përafrimi i plotë me anëtarësimin në BE. |



|              |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |  |               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |            |                                          |
|--------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|---------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|------------------------------------------|
|              | <p>trajtimit dhe mbikëqyrjes për dhënien e ndihmës urgjente në det.</p> <p>Personi përgjegjës për trajtimin në mjete lundruese të kategorisë A duhet të kryejnë trajnimin e tyre praktik në spitale.</p> <p>4. Njohuri të hollësishme se si të përdorin lehtësirat e ndryshme të këshillimit mjekësor në distancë.</p> |  |               | <p>2. Njohuri në elementet e mjekësisë parandaluese, veçanërisht higjienës individuale dhe kolektive, dhe elementët e masave të mundshme profilaktike.</p> <p>3. Aftësi për të kryer format themelore të trajtimit dhe mbikëqyrjes për dhënien e ndihmës urgjente në det.</p> <p>Personi përgjegjës për trajtimin në mjete lundruese të kategorisë A duhet të kryejnë trajnimin e tyre praktik në spitale.</p> <p>4. Njohuri të hollësishme se si të përdorin lehtësirat e ndryshme të këshillimit mjekësor në distancë.</p> |            |                                          |
| Aneksi V, II | Ky trajnim duhet të marrë parasysh programet e udhëzimeve të hollësishme në dokumentet përkatëse ndërkombëtare të fundit.                                                                                                                                                                                              |  | Shtojca V, II | Ky trajnim duhet të marrë parasysh programet e udhëzimeve të hollësishme në dokumentet përkatëse ndërkombëtare të fundit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | E pjesshme | Përafrimi i plotë me anëtarësimin në BE. |



**VENDIM****Nr. 864, datë 24.12.2019****PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT  
POLITIK KOMBËTAR PËR MOSHIMIN,  
2020–2024, DHE TË PLANIT TË  
VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E TIJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e dokumentit politik kombëtar për moshimin, 2020–2024, dhe të planit të veprimit për zbatimin e tij, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e varësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet e varësisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Brendshme dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR  
Edi Rama**

**DOKUMENTI POLITIK KOMBËTAR  
MBI MOSHIMIN  
2020–2024  
Dhjetor 2019****PJESA I  
KONTEKSTI POLITIK, INSTITUCIONAL  
DHE SOCIAL**

Shqipëria ka filluar të përjetojë efektet e moshimit të popullatës, pas një periudhë transformimi demografik që ka ndodhur kohët e fundit në Shqipëri, periudhë gjatë së cilës proporcioni i personave të moshuar është rritur me disa herë, ndërkohë që ka rënë proporcioni i fëmijëve si pasojë e rënies së fertilitetit dhe i adultëve të rinj, si pasojë e emigracionit. Jetëgjatësia mesatare ka ardhur vazhdimisht në rritje dhe ka gjithnjë e më shumë persona, që

mund dhe duhet të vijnë të marrin pjesë aktive në shoqëri edhe pas moshës së pensionit. Nga ana tjetër, tranzicioni i përsheptuar demografik është shoqëruar nga një zvogëlim i familjes dhe i rolit të saj tradicional mbështetës për të moshuarit me nevoja të veçanta. Për më tepër, ndryshe nga shumica e vendeve të rajonit, Shqipëria nuk trashëgon nga e kaluara një sistem tradicional e të integruar të kujdesit shëndetësor e social për të moshuarit. Në këtë kontekst është e nevojshme të ndërtohet një plan kombëtar në këtë fushë, plan i cili do të mbështeste një integrim më të mirë të të moshuarve në shoqëri, si dhe një jetë të gjatë, të shëndetshme dhe produktive.

Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale 2016–2020, i miratuar me VKM-në nr. 87, datë 3.2.2016, një dokument tejet i rëndësishëm i qeverisë shqiptare, garanton një sistem bashkëkohor e të përgjegjshëm, për vlerësimin e përfshirjes sociale në politika të ndryshme sektoriale, si: mbrojtja sociale, punësimi dhe rritja e aftësive, shëndeti, arsimit, strehimi dhe siguri i nevojave bazë, si edhe në politikat e pjesëmarrjes sociale dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Ky dokument synon krijimin e një ambienti mbrojtës e riintegruar për grupet e kategoritë më të përjashtuara të shoqërisë shqiptare, përfshirë të moshuarit.

Çështjet që lidhen me krijimin e një ambienti mbrojtës për individë në nevojë gradualisht janë përfshirë në listën e prioritetëve të qeverisë shqiptare gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Pikëpamja mbi mbrojtjen sociale të grupeve në nevojë ka ndryshuar nga njohja e të drejtave të tyre, në respektimin dhe garantimin e këtyre të drejtave. Sidoqoftë, trashëgimia e varfër e të kaluarës, si edhe problemet ekonomike dhe shoqërore të Shqipërisë, kanë përcaktuar edhe drejtimit e politikave sociale të Shqipërisë. Si rezultat i situatës ekonomike dhe shoqërore, si edhe i dukurive që lidhen me tranzicionin, individë dhe grupe të përjashtuar ose në rrezik përjashtimi, përballen me shumë dukuri kritike, që ndikojnë në moshimin, përjashtimin apo mosrespektimin e të drejtave të tyre.

Në këtë kontekst, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), në cilësinë e institucionit përgjegjës për Politikën e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, me mbështetjen e



UNFPA-së, si edhe të gjitha grupeve të interesit, përgatiti Dokumentin Politik Kombëtar mbi Moshimin.

Ka rreth 400,000 të moshuar në Shqipëri – 14 për qind e popullsisë totale. Rreth 60 për qind e tyre jetojnë në zona të izoluar. Të moshuarit që jetojnë vetëm ose në varfëri, gjë e cila në ndërveprim me barriera të ndryshme (si kushte të veçanta shëndetësore ose infrastruktura e dobët) pengon pjesëmarrjen e plotë dhe efektive në shoqëri<sup>19</sup>.

Vlen të evidentohet se sistemi i shërbimeve sociale, si në drejtim të funksionimit ashtu edhe në drejtim të aksesit të qytetarëve, ka shënuar arritje të konsiderueshme, kryesisht në saxe të bashkëpunimit efektiv të strukturave të shtetit me OJF-të. Në saxe të këtij bashkëpunimi janë zhvilluar shërbime me bazë komunitare, të cilat mbështesin familje dhe individë në nevojë. Megjithatë, në tërësinë e shërbimeve sociale, shërbimet shëndetësore dhe sociale për të moshuarit janë më kritikët.

Në kuadrin e reformës territoriale, njësitë e qeverisjes vendore, bashkitë kanë fituar më shumë kompetenca në lidhje me ofrimin dhe sigurimin e shërbimeve të përkujdesjes sociale. Gjithsesi, rritja e kompetencave duhet të shoqërohet edhe me rritjen e kapaciteteve, si njerëzore ashtu edhe financiare, me qëllim që të mundësohet ofrimi dhe përfitimi i shërbimeve cilësore dhe efektive të mirëqenies sociale. Bashkitë e vendit janë të përfshira në procesin e përgatitjes të planeve sociale, në të cilat nevojat dhe shërbimet për moshën e tretë do të përfshihen, si pjesë e mekanizmit financiar të fondit social.

Përpyqjet e deritanishme kanë arritur të identifikojnë problemet më themelore, me të cilat përballlet moshja e tretë, si edhe grupet më të përjashtuara. Me qëllim harmonizimit e politikave, koordinimit e përpjekjeve dhe rritjen e efektivitetit të burimeve ekzistuese, rezulton i nevojshëm hartimi i planit të veprimit.

### 1.1 Analiza demografike

Me kalimin e viteve, struktura e popullsisë mund të ndryshojë ndjeshëm si rezultat i

ndërveprimit të proceseve demografike, siç janë lindshmëria, vdekshmëria ose migracioni, gjithashtu dhe faktorëve të tjerë indirekt, si zgjedhjet e stilit të jetës ose ofrimi dhe efienca e shërbimeve të kujdesit shëndetësor.

Popullsia e Shqipërisë në 1 janar 2019, rezulton 2.862.427 banorë, duke pësuar një rënie me 0,3 %, krahasuar me 1 janar 2018<sup>20</sup>. Tranzicioni demografik në Shqipëri ka kulmuar dukshëm me një “plakje” graduale të popullatës gjatë dekadave të fundit. Kështu, numri i individëve të moshuar përbën mbi 11% të popullatës së përgjithshme të vendit tonë, me një tendencë në rritje përgjatë viteve të ardhshme<sup>21</sup>.

Shqipëria po fillon të përjetojë efektet e moshimit të popullsisë - procesi sipas të cilit të moshuarit zënë një përqindje proporcionalisht më të madhe të të gjithë popullsisë. Në dy dekadat e fundit, ka ndodhur një transformim demografik i veçantë, ndërsa rritja e përqindjes së personave të moshuar mbi 65 vjeç, shoqërohet me ulje të përqindjes së fëmijëve dhe të rinjve<sup>22</sup>. Kjo situatë amplifikohet akoma më shumë nga niveli i lartë i emigrimit të të rinjve dhe moshave të mesme, gjë që e bën të domosdoshme vendosjen e çështjeve të moshimit mes prioriteteve kryesore të qeverisë shqiptare.

Emigracioni i vazhdueshëm në shkallë të gjerë dhe lindshmëria dhe vdekshmëria në rënie, kanë pasur një ndikim shumë të madh në strukturën e popullsisë së Shqipërisë. Numri i personave në grup-moshën 15–64 vjeç ka mbetur mjaft i qëndrueshëm gjatë periudhës ndërmjet dy censuseve të fundit, duke rënë nga 1.96 milionë në vitin 1989 në 1.90 në vitin 2011. Nga ana tjetër, në një popullsi përgjithësisht në rënie, vërehet një rritje e mprehtë e numrit të të moshuarve mbi 65 vjeç, nga 169 në 318 mijë në të njëjtën periudhë<sup>23</sup>. Ky është një tregues i qartë i transformimit të plotë të shoqërisë, në një periudhë kohore prej vetëm 22 vjet.

<sup>20</sup> INSTAT, Popullsia e Shqipërisë, 1 janar 2019.

<sup>21</sup> Moshja (*Movement of Organizations Supporting Healthy Ageing*), përmbledhje e studimit me të moshuarit në Shqipëri, 2017.

<sup>22</sup> Mplakja e popullsisë: *Situata e të moshuarve në Shqipëri*, nëntor 2015.

<sup>23</sup> Mplakja e popullsisë: *Situata e të moshuarve në Shqipëri*, nëntor 2015.

<sup>19</sup> Vlerësimi i kushteve social-ekonomike, pjesëmarrjes shoqërore dhe gjendjes shëndetësore të të moshuarve në Shqipëri. Rrjeti Shqiptar i Moshimit, tetor 2017.



Sipas të dhënave të përditësuara, popullsia e Shqipërisë në vitin 2031 llogaritet të jetë 2.745.996 banorë. Ky numër është rreth 36 mijë banorë më pak krahasuar me numrin e popullsisë në Projektionet e Popullsisë 2011–2031. Ndryshimi i këtij numri është pasojë direkte e normave më të ulëta të lindshmërisë dhe shpërndarja gjinore e emigrantëve, e cila nuk përkon me hipotezën e Projektioneve të Popullsisë 2011–2031.<sup>24</sup>

Rritja me ritme të ngadalta e Indeksit Sintetik të Fekonditetit (ISF), shoqëruar nga hyrja në moshë riprodhim e brezave të grave më të pakët në numër se ato aktual, do të bëjë që numri i lindjeve të mos pësojë ndryshime domethënëse gjatë periudhës 2019–2031. Në të njëjtën kohë numri i vdekjeve do të vazhdojë të rritet, si pasojë e një popullsie më të madhe në moshë të vjetër. Këto dy ndryshime do të sjellin edhe rënien e shtesës natyrore, deri në rreth 3,2 mijë në 2031.

Një aspekt i rëndësishëm i procesit të moshimit është moshimi demografik progresiv i vetë popullsisë më të vjetër. Numri në rritje i të vjetërve më të moshuar është rezultat i drejtpërdrejtë i jetëgjatësisë në rritje, e cila është vënë re gjatë dekadave të mëparshme dhe që mendohet se do të vazhdojë në dekadat e ardhshme. Nëse vitet shtesë të fituara nëpërmjet jetëgjatësisë së rritur jetohen me shëndet të mirë ose të keq është një çështje tjetër.

Në të kaluarën martesë ishte universale në popullsinë e Shqipërisë dhe rimartesa, veçanërisht te meshkujt, ishte shumë e zakonshme, ndërsa analiza aktuale tregon një shtyrje të martesës, rënie të shkallës së rimartesës dhe madje shfaqjen e fenomenit të braktisjes së saj. Niveli i ulët i martesave, aktualisht, reflektohet nga një nivel i rritjes së divorcave<sup>25</sup>. Demografët e kanë përshkruar zhvillimin nga regjimet e lindshmërisë dhe vdekshmërisë së lartë, te lindshmëria dhe vdekshmëria e ulët si “tranzicion demografik”.

Megjithëse Shqipëria e ka përfunduar tranzicionin e parë demografik në dekadën përpara censusit të vitit 2011, në të njëjtën

periudhë shfaqen tendenca që mund të interpretohen si hapat e parë të tranzicionit të dytë demografik.

## 1.2 Përshkrim i shkurtër i situatës ekonomike, gjendjes shëndetësore e sociale të të moshuarve

Ndikimi i varfërisë dhe problemeve të tjera sociale të shoqërisë shqiptare të përmbledhura më lart, së bashku me “barrierat e moshës”, gjendja shëndetësore ose infrastruktura e dobët e shërbimeve, pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të të moshuarve në shoqëri, iu mohojnë atyre disa nga të drejtat, mundësinë e përfitimit nga mirëqenia e përgjithshme, ashtu si anëtarët e tjerë të shoqërisë. Për rrjedhojë, të moshuarit janë ndër grupet më të përjashtuara të popullsisë<sup>26</sup>.

Përjashtimi social në Shqipëri përkufizohet si: “mohim i mundësive të barabarta nga disa grupe të shoqërisë mbi të tjerë, gjë e cila çon drejt paaftësisë së individit, për të marrë pjesë në funksionimin bazë politik, ekonomik dhe social të shoqërisë”. Moshë e tretë në Shqipëri përballat me probleme mjaft kritike, të cilat ndikojnë në përjashtimin shumëdimensional, gjë që konfirmohet nga studime, të dhëna, si edhe diskutime me grupe të interesit.

Në përputhje me përcaktimet teorike, si edhe me metodologjinë e zhvilluar në kuadrin e përgatitjes së “Dokumentit politik të përfshirjes sociale”, dimensionet e përjashtimit përkufizohen, si:

- “dimensioni ekonomik”, pamundësia për të krijuar dhe/ose zotëruar të ardhura, mjete prodhimi, prona, kapitale, përfshirë edhe banesën;

- “dimensioni social”, paaftësia në përdorimin e shërbimeve (të gjithë tipat), mundësia për të përdorur kontaktet sociale, pamundësia e një jetë të qetë në komunitet, siguria nga vjedhja, grabitjet, dhuna, kriminaliteti;

- “kultural”, pamundësia për të përdorur shërbimet argëtuese, riaftësuese e kulturore;

- “etik, njerëzor”, izolimin e të moshuarve deri në “harresën” e tyre, nga shoqëria;

- “politik”, pamundësia për të ushtruar të drejtat politike dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje.

<sup>24</sup> INSTAT, Projektionet e popullsisë, 2019–2031.

<sup>25</sup> Shqipëri: Popullsia dhe dinamikat e saj - horizonte të reja demografike?, INSTAT, maj, 2014.

<sup>26</sup> Profili social i të moshuarve në Shqipëri.



Problemi më kritik i moshës së tretë është varfëria ekonomike, e shkaktuar nga mungesa ose pamjaftueshmëria e të ardhurave. Pavarësisht reformimit të skemës së pensioneve, sistemi përballat me sfida të lidhura me demografinë dhe ekonominë. Raporti i vartësisë së moshimit pothuaj u dyfishua nga 8.6% në vitin 1989 në 16.7% në vitin 2011. Në vitin 2030, ky raport do të jetë dyfishuar sërish për të arritur në nivelin 32.9%.

Rreth 30% e të moshuarve shqiptarë jetojnë në blloqe apartamentesh të ndërtuara para viteve 90, ku një kufizim i rëndësishëm i lëvizshmërisë për 80% të tyre është mungesa e ashensorit. Shumica dërrmuese ose 93% e të moshuarve ka akses në banja të përshtatshme, por vetëm 76% e kanë këtë brenda shtëpisë.

Gjendja shëndetësore e të moshuarve është problemi i dytë për nga rëndësia. Të moshuarit vuajnë më shumë se një sëmundje kronike. Ata shprehen se nuk e përballojnë dot blerjen e ilaçeve dhe shpesh detyrohen të marrin vetëm një pjesë të ilaçeve, kryesisht ato që janë më rimbursim. Nga ana tjetër, sistemi publik i kujdesit shëndetësor është i papërgatitur për të përballuar nevojën në rritje të të moshuarve.

Nga disa studime, që ka kryer Shoqata e Gerontologjisë, e ngritur posaçërisht për evidentimin e problemeve të të moshuarve, rezulton se rreth 60 për qind e të moshuarve në të gjithë vendin, vuajnë nga sëmundje kronike, ndërkohë që rreth 30 për qind deri në 40 për

qind e medikamenteve, përdoret nga moshë e tretë, duke ndikuar ndjeshëm në buxhetin e shtetit. Gjendja shëndetësore, sidomos e të moshuarve mbi 75 vjeç dhe të sëmurë, është faktor kritik përjashtimi.

Studimi “Vlerësimi i kushteve social-ekonomike, pjesëmarrjes shoqërore dhe gjendjes shëndetësore të të moshuarve në Shqipëri”, i realizuar nga Rrjeti Shqiptar i Moshimit në vitin 2017, konfirmon se rreth 8% e të moshuarve nuk kanë asnjë kontakt me pjesëtarët e familjes dhe/ose miqtë, duke dëshmuar për një izolim të plotë social të kësaj kategorie të moshuarish. Shkalla e përjashtimit social është disi më e lartë te femrat (8.7%) në krahasim me meshkujt (7.7%), dhe është shumë më e lartë te të moshuarit në moshë shumë të madhe, në krahasim me ata me moshë më të re.

Në studimin e vitit 2017, me pak përjashtime, vërehet një përmirësim si në drejtëm të perceptimit të shëndetit, përdorimit të shërbimeve shëndetësore, ashtu edhe në perceptimin e varfërisë, krahasuar me studimin e parë të ngjashëm, të realizuar në vitin 2008. Megjithatë, problemet mbi vetminë dhe shqetësimet e lidhura me shikimin janë shtuar. Tabela 1 paraqit një përmbledhje të problemeve të shërbimeve shëndetësore, të identifikuara nga dy grupe të përqendruara në Tiranë dhe në Vlorë, të organizuara gjatë procesit të vlerësimit të situatës për përgatitjen e Planit të Veprimit mbi Moshimin.

**Tabela 1. Përmbledhje e problemeve të të moshuarve në Tiranë dhe në Vlorë**

| Nevojat e perceptuara shëndetësore                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | Probleme lidhur me përdorimin e shërbimeve                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | Probleme lidhur me cilësinë e shërbimeve                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Ka një nivel shumë më të lartë të sëmundjeve kronike dhe të humbjes së aftësisë krahasuar me moshat e tjera.<br>Te gratë vërehet nivel më i lartë i hasjes së sëmundjeve kronike, depresionit, dhimbjeve dhe uljes së mobilitetit.<br>Ka një numër të lartë personash me më shumë se një sëmundje dhe nevoja për trajtime të shumëfishta. | Mobilitet i ulët te shumë të moshuar, si dhe humbje e autonomisë te disa çon në mënjanim të shërbimeve në rast nevojë.<br>Probleme me transportin.<br>Mos përballim i kostove shtesë të disa barnave apo i ekzaminimeve shtesë të rekomanduara nga mjekët.<br>Prirje e përdorimit të mjekësisë alternative/tradicionale.<br>Pritshmëri të ulëta nga shërbimet në zonat rurale.<br>Opinione të ndara lidhur me pagesat informale. Disa besojnë se sjellja e mjekëve është e ndikuar nga aftësia e tyre për të paguar. Disa të tjerë e lidhin me formimin dhe profesionalizmin individual të mjekut.<br>Vizitat në shtëpi në zonat urbane shumë të rralla dhe të kondicionuara nga pagesat informale | Mjeket nuk u kushtojnë kohën e duhur dhe nuk i dëgjojnë me kujdes shqetësimet e tyre.<br>Mjeket nuk japin shpjegime mbi trajtimin dhe barnat<br>Mosbesim te cilësia e barnave të listës.<br>Mungesë e kujdesit në shtëpi kur nevojitet.<br>Mungesë besimi te kapacitetet në kujdesin parësor.<br>Probleme (sidomos te gratë e moshuara) në mënyrën e komunikimit nga ana e personelit.<br>Pakënaqësi me rezultatet e trajtimit (sidomos te gratë). |



Braktisja nga familja ose jetesja në vetmi është problemi më i ri me të cilin përballen të moshuarit në Shqipëri. Pjesërisht për shkak të dobësimit të lidhjeve familjare në kohën moderne dhe pjesërisht për shkak të imigracionit dhe emigracionit, të moshuarit edhe pse nuk përballen me problemin e mungesës së strehimit, vuajnë vetminë, e cila rëndon edhe më shumë gjendjen e tyre shëndetësore dhe emocionale.

Braktisja nga shoqëria shoqëron “moshimin” në Shqipëri. Të moshuarit, pasi ndërpresin marrëdhënien me punën, ndërpresin marrëdhënien edhe me kontaktet sociale, gjë që thellon rrezikshmërinë e përjashtimit social. Në këtë periudhë, personat me moshë të pjekur duhej të kishin mundësi të tregonin eksperiencat dhe arritjet e tyre në jetë, duke kontribuar në aktivitete të përshtatshme për kualifikimin dhe gjendjen shëndetësore të tyre. Kjo kërkon që shoqëria të krijojë mekanizma, të cilët përdorin punën vullnetare të të moshuarve, për të realizuar shërbime të domosdoshme komunitare.

Në përfundim të përshkrimit, vlerësohet se të moshuarit e vetëm, në nevojë për shërbime dhe me të ardhura të pamjaftueshme, janë më të privuarit nga pjesëmarrja në funksionimin bazë politik, ekonomik dhe social të shoqërisë. Përjashtimi dhe mohimi i të drejtave janë ngushtësisht të lidhura. Të moshuarve iu mohohen të drejtat që vijojnë:

- e drejta e të moshuarve për të qenë të lirë nga diskriminimi, nëpërmjet mohimit të aksesit ndaj shërbimeve ose edhe faktorëve të tjerë, si: gjinia, etnia ose aftësitë e kufizuara;

- e drejta e të moshuarve për të qenë të lirë nga dhuna, sepse të moshuarit, burra dhe gra, shpesh janë subjekt i abuzimit, si ai verbal, seksual, psikologjik dhe financiar;

- e drejta e të moshuarve për siguri sociale, për shkak të paaftësisë të sektorit publik për t’u siguruar mbrojtje të veçantë të moshuarve dhe riintegrim ose sigurimit të një minimumi të ardhurash;

- e drejta e të moshuarve për shëndet për shkak të mohimit të kujdesit të duhur shëndetësor dhe pamundësisë të përfitimit të trajtimit mjekësor të nevojshëm;

- drejta e të moshuarve për të kontribuar, për shkak të konsiderimit si “jo të aftë për t’u punësuar”.

### 1.3 Kuadri ligjor në mbrojtje të të drejtave të moshës së tretë

Korniza e përgjithshme e ligjore, mbi bazën e së cilës organizohet dhe realizohet mbrojtja, kujdesi dhe integrimi social i të moshuarve përbëhet nga:

- ligji nr. 104/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”;

- ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;

- ligj nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”;

- ligj nr. 10 107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”;

- ligj nr. 105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”<sup>27</sup>;

- ligj nr. 7870, datë 13.10.1994, “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”.

Gjithashtu, Shqipëria ka miratuar ligjin nr. 8137, date 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore” (FZ 20/1996).

Analiza e ligjeve të mësipërme, si edhe e vendimeve që shoqërojnë zbatimin e tyre, dëshmon se “të moshuarit”, nuk trajtohen si grup i përjashtuar apo në nevojë të veçantë, sidomos “sipas kriterit të nevojave për kujdes dhe shërbime shëndetësore”.

Sipas kriterit të “nevojave për mbrojtje dhe shërbime shoqërore”, ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet sociale në Republikën e Shqipërisë”, përcakton, se kategoria “të moshuar në nevojë” ka të drejtë të përfitojë ndihmë monetare dhe shërbime shoqërore, në legjislacionet e tjera, të moshuarit trajtohen si të gjithë anëtarët e shoqërisë. Ndërsa ndihma monetare përcaktohet mbi bazën e të ardhurave, pavarësisht nga mosha, shërbimet shoqërore mund të përfitojnë vetëm të moshuarit, të identifikuar si individë në nevojë, për arsye të ndryshme, si të moshuar të vetëm, të moshuar pa të ardhura, të moshuar pa mbështetje.

Shërbimet sociale për të moshuar realizohen nëpërmjet:

A. Shërbimeve të kujdesit shoqëror, që ofrohen në qendra publike të shërbimit si qendrat komunitare, qendrat rezidenciale, qendrat ditore ose në shtëpi dhe financohen nga buxheti i shtetit

<sup>27</sup> <https://shendetesia.gov.al/ligje-8/>



dhe nga buxhetet vendore të organeve të qeverisjes vendore.

**B.** Shërbimeve të kujdesit shoqëror që ofrohen në qendra jopublike, nga organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse.

Në rang vendi, shërbimet sociale për të moshuar të ofruara nëpërmjet qendrave të kujdesit social, të të gjitha llojeve, përbëjnë vetëm 15%, përkatësisht 39 qendra për të moshuar në të gjithë vendin nga 259 qendra shërbimesh që janë në Shqipëri. 36% e qendrave (14 qendra) ofrojnë shërbime për të moshuar në qarkun e Tiranës, ndërsa 25 të tjerat ofrojnë shërbime përkatësisht në Korçë (6 qendra), Shkodër (5 qendra), Berat (3 qendra), Durrës, Vlorë dhe Elbasan (nga 2 qendra) dhe Lezhë, Dibër, Gjirokastrë, Fier, Kukës (nga 1 qendër).

Shërbimi për të moshuarit në qendrat rezidenciale është i garantuar, cilësor dhe i bazuar në standardet e shërbimit të miratuara nga qeveria shqiptare. Në shërbim të të moshuarve ka stafe me punonjës të specializuar për këtë tipologji shërbimesh, ekupe multidisiplinare që realizojnë vlerësimin e personalizuar të nevojave për çdo të moshuar dhe njëkohësisht kanë hartuar dhe planin e ndërhyrjeve individuale për plotësimin e nevojave të identifikuar. Të moshuarit në këto qendra kanë të drejtat e tyre për ankimim për çdo rast të pakënaqësisë ose kontestimi të cilësisë së ushqimit, higijenës, mënyrës së sjelljes së punonjësve etj. Megjithatë, qendrat e shërbimeve sociale për të moshuar janë të pamjaftueshme, ndërsa kapaciteti i tyre, gjithashtu, është i kufizuar për të plotësuar nevojat për shërbime.

Personeli i qendrave të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për të moshuar (i qendrave publike) përbëhet kryesisht nga mjekë e infermierë, ndonëse edhe profesioni i punonjësit social është i përfshirë në organigramë. Sidoqoftë, duhet nënvizuar se profesioni i “kujdestarit social” ende është i panjohur.

#### **1.4 Institucionet përgjegjëse për politikën e “moshës së tretë”.**

**Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** është institucioni kryesor, përgjegjës për hartimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave të mbrojtjes, kujdesit dhe integritetit të të moshuarve.

**Instituti i Shëndetit Publik, Shërbimi Social Shtetëror, Operatori i Shërbimit të Kujdesit**

**Shëndetësor** janë institucione në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përgjegjëse për zbatimin e politikave të moshës së tretë.

**Fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor** është institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin politikave kombëtare të kontributit dhe përfitimit të kujdesit shëndetësor, në të cilën, të moshuarit janë një nga grupet përfituese.

**Instituti i Sigurimeve Shoqërore**, në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, është institucioni përgjegjës për zbatimin e politikave kombëtare të kontributeve dhe përfitimeve, në të cilat komponenti kryesor përbëhet nga “kontributet dhe të ardhurat për pension pleqërie”.

**Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë** është institucioni kryesor, përgjegjës për hartimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave të arsimit dhe edukimit gjatë gjithë jetës dhe organizimit të aktiviteteve të përbashkëta në kuadër të vullnetarizmit midis brezave.

Sipas reformës territoriale, të miratuar nëpërmjet ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, siguri dhe funksionimi i shërbimeve shoqërore për kategori në nevojë, përfshirë të moshuarit, është përgjegjësi e **njësisë të vetëqeverisjes vendore**, përkatësisht për:

- krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, komunitare, në nivel lokal;
- ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore;
- krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Mundësitë e bashkive për ngritjen, administrimin dhe funksionimin e shërbimeve sociale për të moshuar, kufizohen nga mungesa e burimeve financiare, pavarësisht decentralizimit të kompetencave. Studimi “Vëzhgim mbi buxhetet lokale të shpenzuara për shërbime të përkujdesjes sociale në disa bashki të vendit”, i mbështetur nga UNDP-ja në vitin 2018, tregoi se shërbimet e përkujdesjes shoqërore në bashki, financohen thuhet plotësisht nga fondet e kushtëzuara. Financimi nga “fondet e pakushtëzuara” ose “të ardhurat e vetë bashkisë” është thuhet i papërfillshëm, rreth 2 deri 3%, me përjashtim të Tiranës, në të cilën “të ardhurat e vetë Bashkisë” mbulojnë 8% të nevojës.



### 1.5 Të drejtat e moshimit/sfidat e Planit Kombëtar të Veprimit, 2020–2024

Me fillimin e reformës së transformimit nga ekonomi qendrore në ekonomi tregu, vëmendja e qeverisë shqiptare dhe shoqërisë civile për të mbrojtur dhe garantuar të drejtat e njeriut, është rritur. Gjatë dy dekadave të tranzicionit, politikat e mbrojtjes sociale të grupeve më të përjashtuara të shoqërisë, janë reformuar rrënjësisht. *Dokumenti Politik për Përfshirjen Sociale, 2016–2020*, që është miratuar, i ndërtuar në përputhje me strategjinë e përfshirjes sociale të BE-së, përcakton objektiva ambiciozë në fushën e reformës të politikave sociale. Ky dokument i kushton vëmendje të veçantë “moshës së tretë”.

*Ligji për asistencën sociale*, pavarësisht kufizimeve, përcjell një kuptim të ri mbi trajtimin e nevojës për shërbime për të moshuarit, sepse synon që gradualisht të përafrojë “trajtimin sipas nevojës” me “trajtimin sipas të drejtave”. Gjithashtu, ky ligj ndikon në rritjen e aksesit të të moshuarve te shërbimet shoqërore.

*Reforma e Pensioneve*, e miratuar në vitin 2014, është me rëndësi të veçantë për grupin e targetuar. Kjo reformë merr në konsideratë moshimin e popullatës shqiptare, gjë që ndikon si te personat që janë mbi 65 vjeç, ashtu edhe ata që janë ende më të rinj. Harmonizimi i sistemit të pensioneve, rritja e moshës së pensionit dhe e viteve të kontributit, si dhe futja e pensioneve sociale shërbejnë si bazë për stabilizimin e kontratës ndërmjet brezave në të ardhmen, ndërsa përgatisin shoqërinë për rritjen graduale të të moshuarve të mbetur jashtë sistemit.

*Reforma shëndetësore* është e fokusuar te përballimi i sëmundjeve kronike në rritje dhe përmirësimi i aksesit të të gjitha kategorive të popullatës, te shërbimet efektive e cilësore të kujdesit shëndetësor.

*Reforma territoriale*, e miratuar në vitin 2014, gjithashtu i hap rrugën jo vetëm rritjes së aksesit të të moshuarve te shërbimet e përkujdesjes shoqërore, por edhe ofrimit të shërbimeve sipas nevojës, duke siguruar edhe eficiencën e tyre. Gjithashtu, kjo reformë, nëpërmjet qasjes së “shërbimeve me bazë komunitare” do të ndikojë në realizimin e së drejtës së të moshuarve për të përfutur shërbime të cilësishme.

*Ligji “Mbi strehimin social”*, i cili përcakton të moshuarit si një nga kategoritë përfituese të strehimit.

*Ligji për shërbimet e kujdesit shoqëror* parashikon se një nga kategoritë përfituese janë të moshuarit, dhe për herë të parë parashikohet një tipologji e re shërbimi, me bazë komunitare, për këtë kategori “asistenca shtëpiake” e miratuar me udhëzimin 571/2017. Megjithatë, konstatohet se pjesa më e madhe e shërbimeve sociale janë përqendruar në zonat urbane, si ato publike, ashtu edhe ato të ofruara nga institucione jopublike.

Përfundimisht, vlerësohet se Dokumenti i Politikave Kombëtar mbi Moshimin, duhet të konsiderojë:

- të drejtat e të moshuarve për shërbime shoqërore dhe shëndetësore, në përputhje me nevojat e tyre;
- përafrimin e shërbimit te klienti;
- garantimin e së drejtës së përfitimit dhe të zgjedhjes së alternativës së shërbimit;
- ofrimin e shërbimeve multidisiplinare, me synim riintegrimin dhe/ose përmirësimin e cilësisë së jetës të të moshuarve;
- shpërndarjen e përgjegjësi ndërmjet aktorëve të ndryshëm të shoqërisë;
- fuqizimin e bashkive për të realizuar përgjegjësitë e tyre.

## 2. PJESA II POLITIKAT DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKË MBI MOSHIMIN

### 2.1 Metodologjia e përdorur

Hartimi i Dokumentit Politik Kombëtar dhe i Planit të Veprimit mbi Moshimin mbështetet në disa kriterë:

Kriteri 1: Ndërsa do të rivlerësojë politikat ekzistuese, dokumenti do të sugjerojë masa të reja politike dhe institucionale, në përputhje me kuadrin ekzistues legjislativ, detyrimet ndërkombëtare, si edhe modele referencë, plotësisht të zbatueshme në kontekstin shqiptar.

Kriteri 2. Ky dokument do të përfshijë, si nivelin qendror, ashtu edhe atë lokal.

Kriteri 3. Ky dokument do të përfshijë politika dhe masa ndërsektoriale.

Kriteri 4. Ky dokument do të përmbajë edhe detyrimet institucionale, që burojnë nga domosdoshmëria e realizimit të tij, përfshirë burimet e nevojshme, njerëzore dhe financiare.



Procesi, përgjatë të cilit u mundësua përgatitja e Dokumentit Politik dhe Planit të Veprimit, kaloi nëpër katër faza themelore, përkatësisht:

A. Rishikimi i të gjitha materialeve ekzistuese, politike dhe studimore, me qëllim verifikimin e informacioneve, rivlerësimin e grupeve më të përjashtuara brenda grupimit të përcaktuar si “mosha e tretë”, si edhe riformulimin e problemeve më kritike, që cenojnë të drejtën e të moshuarve për shërbime cilësore të mirëqenies sociale.

B. Plotësimin e informacionit nëpërmjet intervistave me grupe të fokusuara, kryesisht me hartues të politikave në nivel qendror, zbatues të politikave në nivel qendror dhe vendor.

C. Mbledhja e opinionëve dhe komenteve nga shoqëria civile, organizatat që mbrojnë të drejtat e të moshuarve ose ofrojnë shërbime për të moshuar.

D. Përgatitja e draftit të Planit të Veprimit dhe diskutimi i tij me grupet e interesit.

Gjatë fazës A u analizuan dokumentet përkatëse nën këndvështrimin e vlerësimit të përshtatshmërisë së politikave ekzistuese të përfshirjes dhe mbrojtjes sociale, si edhe rezultatet konkrete të tyre, duke evidentuar edhe shkaqet që kanë penguar/vështirësuar arritjen e objektivave të politikave ekzistuese.

Faza e dytë B ndihmoi në saktësimin e përfundimeve të analizës të dokumentacionit të realizuar gjatë fazës A. Në fazën e dytë, analiza u mbështet te “opinionet”, përkatësisht të hartuesve të politikave të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale, si edhe të kujdesit shëndetësor (MSHMS), të politikave ekonomike dhe financiare (MEF), të zbatimit të politikave në nivel qendror, përkatësisht të Shërbimeve Sociale (SHSSH), të Sigurimeve Shoqërore (ISSH), të Fondit të Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH), të mbrojtjes në punë (Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale), të mbrojtjes së shëndetit (Instituti i Shëndetit Publik), si edhe të zbatimit të politikave në nivel lokal.

Faza e tretë C përfshiu diskutimet me aktorët joqeveritarë. Kjo përjasje u konsiderua thelbësore për të mbledhur të dhënat e nevojshme dhe për të propozuar politika efektive, të zbatueshme në afatshkurtër, si edhe në afatgjatë.

Diskutimet në grup u zhvilluan në formën e intervistave gjysmë të strukturuar të organizuara, sipas një pyetësoi udhëzues.

Faza e katërt D përfshin analizën e të dhënave dhe Informacionit, si edhe ballafaqimin e tij me sugjerimet e literaturës, me qëllim formulimin e strategjive më të përshtatshme dhe të zbatueshme në kontekstin shqiptar, bazuar mbi profilin e varfërisë dhe përjashtimit social.

## **2.2 Referenca me dokumente të tjera strategjike kombëtare e ndërkombëtare dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm**

Dokumenti Politik mbi Moshimin, përveç analizës së nevojave dhe identifikimit të sfidave të moshimit në popullatën e Shqipërisë, ka konsideruar dhe është mbështetur mbi disa parime të përfshira në dokumente të Bashkimit Evropian mbi moshimin e shëndetshëm dhe aktiv, Organizatës së Kombeve të Bashkuara (p.sh., “Parimet e OKB-së për të moshuarit”) dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë (p.sh., “Shëndet 2020”). Gjithashtu, ky dokument respekton parimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjeve bazë në Shqipëri.

Dokumenti Politik mbi Moshimin dhe Plani Kombëtar i Veprimit mbi Moshimin, 2020–2024 hartohet në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2015–2020 (komponenti: Investimi te Kapitali Social), sipas vizionit: “Shqipëria – një demokraci në forcim, në rrugën drejt integritetit të saj në Bashkimin Evropian, me një ekonomi konkurruese, të stabilizuar dhe të qëndrueshme, që garanton të drejtat themelore dhe liritë e njeriut”.

Në këtë kontekst, ky dokument është drejtpërsëdrejti i lidhur me synimin themelor të strategjisë për komponentin e përmendur, sipas së cilës: Investimi te kapitali social do të mundësohet nëpërmjet ndërtimit të një sistemi të mbrojtjes shoqërore, që redukton pabarazitë ekonomiko-shoqërore, krijon një sistem me politika dhe mekanizma për mbrojtjen e të gjithë individëve vulnerabël dhe të përjashtuar, përmes programeve parandaluese dhe atyre të përfshirjes sociale, të kombinuar me skemat e punësimit, duke garantuar që çdo fëmijë, çdo person i moshuar dhe çdo familje shqiptare të ketë akses të barabartë, në lidhje me shërbimet e kujdesit shoqëror funksional dhe gjithëpërfshirës, bazuar mbi parimin e





decentralizimit, deinstitutionalizimit dhe diversifikimit për të.

Në Strategjinë e Mbrojtjes Sociale 2015–2020, të moshuarit konsiderohen si një nga grupet me nevoja të veçanta. Plani i Veprimit mbi Moshimin është në përputhje me vizionin për mbrojtjen sociale, bazuar në qasjen e *ciklit të jetës*.

Strategjitë specifike të sistemit shëndetësor prekin pak ose aspak, në mënyrë të drejtpërdrejtë çështjet e moshimit. Ky plan, përveçse është në përputhje me principet e përgjithshme të disave prej tyre, si kujdesi universal dhe promocioni shëndetësor, është edhe një mundësi për të plotësuar boshllëqet strategjike dhe për të adresuar sfidat e moshimit lidhur me shëndetin.

Dokumenti Politik mbi Moshimin dhe Plani Kombëtar i Veprimit mbi Moshimin është në linjë me objektivat e strategjisë shëndetësore të Bashkimit Evropian Së bashku për shëndetin: Një qasje strategjike për BE-në 2008–2013, në të cilën nënvizohej nevoja për promovimin e shëndetit, në të gjitha fazat e jetës, ndërkohë që popullata plakët. Ky element është nënvizuar edhe në konkluzionet e Këshillit të BE-së: “Moshim i shëndetshëm gjatë gjithë ciklit të jetës” (2012/C 396/02), ndërkohë që Programi i Tretë Shëndetësor i BE-së, identifikon ndryshimet demografike, si një sfidë kyçe për rajonin.

Politikat dhe objektivat specifikë të Dokumentit Politik mbi Moshimin dhe të Planit Kombëtar të Veprimit mbi Moshimin janë, gjithashtu, në linjë me disa prej objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ/SDG):

- Synimi 1. Zhdukje e varfërisë kudo dhe në të gjitha format.

- Synimi 3. Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë në të gjitha moshat.

- Synimi 4. Sigurimi i arsimimit gjithëpërfshirës dhe krijimi i mundësive për të mësuarit gjatë gjithë jetës, për të gjithë.

- Synimi 5. Arritje e barazisë gjinore dhe fuqizim i grave.

- Synimi 8. Promovim i rritjes së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse ekonomike, punësim dhe punë për të gjithë.

- Synimi 11. Qytete për të gjithë, të sigurt, reziliente dhe të qëndrueshme.

Ne seksionin 3.1 të Planit të Veprimit, më poshtë, për çdo objektiv specifik të politikave

prioritare, është dhënë edhe referenca me OZHQ-në/SDG-në përkatëse.

### **2.3 Vizioni, parimet dhe synimet e përgjithshme të Dokumenti Politik mbi Moshimin dhe Plani Kombëtar i Veprimit mbi Moshimin**

Ky dokument, përveç analizës së nevojave dhe identifikimit të sfidave të moshimit në popullatën e Shqipërisë, ka konsideruar dhe është mbështetur mbi disa parime të përfshira në dokumente të Bashkimit Evropian mbi moshimin e shëndetshëm dhe aktiv, Organizatës së Kombeve të Bashkuara (p.sh., “Parimet e OKB-së për të moshuarit”) dhe të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (p.sh., “Shëndet 2020”). Gjithashtu, ky dokument respekton parimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjeve bazë në Shqipëri.

**2.3.1 Parimet** mbi të cilat mbështetet dokumenti:

- pjesëmarrja e të moshuarve;
- fuqizimi në nivel personal dhe komunitar;
- vëmendja për grupet më në nevojë ose vulnerabël;
- barazia gjinore;
- masat ndërsektoriale;
- qëndrueshmëria financiare dhe kosto-efektiviteti.

#### **2.3.2 Vizioni:**

Të moshuarit shqiptarë jetojnë e kontribuojnë me dinjitet, të përfshirë dhe jo të diskriminuar, duke realizuar potencialin e tyre, në një shoqëri që i mbështet të ruajnë aftësitë funksionale e shëndetësore dhe u mundëson akses pa barriera nëpërmjet shërbimeve cilësore shëndetësore dhe sociale.

#### **2.3.4 Synimet e përgjithshme:**

Synimet e përgjithshme të Planit të Veprimit mbi Moshimin janë:

- deri në vitin 2024, të sigurojë ndërtimin e një ambienti të përshtatshëm, që mbështet dhe ndihmon gratë dhe burrat e moshuar, për t'u integruar në shoqëri, duke ruajtur dinjitetin njerëzor, pavarësisht nga gjendja e tyre shëndetësore apo autonomia e tyre funksionale;

- të sigurojë ndërtimin dhe forcimin e sistemit të kujdesit social dhe shëndetësor në të gjitha bashkitë e vendit, mbështetur mbi parimet e moshimit të shëndetshëm, duke garantuar përdorimin e shërbimeve të cilësishme, për të gjithë të moshuarit, që kanë nevojë për kujdes;



- të mundësojë një jetë sa më të gjatë, të shëndetshme dhe aktive për të gjithë shqiptarët, nëpërmjet ndërgjegjësimit të shoqërisë mbi shëndetin e mirë, parandalimin e sëmundjeve, si edhe zvogëlimin e pabarazive në trajtimin e nevojave të moshës së tretë.

#### 2.3.5 Treguesit e ndikimit:

- deri në vitin 2024, rritje me 1 vit e jetëgjatësisë

mesatare dhe e jetëgjatësisë së shëndetshme (pa sëmundje);

- deri në vitin 2024, ulje me 5% e varfërisë të personat mbi 65 vjeç, e matur sipas standardit të Bashkimit Evropian;

- deri në vitin 2024, mbulimi në 100% me shërbime shëndetësore dhe sociale për personat mbi 65 vjeç.

### PJESA III

## QËLLIMI I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË STRATEGJISË

### 3.1 Politikat prioritare mbi moshimin 2020–2024

| Politika prioritare                                                           | Objektiva specifike për secilën politikë (dhe lidhja me OZHQ-në/SDG-në përkatëse).                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
|-------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>I. Mbrojtja dhe përfshirja sociale</b>                                     | Mbështetje për të moshuarit më të varfër, përmes përmirësimit gradual të pensioneve më të ulëta (SDG 1, 3).<br>Rritje e aksesit në transportin publik për të moshuarit me të varfër (SDG 11, 3).<br>Pjesëmarrje më të gjerë e të moshuarve në jetën komunitare. (SDG 11, 3).<br>Zgjatje e jetës në punë dhe ruajtja e aftësisë për punë. Nxitje e të mësuarit gjatë gjithë jetës (SDG 4, 8).<br>Promovim i vullnetarizmit dhe bashkëveprimit ndërbreznor (SDG 11, 3). |
| <b>II. Shërbimet sociale e shëndetësore të integruara</b>                     | Integrimi i shërbimeve shëndetësore me ato sociale dhe kujdes i vazhduar për të moshuarit vulnerabël (SDG 3).<br>Zgjerim i shërbimeve në qendra komunitare dhe krijimi i modeleve të apartamenteve si bashkësi (SDG 3, 11).<br>Fuqizim i asistencës në shtëpi (SDG 3, 5).<br>Rritje e kapaciteteve geriatrike dhe gerontologjike, të profesionistët shëndetësore dhe sociale (SDG 3).                                                                                 |
| <b>III. Promovimi i shëndetit/i mirëqenies dhe ndërgjegjësimi i shoqërisë</b> | Nxitje e jetës së shëndetshme, parandalimit të sëmundjeve e invaliditetit të të moshuarit. (SDG 3).<br>Përmirësimi i imazhit të moshimit dhe luftimi i çdo forme paragjykimi e diskriminimi (SDG 3).<br>Përmirësim i informacionit dhe monitorimit të shëndetit/mirëqenies së të moshuarve (SDG3).                                                                                                                                                                    |

### 3.2 Politika 1. Mbrojtje dhe përfshirje sociale për të moshuarit

Një pjesë të madhe të kontributit në cilësinë e jetës, lidhur me moshimin e shëndetshëm, e luajnë lufta kundër varfërisë, integrimi në jetën shoqërore dhe mjedisi në nivel komunitar. Kjo vlen si për zonat rurale, ashtu edhe për ato urbane. Elementet e rëndësishme të mjedisit ku jeton i moshuari përbëjnë transporti, pjesëmarrja dhe përfshirja sociale, siguria publike, arsimi apo informimi dhe komunikimi. Ndërkohë që disa politika, si ato të pensioneve, hartohen dhe miratohen në nivel qendror, shumë vendime të rëndësishme për jetën dhe mirëqenien e të moshuarve, merren në nivelin e qeverisjes vendore. Shumë prej barrierave dhe pabarazive mund të adresohen po në këtë nivel.

**Rezultati i pritshëm** për këtë politikë prioritare është mbrojtja e të moshuarve më në nevojë,

përmes përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit pensione dhe mekanizmave të tjerë socialë, në përputhje me standardet evropiane dhe ato ndërkombëtare. Gjithashtu do të mbështeten qeveritë vendore, për t'i shndërruar bashkitë në komunitete më miqësore për moshimin, duke krijuar më shumë mjedise të përshtatshme për shëndetin e mirëqenien e të moshuarve apo duke nxitur përfshirjen e tyre në jetën komunitare e shoqërore.

#### 3.2.1 Objektivi specifik 1 i qëllimit të politikës 1

**A. Të garantojmë kushte jetese dinjitoze përmes miratimit të përmirësimit gradual të pensioneve më të ulëta, çdo vit, në përputhje me rritjen e nivelit të inflacionit, duke ofruar mbështetje të qëndrueshme për të moshuarit më të varfër.**



Grupet më vulnerabël, nga pikëpamja e varfërisë absolute mes të moshuarve, janë ata me pensione minimale. Pensionet duhet të arrijnë të mbulojnë nevojat elementare të individëve për të siguruar jetën, shëndetin dhe përfshirjen sociale. Është e nevojshme që të përcaktohen fillimisht kriteret mbi indeksimin e pensionit minimal dhe, në mënyrë graduale të përmirësohen pensionet e ulëta në përputhje me këto kriterë. Në këtë proces do të përfshihen veç Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrotjtjes Sociale, me institucionet e varura prej saj, edhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

### ***Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme:***

1. Ngritja e një grupi ndërinstitucional mbi hartimin e një dokumenti mbi metodologjinë për përlogaritjen e vazhdueshme të pensionit minimal;
2. Tregues: Dokumenti i hartuar;
3. Përshtatje graduale, brenda 5 vjetëve, e pensioneve të ulëta. Ky proces do të shoqërojë forcimin gradual të të gjithë sistemit të pensioneve.

Tregues: Rritje me rreth 2-3 % çdo vit për 5 vite.

Intensifikim i informimit nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore mbi pensionet sociale, me synim uljen e numrit të atyre që nuk e përfitojnë atë, thjesht për arsye informimi dhe burokracie.

Tregues: Rreth 5 mijë të moshuar shumë të varfër të informuar më mirë mbi mundësitë e pensioneve sociale.

#### **3.2.2 Objektivi specifik 2 i qëllimit të politikës 1**

### **B. Të rrisim aksesin në transportin publik për të moshuarit më të varfër përmes skemave të subvencionimit.**

Individët e moshuar munden të jenë aktivë dhe pjesëmarrës vetëm në kushtet e një mjedisi të përshtatshëm të banimit. Mjedis i përshtatshëm për personat e moshuar do të thotë edhe mjedis i sigurt. Barrierë negative, që ndërhyjnë në përfshirjen e të moshuarve në jetën shoqërore, është mes të tjerash edhe pamundësia për të përdorur transportin për distanca relativisht të largëta në mjedisin urban. Është dëshmuar se mundësia e përdorimit të transportit publik për të moshuarit, rrit në mënyrë të dukshme kapacitetin e tyre për t'u integruar në shoqëri dhe për të përdorur shërbimet. Në Shqipëri, ky model ka filluar të funksionojë në ndonjë qytet (Korçë), por është ende në hapat e parë. Do të përfshihet përmirësimi i aksesit në transportin publik për të moshuarit në të gjitha

politikat kombëtare të lidhura me transportin dhe do të mbështeten bashkitë për të aplikuar skema të subvencionimit të transportit publik urban për të kategori të veçanta të të moshuarve me vulnerabël (me në nevojë).

### ***Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme:***

1. Specifikimi i nevojave të të moshuarve për transport, në të gjitha dokumentet dhe planet lidhur me transportin publik, si në nivel qendror ashtu edhe në nivelin e qeverisjes vendore.

Tregues: Politikat e aprovuara të transportit publik, ku nevojat e të moshuarve specifikohen qartë.

2. Rritja e aksesit në transport publik për grupet më në nevojë të të moshuarve (p.sh., të moshuarit në pension social), përmes mbulimit të plotë apo të pjesshëm të kostove të transportit nga ana e bashkive.

Tregues: 1) Bashkitë me mbi 100 000 banorë me modele të subvencionimit të transportit, për grupe të caktuara të të moshuarve; 2) 2000 të moshuar me pension social të përfshirë në skemë.

#### **3.2.3 Objektivi specifik 3 i qëllimit të politikës 1**

### **C. Të sigurojmë një pjesëmarrje më të gjerë e të moshuarve në jetën komunitare, për të reduktuar nivelin e vetmisë dhe izolimit social mes të moshuarve.**

Zakonisht, me daljen në pension rritet risku i shkëputjes së lidhjeve shoqërore të të moshuarve dhe i uljes së përfshirjes së tyre në aktivitet sociale, kulturore dhe ekonomike. Këto përbëjnë faktorë të rëndësishëm risku për shëndetin dhe mirëqenien e të moshuarve. Nga ana tjetër, izolimi ul kontributin e të moshuarve në shoqëri. Bashkitë janë niveli i duhur i qeverisjes, ku mund të ofrohen një sërë aktiviteteve sociale, të cilat do të nxisin pjesëmarrjen e të moshuarve në shoqëri, do të shmangnin izolimin për shumë prej tyre dhe rritjen e kontributit në jetën komunitare.

### ***Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme:***

1. Qeveritë vendore ndërtojnë plane/politika lokale të mbështetjes për të moshuarit, brenda planeve lokale/rajonale sociale dhe mekanizma të pjesëmarrjes së të moshuarve, sidomos grave, në procesin e vendimmarrjes.



Tregues: 50 bashki që kanë politika mbi moshimin dhe aplikojnë përfshirjen e të moshuarve në vendimmarrje.

2. Ofrim sistematik nga ana e bashkive të aktiviteteve kulturore e sociale me përfshirje të të moshuarve të vetmuar (vizita turistike në qytete të Shqipërisë, konkurse letërsie dhe muzikë, përkujtimore të personave të shquar etj.). Aplikim i tarifave të reduktuara për personat mbi 65 vjeç për evente artistike apo sportive të ofruara nga vetë bashkia apo agjenci të tjera publike a private në territorin e bashkisë.

Tregues: 50 bashki me të paktën një aktivitet për të moshuarit në vit.

#### **3.2.4 Objektivi specifik 4 i qëllimit të politikës 1**

**D. Të sigurojmë mjedise motivuese në punë për personat para daljes së tyre në pension dhe të nxisim të mësuarit gjatë gjithë jetës.**

Ndërprerja e menjëhershme e marrëdhënieve të punës krijon një potencial krize ekonomike, shoqërore dhe shëndetësore për të moshuarin. Të moshuarit janë një mes grupeve më të rrezikuar në tregun e punës, sidomos në rastet kur ka një akumulim faktorësh të tillë si arsimim i ulët, aftësi të kufizuara, adaptim i pamjaftueshëm në kushtet e reja. Koncepti i të mësuarit gjatë gjithë jetës shpesh kombinon arsimimin me aktivitetin e punës dhe ndihmon në fleksibilitetin e individit të moshuar ndaj tregut të punës apo në adaptimin ndaj ndryshimeve teknologjike.

Të mësuarit gjatë gjithë jetës krijon kushtet për kualifikim e vetëplotësim shoqëror, sipas interesave individualë, jashtë sistemit tradicional shkollor.

Është e nevojshme që tranzicioni nga puna në pension të bëhet më fleksibël dhe individët të vijnë në punë në varësi të nevojave dhe mundësive personale, ndërkohë që ekzistojnë mundësitë për arsimim gjatë gjithë jetës, duke ruajtur në këtë mënyrë e aftësitë për punë për një kohë të gjatë.

#### ***Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme:***

1. Përmirësimi i ndërgjegjësimit të publikut në përgjithësi mbi mundësitë që ofron tregu i punës për punësimin e të moshuarve. Sigurimi përfshirjes së shumicës së institucioneve publike në iniciativa që nxisin sjelljet pozitive ndaj nëpunësve të

moshuar dhe lufta ndaj diskriminimit lidhur me moshën në punë.

Tregues: Fushata të përvitshme të informimit dhe aktivitete të tjera mbi këtë temë.

2. Krijimi i një modeli të “Universitetit të Moshës së tretë” në një bashkëpunim mes institucioneve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile (përgatitje e kurseve 1-ditore të edukimit mbi tema të ndryshëm).

Tregues: 10 kurrikula të miratuara. 1000 të moshuar pjesëmarrës në aktivitete të “Të mësuarit gjatë gjithë jetës”.

#### **3.2.5 Objektivi specifik 5 i qëllimit të politikës 1**

**E. Të sigurojmë njohjen dhe vlerësimin nga ana e shtetit të kontributeve vullnetare për një shoqëri të të gjitha moshave.**

Ndryshimi i shpejtë i situatës demografike, nëse do të kombinohej me një krizë ekonomike, do të rriste mundësitë për tension mes brezave në shoqërinë shqiptare. Kjo përbën një sfidë për t'u adresuar përmes mbështetjes së solidaritetit, dialogut dhe bashkëveprimit midis individëve të kategorive të ndryshme moshore. Përveç përmirësimeve të pritshme në kohezionin social, lidhjet ndërbreznore kanë efekte pozitive në jetën në familje, si dhe në funksionimin e sektorëve shëndetësore, sociale dhe të zhvillimit ekonomik të vendit.

Qëndrimet pozitive lidhur me moshimin nevojitet të formohen që në moshë të re. Gjithashtu, është me rëndësi të drejtohet fokusi i vëmendjes, jo vetëm drejt të kuptuarit dhe nevojave të të moshuarve nga ana e rinjve, por edhe t'u shpjegohen të moshuarve interesat e të rinjve dhe sfidat që ata duhet të përballojnë. Do të promovohet vullnetarizmi dhe bashkëveprimi ndërbreznor, për të ruajtur atmosferën tradicionale të mirëkuptimit dhe e respektit mes brezave.

Përfshirja vullnetare në aktivitete në ndihmë të të moshuarve apo të të gjitha shtresave në nevojë, është një nga mënyrat më të mira për të dëshmuar impenjimin komunitar të gjithkujt, si në dialogun ndërbreznor, ashtu edhe në ndihmë të një shoqërie për të gjitha moshat. Megjithatë, ka një stigmatizim të kontributeve vullnetare në shoqëri. Për të tejkaluar këtë problem, do të synohet njohja formale e aktiviteteve vullnetare, sidomos ajo e të rinjve në ndihmë të të moshuarve.

***Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme:***

1. Rregullim institucional i normave për marrje dhe njohjen dhe certifikimin e vullnetarizmit, me synim formalizimin këtij procesi.

Tregues: Dokument orientues mbi njohjen e vullnetarizmit që nxit angazhimin e të rinjve në mbështetje të të moshuarve.

2. Organizimi çdo vit i ditëve të dyerve të hapura për të moshuarit në shkollat dhe institucionet e tjera arsimore (përfshi sistemin parashkollor). Organizimi i sesioneve informuese mbi çështjet e moshimit, destigmatizimin e të moshuarve, heqjen e tabuve mbi vdekjen, dhe shpërndarjen e shembujve pozitivë të bashkëveprimit ndërbreznor. Përfshirja e universiteteve të shkencave sociale në zhvillimin e këtyre aktiviteteve.

Tregues: 500 aktivitete në shkolla.

**3.3 Politika 2: Shërbimet sociale e shëndetësore të përshtatshme dhe të integruara për të moshuarit**

Të moshuarit kanë më shumë nevoja shëndetësore dhe sociale krahasuar me kategoritë e tjera. Të moshuarit janë në risk shumë më të lartë, për sëmundje kronike, mbivendosje të shumë sëmundjeve kronike te një person, si dhe humbje afatshkurtër apo afatgjatë të aftësive funksionale. Gjithashtu, ata hasin me shumë barriera lidhur me aksesin në shërbimet shëndetësore e sociale krahasuar me shumë grupe të tjera të popullatës, përfshirë barriera të lidhura me mobilitetin, informacionin dhe kostot. Nga ana tjetër, sistemi shëndetësor shqiptar ka shumë nevojë për përmirësim të kapaciteteve profesionale në fushën e geriatriisë dhe gerontologjisë.

Humbja e aftësive funksionale, cenimi i mobilitetit dhe autonomisë, si dhe sëmundje të rënda kronike kërkojnë shërbime të kujdesit afatgjatë, në nivel spitalor apo jashtë spitalor. Gjithashtu, risku më i lartë për probleme të shëndetit mendor, humbje të aftësive konjitive dhe për demenca shton nevojën për shërbime afatgjata, sidomos në shtëpi, ku një barrë e madhe mbahet nga familjarët, të cilët kanë nevojë për mbështetje.

**Rezultati i pritshëm** Për këtë politikë prioritare është forcimi i kapaciteteve të sistemeve të shërbimeve shëndetësore dhe sociale në mënyrë, që të jenë në gjendje t'i

përgjigjen një proporcioni gjithnjë e më të madh të të moshuarve në popullatë, duke përmirësuar shëndetin e tyre kur kanë nevojë dhe duke lehtësuar përdorimin nga ana e tyre të shërbimeve dhe mbrojtjen përmes mekanizmave financiarë dhe socialë. Kjo do të sigurojë një mirëqenie, autonomi, jetë aktive dhe pjesëmarrje shoqërore për të moshuarit për një kohë sa më të gjatë.

**3.3.1 Objektivi specifik 1 i qëllimit të politikës 2****A. Të zhvillojmë një sistem të integruar shërbimesh shëndetësore dhe sociale me bazë komunitare**

Të moshuarit në Shqipëri ngelen një grup i popullatës me nevoja me të larta për kujdes shëndetësor. Mes të moshuarve ka grupe me nevoja të rritura edhe për kujdes social, për arsye të mungesës së rrjeteve mbështetëse, varfërisë, mobilitetit të reduktuar apo kushteve të banimit dhe të ushqyerjes. Integrimi apo koordinimi mes shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe atyre social do të rriste mundësitë e rehabilitimit të një të moshuari në nevojë, që del nga spitali dhe do të ulte riskun e humbjes së autonomisë dhe gjithë pasojat e rënda që e shoqërojnë atë. Gjithashtu, shumë të moshuar, për arsye të mbivendosjes së sëmundjeve me humbjen e aftësive funksionale, e kanë të nevojshme mbështetjen e vazhduar në nivele të ndryshme të sistemit shëndetësor dhe në burokracinë e atij të mbrojtjes sociale. Ndërkohë që në Shqipëri, në nivel qendror, ka filluar integrimi i dy sistemeve, ngelet ende shumë për të bërë në nivel lokal. Objektivi është futja e mekanizmave koordinues mes shërbimit social dhe shëndetësor në nivel lokal dhe rritja e cilësisë së shërbimeve sociale për të moshuarit. Në këtë mënyrë do të arrihet integrimi i shërbimeve shëndetësore me ato sociale dhe kujdesi i vazhduar për të moshuarit vulnerabël, për të mbështetur moshimin në komunitet dhe autonominë me të madhe të mundshme.

***Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme:***

1. Krijimi i strukturave koordinuese (me persona përgjegjës) mbi mbështetjen sociale pranë operatorëve shëndetësorë rajonalë. Këto struktura do të mundësojnë përgatitjen e informacioneve vjetore në nivel bashkie dhe rajoni mbi numrin, vendndodhjen dhe nevojat e



të moshuarve të sëmurë në nevojë për asistencë sociale dhe ndarjen e këtij informacioni mes bashkive e qendrave të kujdesit shëndetësor parësor.

Tregues: 4 struktura me personat përgjegjës të aprovuara.

2. Përgatitje e një paketë bazë shërbimesh sociale dhe shëndetësore për të moshuarit në komunitet. Paketa do të përfshijë gjithashtu kompetencat e kërkuara, detyrat në nivele të ndryshme dhe standardet e cilësisë.

Tregues: 1) Dokumenti i përgatitur dhe miratuar; 2) 100 000 të moshuar që përfitojnë nga kjo paketë.

### **3.3.2 Objektivi specifik 2 i qëllimit të politikës 2**

#### **B. Të zgjerojmë shërbimet në qendra komunitare dhe të krijojmë modele të apartamenteve si bashkësi.**

Shumica dërmuese e të moshuarve do të dëshironin të jetonin në shtëpitë e tyre, në komunitetin ku kanë lidhjet me familjarët dhe fqinjët. Mjediset publike, të tilla si: qendrat ditore, janë një element i rëndësishëm, që përmirëson cilësitë e mjedisit komunitar dhe mundësitë e tyre për integrim. Do të vijohet me mbështetjen e iniciativave të bashkive për krijimin e qendrave ditore, ku të moshuarit me risk për izolim do të kenë mundësi për t'u integruar në shoqëri, duke ruajtur rrjetet sociale dhe duke krijuar forma të reja të mbështetjes komunitare. Në këtë mënyrë do të shmanget humbja e parakohshme e autonomisë dhe rritja drastike e nevojave për kujdes të specializuar dhe/ose të vazhdueshëm.

Ndërkohë, ende në Shqipëri, shumë nevoja për qendra rezidenciale ngelen ende të paplotësuara, si për arsye të mangësive historike, por sidomos për arsye të ndryshimeve të shpejta demografike, të kombinuara me një nivel të lartë emigracioni mes grup-moshave të afta për punë, të cilat tradicionalisht kanë mbajtur barrën e mbështetjes apo kujdesit për të moshuarit me nevoja të veçanta. Një pjesë e tyre mund të adresohen përmes shtimit të qendrave të specializuara rezidenciale për të moshuarit dhe të sëmurët rëndë, të cilët vuajnë nga ndryshime të përhershme të gjendjes shëndetësore. Një model i ri që do të pilotohet është ai i banesave të specializuara, përmes të cilit do të mund të mbulohen nevoja akute për strehim afatgjatë, të

disa kategorive të të moshuarve në risk për braktisje dhe izolim.

#### ***Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme:***

1. Krijimi i qendrave të reja ditore komunitare pranë bashkive. Qendrat do të shërbejnë si mjedise të sigurta për të moshuarit më në nevojë dhe do të ofrojnë veç të tjerash, edhe kujdes shëndetësor e social.

Tregues: 1) 10 qendra të reja ditore. 20 bashki ofrojnë të paktën një qendër ditore për të moshuarit; 2) 3000 të moshuar që vizitojnë të paktën një herë në muaj një qendër ditore.

2. Krijimi i një modeli në Tiranë me banesa të specializuara, sipas nenit 59, të ligjit nr. 22/2018, “Për Strehimin Social”, të cilat do të jepen me qira të përballueshme, sipas nenit 3, të ligjit nr. 22/2018, për të moshuar vulnerabël dhe të papastrehë, në bashkëpunim me qeverisë dhe bashkisë.

Tregues: 50 banesa të specializuara për të moshuarit, me kontratë qiraje ose uzurfrukti, të cilët paguajnë qira të përballueshme, sipas nenit 3, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”.

3. Krijimi i një qendre të re rezidenciale për kujdes afatgjatë për të moshuarit dhe të sëmurët rëndë, të cilët vuajnë nga ndryshime të përhershme të gjendjes shëndetësore, të financuar plotësisht nga buxheti i shtetit ose përmes skemave të partneritetit publik-privat.

Tregues: Një qendër e re rezidenciale ofron strehim dhe shërbime social shëndetësore afatgjatë për 100 të moshuar.

### **3.3.3 Objektivi specifik 3 i qëllimit të politikës 2**

#### **C. Të ngremë shërbimin e asistencës në shtëpi për të moshuarit me humbje të autonomisë**

Rritja e proporcionit të të moshuarve në vendin tonë është shoqëruar me zvogëlimin e familjeve dhe largimin e të rinjve në kërkim të punës. Kjo i ka rritur nga njëra anë nevojat për kujdestarë për të moshuarit me kufizim të autonomisë dhe nga ana tjetër ka rritur stresin te partnerët e moshuar dhe sidomos gratë, të cilat mbajnë një barrë të madhe të shërbimeve, që ngelet shpesh e panjohur dhe e paformalizuar nga shoqëria.

Mbështetja që jep familja për të moshuarin dhe përfshirja e anëtarëve të familjes në ofrimin e shërbimeve, duhet të shndërrohet në një pjesë integrale e kujdesit për të moshuarit në Shqipëri.



Mbështetja për kujdestarët informalë është një nga investimet me efektive në fushën e kujdesit afatgjatë për të moshuarit. Produktiviteti i këtij grupi ofruesish shërbimesh (sepse duhen konsideruar si të tillë) mund të rritet, çka do të çonte në përmirësim të cilësisë së kujdesit, kosto më të ulëta të sistemeve shëndetësore dhe sociale dhe, gjithashtu, në ulje të riskut për komplikacione shëndetësore. Për këtë arsye anëtarët e familjes që luajnë rolin e kujdestarëve për të moshuarit e sëmure nevojitet të marrin maksimumin e mbështetjes në formën e edukimit/informimit, këshillimit psikologjik, lehtësimit të komunikimit me institucionet dhe formalizimit të tyre në tregun e punës përmes stimuljeve financiare.

Sigurimi i “moshimit në vendbanim”, duke promovuar shërbime dhe mbështetje për individin dhe familjen, do t'i lejojë të moshuarit të vijnë në jetë sa më gjatë që mundet në komunitetin dhe mjedisin e tij.

Synimi është të shndërrohet kujdesi informal, i cili ofrohet zakonisht nga familja dhe zakonisht nga gratë, në një aktivitet të qëndrueshëm dhe me cilësi, duke përmirësuar mirëqenien e atyre që kanë nevojë për kujdes, por edhe të atyre që ofrojnë kujdes (kujdestarëve). Një fokus i veçantë të numri në rritje i personave me *dementia senile*.

#### ***Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme:***

1. Përgatitjeje e udhërrëfyesve mbi sigurimin e zbatimit të standardeve të kujdesit në shtëpi për të moshuarit. Përgatitjeje e manualit të vetëdihmës për kujdesin e të moshuarit në kushtet e shtëpisë, bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare. Organizim i një kursi afatshkurtër të trajnimit dhe i një *website*-i me informacion mbi kujdesin në shtëpi për të moshuarit.

Tregues: 1) Udhërrëfyesit dhe manualët të përgatitur; 2) *Website* i ndërtuar dhe i pajisur me informacion. 3) Kurse trajnimi të organizuara me pjesëmarrja të kujdestarëve.

2. Përcaktim i personelit të dedikuar dhe organizim i vizitave sistematike (të përmuajshme në shtëpitë e të moshuarve me humbje të autonomisë dhe të paktën 2 vizita në vit në shtëpitë e të moshuarve mbi 80 vjeç, pavarësisht shkallës së autonomisë), me përfshirje të infermierëve të kujdesit shëndetësor parësor dhe punonjësve socialë. Vlerësim i kushteve në shtëpi, përgatitja e planeve të kujdesit në shtëpi dhe mbështetja, aty ku

është e nevojshme, e kujdestarëve me instruksione për shërbime të specializuara, si: ndërrimi i kateterit, trajtimi i plagëve kronike etj.

Tregues: 1) 300 personel infermier dhe punonjës socialë të dedikuar për vizita në shtëpi; 2) 50 000 vizita të kryera në vit.

3. Rishikim i kornizës ligjore për mbështetjen sociale të kujdestarëve familjarë/ndihmësve personalë dhe njohjen e tij (p.sh., mundësimi i një leje të veçantë për të afërmit/kujdestarë që punojnë, sipas modelit të lejes së lindjes, lehtësimi i kthimit në tregun e punës për kujdestarët informale mbi 50 vjeç, rregullimi i pensionit për ta, priorizimi në listat e të pastrehëve etj.).

Tregues: Draftpaketa e ndryshimeve ligjore të nevojshme.

4. Përgatitja e një plani kombëtar të kujdesit për personat me demenca (përfshi sëmundjen e Alzheimer), nga një grup ekspertesh me përfshirjen e përfaqësuesve të kujdestarëve informale.

Tregues: Plani i përgatitur dhe i financuar.

#### **3.3.4 Objektivi specifik 4 i qëllimit të politikës 2**

##### **D. Të rrisim kapacitetet geriatrike dhe gerontologjike të profesionistëve shëndetësorë dhe socialë.**

Puna dhe kujdesi më të moshuarit duhet të adresojë shumë specifika të shfaqjes së problemeve shëndetësore tek ata, të tilla si: paraqitja atipike e sëmundjeve, multipatologjitë, kombinimi i shumë mjekimeve, kombinimi i nevojave shëndetësore me ato sociale, si dhe çështje specifike të komunikimit me të moshuarit. Kapacitetet në geriatri dhe gerontologji janë të pamjaftueshme në të gjitha nivelet. Kjo përfshin, si boshllëqet në njohuri të mjekët e përgjithshëm dhe profesionistët e tjerë shëndetësorë, ashtu edhe kualifikimin e specializuar në geriatri. Ndërkohë, që në paketën e shërbimeve bazë të kujdesit shëndetësor parësor janë përfshirë një sërë shërbimesh me natyrë geriatrike të dedikuara për të moshuarit, ende vërehen shumë probleme lidhur me cilësinë e kujdesit të ofruar, që vijnë si pasojë e mungesës së trajnimit të përshtatshëm në fushën e kujdesit për të moshuarit. Nëse për infermierët dhe punonjësit socialë janë përfshirë disa elemente lidhur me geriatrinë dhe gerontologjinë në programet e arsimimit universitar, kjo nuk ka ndodhur me arsimimin universitar të mjekëve, ndërkohë që kanë munguar trajnimet e edukimit të vazhduar në këtë fushë.



Investimi në këtë fushë do të ishte ndërhyrja me kosto efektive për fuqizimin e sistemit shëndetësor me fokus të moshuarin dhe rritjen e kapaciteteve të përgjithshme të shëndetit publik

Është i nevojshëm adaptimi proceseve të planifikimit dhe monitorimit të burimeve njerëzore në sistemin e kujdesit shëndetësor e social, në mënyrë të tillë që të sigurohen numrat dhe kualifikimet e përshtatshme të personelit për një popullatë gjithmonë e më të moshuar.

#### ***Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme:***

1. Përgatitja e protokolleve dhe e instrumenteve specifike për mjekët dhe infermierët e kujdesit shëndetësor parësor, lidhur me vlerësimin e problemeve prevalente të të moshuarit të tilla, si: rënia e aftësive konjitive, dhimbja, rënia e shikimit dhe e dëgjimit, rënia e mobilitetit dhe e hapësirës jetike, menaxhimin e multipatologjive, këshillimin mbi medikamentet etj. Udhërrëfyes specifikë lidhur me shërbimet e kujdesit dentar, oftalmologjik, audiologjik dhe fizioterapeutik për të moshuarit.

Tregues: 1) Protokoll klinik dhe udhërrëfyesit të përgatitur; 2) 400 qendra shëndetësore të pajisura me paketën e instrumenteve përkatëse; 3) 50 000 vizita për të moshuarit në kujdesin parësor me cilësi të përmirësuar.

2. Përgatitje e një programi intensiv për trajnimin mbi geriatrinë në nivel kombëtar. Organizim i kurseve afatshkurtra të trajnimit, si pjesë e edukimit të vazhduar.

Tregues: 1. 5 kurse të akredituar; 2. 100 pjesëmarrës.

3. Riorganizim i shërbimeve me shtretër dhe adaptim i normave, që garantojnë shpërndarje të përshtatshme të shtretërve spitalorë, për kujdesin afatgjatë për të moshuarit. Pilotimi i njësive të dedikuara për kujdesin geriatrik në Qendrën Spitalore Universitare dhe 2 spitale rajonale me standard orientues minimal 2 shtretër për 1000 banorë mbi 65 vjeç, përfshi shtretër psikiatrikë për të moshuar. Përcaktim i shtretërve të dedikuar në kujdesin paliativ.

Tregues: 1) Plani i miratuar; 2) 5 njësi pilote funksionale pranë spitaleve të përzgjedhura.

#### **3.4 Politika 3. Promovimi i shëndetit, mirëqenies së të moshuarve dhe ndërgjegjësimi i shoqërisë mbi moshimin**

Shëndeti dhe aktiviteti në moshë të vjetër janë rezultat i rrethanave dhe i sjelljes individuale gjatë

gjithë jetës. Shoqëria mund të ndihmojë individët të zgjedhin sjellje të shëndetshme në çdo moment të jetës. Duke u përpjekur për një stil jete më të shëndetshëm në faza të ndryshme të jetës dhe duke u adaptuar me ndryshimet e lidhura me moshën, individët do të ndikojnë në moshimin e tyre të shëndetshëm. Kjo do të ishte edhe qasja me kosto efektive për sigurimin e një jete jo vetëm të gjatë, por edhe autonome e më pak nevoja për asistencë mjekësore e sociale. Kjo politikë strategjike nënvizon dy elemente thelbësore për moshimin e shëndetshëm; aktivitetet e orientuara drejt personave në fillimet e hershme të moshimit, si dhe në parandalimin, përfshirë atë dytësor dhe tretësor.

Moshimi i shëndetshëm është i lidhur edhe me mënyrën, se si e sheh gjithë shoqëria të moshuarin. Nëse shoqëria do ta shihte të moshuarin si një barrë të padobishme, kjo nga njëra anë do të krijonte kushte për më shumë izolim dhe humbje të autonomisë dhe, nga ana tjetër do të shtonte riskun e abuzimit me të moshuarit. Për këtë arsye, pjesë e rëndësishme e kësaj politike do të jetë edhe ndërgjegjësimi i shoqërisë mbi imazhin pozitiv të moshimit (moshimi si fazë natyrale e zhvillimit të individit) dhe lufta kundër diskriminimit apo abuzimit me të moshuarit.

**Rezultati i pritshëm** për këtë politikë prioritarë është promovimi më i mirë i shëndetit dhe i parandalimit të sëmundjeve në të gjitha moshat dhe në të gjitha nivelet e shoqërisë. Gjithashtu, pritjet të arrihet një ulje e invaliditetit dhe abuzimit të të moshuarit, për një moshim të shëndetshëm, si dhe një imazh pozitiv i moshimit në shoqëri.

#### **3.4.1 Objektivi specifik 1 i qëllimit të politikës 3**

**A. Të rrisim ndërgjegjësimin dhe informacionin mes personave mbi 50 vjeç lidhur me mënyrat, sjelljet e praktikat, për moshimin e shëndetshëm, aktiv dhe jetën autonome në moshë të vjetër.**

Shëndeti në moshë të vjetër është rezultat i kushteve të jetesës dhe i stilit të jetesës së një individi gjatë gjithë jetës së tij. Duke u përpjekur për një stil jete më të shëndetshëm në faza të ndryshme të jetës dhe duke u përshtatur me ndryshimet e lidhura me moshën, individët mund të ndikojnë në moshimin e tyre të shëndetshëm.





Gjithashtu, lidhja midis parandalimit të sëmundjeve kronike dhe moshimit të shëndetshëm, është nënvizuar në dokumente bazë të Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Kjo ndërhyrje fokusohet te grup-moshat e fillimit të moshimit, ata mbi 50 vjeç dhe përfshin veç parandalimit parësor edhe atë dytësor e tretësor. Më tej, pa harruar aktivitetet kundër duhanpirjes, abuzimit me alkoolin dhe kontrollit të peshës trupore, theksi do të vendoset në tre grup-aktivitetesh, që janë më specifike për cilësinë e jetës së të moshuarve dhe janë provuar si më efektive për të siguruar një jetë autonome në moshë të vjetër: aktiviteti fizik, parandalimi i rrëzimeve dhe kapja e hershme e depresionit.

Niveli i aktiviteti fizik është ndër treguesit më efektivë të moshimit të shëndetshëm, sidomos për moshat shumë të vjetra. Aktiviteti fizik mund të përmirësojë funksionet respiratore të mobilitetit dhe të ulë riskun për sëmundje kronike, depresion dhe demenca.

Rrëzimet te të moshuarit janë ndër shkaqet e rëndësishme të uljes së mobilitetit, një risk madhor për humbje të autonomisë funksionale. Disa prej tyre (si, p.sh., frakturat e femurit), zakonisht kërkojnë procedura spitalore me kosto shumë të lartë. Risku i rrëzimeve rritet shpejt me rritjen e moshës. Shumica e rrëzimeve janë të parandalueshme.

Megjithëse programi kombëtar i kontrollit shëndetësor bazë ka përfshirë edhe grupe të personave mbi 65 vjeç, përdorimi i disa teknikave të identifikimit dhe të menaxhimit të hershëm të problemeve shëndetësore, si p.sh., depresioni, ngelet në nivele mjaft të ulëta.

#### ***Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme:***

1. Rritja e ndërgjegjësimit të popullatës së adulateve të vjetër dhe të moshuarve mbi moshimin e shëndetshëm dhe aktiv, si dhe parandalimin e sëmundjeve dhe dëmtimeve.

Tregues: 1) 5 fushata të organizuara; 2) 200 000 kanë marrë informacion.

2. Rritje e përdorimit sistematik të programeve të kapjes së hershme të hipertensionit dhe të diabetit, pranë shërbimeve të kujdesit shëndetësor, nga popullata mbi 50 vjeç. Rritja e ndërgjegjësimit mbi depresionin te të moshuarit dhe lufta kundër stigmës, në kuadër të identifikimit të hershëm të shenjave dhe

menaxhimit të përshtatshëm në shërbimet e kujdesit parësor.

Tregues: 1) 80% e personave mbi 50 vjeç ka kryer të paktën një ekzaminim për hipertensionin dhe diabetin; 2) 50% popullatës mbi 50 vjeç që ka kryer pyetësorin e depresionit, në programin e kontrollit bazë shëndetësor.

3. Përgatitje e instruksioneve/standardeve për parandalimin e rrëzimeve të të moshuarve në institucionet e kujdesit dhe në vendbanim, për personat mbi 70 vjeç. Sigurimi i pajisjeve mbrojtëse (*hip protectors*) personat mbi 70 vjeç në risk të lartë.

Tregues: 1) Instruksionet/standardet të përgatitura; 2) 500 institucione kanë filluar t'i aplikojnë; 3) 500 pajisje të shpërndara.

#### **3.4.2 Objektiv specifik 2 i qëllimit të politikës 3**

**B. Të përmirësojmë informimin e publikut mbi moshimin, duke dekurajuar të gjitha format e paragjykitimit e diskriminimit.**

Në shoqëri ende është i përhapur opinioni mbi të moshuarin, si individ i sëmurë, i dobët dhe barrë për familjen. Ky këndvështrim ka prirje të krijojë stigmë mbi moshimin, barrierë për integrimin e të moshuarve dhe risk për abuzim e diskriminim. Në të vërtetë, moshimi është një fazë natyrale e zhvillimit të individit dhe shumica dërrmuese e të moshuarve kanë një potencial të madh për vijim të ndikimit aktiv në shoqëri. Është e nevojshme që ata të mbështeten për të shprehur këtë potencial.

#### ***Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme:***

1. Përfshirje e institucioneve të shëndetit e të mbrojtjes sociale, në bashkëpunim me avokatin e popullit, në fushatat për mbrojtjen e dinjitetit të të moshuarve, sidomos e atyre me invaliditet, si dhe inkurajimi i vetëvlerësimit të tyre, përmes luftimit të çdo forme paragjykimi, neglizhimi, abuzimi dhe diskriminimi.

Tregues: 5 fushata informimi.

2. Zhvillimi i imazheve jodiskriminuese të të moshuarve dhe përhapja e informacionit pozitiv rreth tyre, në bashkëpunim me massmediet. Përfshirja e të moshuarve në planifikim, zbatim dhe vlerësim të programeve të tilla.

Tregues: 5 fushata informimi.

#### **3.4.3 Objektiv specifik 3 i qëllimit të politikës 3**



### **C. Të përmirësojmë sistemin e informacionit mbi moshimin dhe monitorimin e shëndetit/mirëqenies së të moshuarve.**

Tradicionalisht sistemet e informacionit shëndetësor dhe treguesit e monitorimit të shërbimeve janë fokusuar në shëndetin e nenave, fëmijëve dhe të rinjve. Kjo ka ardhur si përgjigje ndaj profilit të riskut në popullatë dhe e prioritetizimit në politika të këtyre grupeve demografike. Mangësitë në informacion, lidhur me të moshuarit, janë sidomos të dukshme në vlerësimin e gjendjes shëndetësore dhe sociale, përmes studimeve periodike në popullatë. Është e nevojshme që politikat e reja mbi moshimin të mbështeten me informacion sistematik dhe të besueshëm.

#### ***Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme:***

1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të angazhohet në bashkëpunim me INSTAT-in, Institutin e Shëndetit Publik dhe Shërbimin Social Shtetëror në përgatitjen e një seti indikatorësh mbi moshimin bazuar në standardet ndërkombëtare. Indikatorët do të duhet të përfshijnë gjendjen shëndetësore, ekonomike, përfshirjen sociale etj. dhe shërbimet për të moshuarit.

Tregues: Korniza e indikatorëve e përgatitur dhe funksionale.

2. Kryerja e një studimi të standardizuar në popullatën e personave mbi 65 vjeç, çdo 5 vjet dhe përgatitja e një raporti kombëtar çdo 5 vjet mbi gjendjen e të moshuarve bazuar në të dhënat e INSTAT-it.

Tregues: 1 studim i kryer; 1 raport i përgatitur.

#### **4. Monitorimi dhe llogaridhënia**

Monitorimi i Planit të Veprimit mbi Moshimin do të drejtohet nga grupi tematik për përfshirjen sociale, brenda strukturës së grupit për menaxhimin e integruar të politikave (GMIP) të miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ ndërsektorial të integruar”.

*Grupi i treguesve dhe integritetit të statistikave (GTIS) do të bashkërendojë aktivitetin monitorues me Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Sektori i Politikave dhe Strategjive për Përkujdesjen Shoqërore dhe shërbimet*

*sociale të integruara, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.*

I gjithë procesi do të kryhet me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga institucionet kryesore kombëtare përgjegjëse për shëndetin dhe mbrojtjen sociale (përfshi Shërbimi Social Shtetëror dhe Instituti i Shëndetit Publik), arsimin strehimin, të drejtat e njeriut, institucionet e qeverisjes vendore, INSTAT-in, përfaqësuesit nga qarqet akademike dhe qendrat universitare, shoqëria civile (përfaqësues të shoqatave të pensionisteve) etj.

Draftet e raporteve, çdo dyvjeçarë të monitorimit, do të përgatiten në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Sektori i Politikave dhe i Strategjive për Përkujdesjen Shoqërore dhe Shërbimet Sociale të Integruara dhe do të miratohen nga GMIP-ja.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 12, 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 151/2014, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e shërbimeve mjedisore”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim notash, të marrëveshjes së huas, të datës 25 korrik 2014, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e shërbimeve mjedisore, ratifikuar me ligjin nr. 151/2014, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR  
Edi Rama**

Banka Botërore  
IBRD • IDA GRUPI I BANKËS BOTËRORE  
Pratertrasse 31/21  
Vienna, Austria, 1020  
LINDA VAN GELDER

**Drejtoresha Rajonale për Ballkanin  
Perëndimor, Evropën dhe Azinë Qendrore**

**30 shtator 2019****Sh. s. Anila Denaj****Ministër e Financave dhe Ekonomisë****Tiranë, Shqipëri**

E nderuar znj. Ministre,

*Projekti i shërbimeve mjedisore në Shqipëri*

*IBRD Huaja 8401-AL*

*Riallokimi i të ardhurave të huas dhe zgjatje e afatit të mbylljes*

Referuar marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka), datë 25 korrik, 2014, për projektin e shërbimeve mjedisore (Projekti) dhe letrës suaj, datë 12 shtator 2019, ku Bankës Botërore i kërkohet riallokimi i të ardhurave të huas midis kategorive të disbursimit, si edhe zgjatje të afatit të mbylljes, nga 30 shtator 2019, deri në datën 30 shtator 2020.

Kemi kënaqësinë t’ju njoftojmë se Banka Botërore bie dakord me kërkesën tuaj dhe:

a) rialokon të ardhurat e huas sipas paragrafit IV.A.2, të skedulit të marrëveshjes së huas, siç përcaktohet në shtojcën 1 të kësaj letre; dhe b) cakton datën 30 shtator 2020, si datë të mëvonshme për qëllime të paragrafit IV.B.2, të skedulit 2, të marrëveshjes së huas.

Me respekt,

Nënshkrimi

Linda Van Gelder

Drejtoresha Rajonale për Ballkanin Perëndimor,  
Evropën dhe Azinë Qendrore

Në vëmendje të: Sh. s. Blendi Klosi - Ministër i Turizmit dhe Mjedisit

Z. Erjon Luci - Zëvendësministër i Financave

Znj. Petra Burcher - Shefe e Bashkëpunimit për Zhvillim, Ambasada Suedeze

Z. Tomas Nystrom - Drejtues i Programit, Ambasada Suedeze

Znj. Majlinda Dhuka - Zv. Sekretare e Përgjithshme dhe Drejtoresha e Përgjithshme e Departamentit për Zhvillim dhe Mirëqeverisje

Z. Patrizio Pagano - Drejtor Ekzekutiv, Banka Botërore

Sh. s. Anila Denaj

Sh. s. Anila Denaj 30 shtator 2019



Tabela në paragrafin IV.A.2, të skedulit 2, të marrëveshjes së huas, është ndryshuar si më poshtë:

| Kategoria                                                                                         | Shuma e grantit të alokuar shprehur në euro | Përqindja e shpenzimeve për t'u financuar (duke përfshirë taksat)                                                          |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1. Materiale dhe shërbime jokonsulence sipas pjesës 1/a, pjesës 2/c dhe pjesës 4/ a, të projektit | 5,239,472/93                                | 100%                                                                                                                       |
| 2. Nënprojekte sipas pjesës 2/b të projektit                                                      | 2,042,277.07                                | 100%                                                                                                                       |
| 3. Tarifa fillestare                                                                              | 18,250                                      | Shuma e pagueshme sipas paragrafit 2.3 të kësaj marrëveshje, në përputhje me paragrafin 2.07/b të Kushteve të Përgjithshme |
| Shuma totale                                                                                      | 7,300,000                                   |                                                                                                                            |

Sh. s. Anila Denaj

Miratuar nga: Kseniya Lvovsky, Menaxhere e Praktikave, GENEC - Damir Leljak (WFACS)

Për dijeni: Linda Van Gelder, Maryam Salim, Kseniya Lvovsky, Luis M.Schwarz, Damir Leljak, Drita Dade, Silvia Mauri, Arben Maho, Jonida Myftiu, BekimImeri, Esma Kreso, Elona Qana, Simon Ellis, Lada Strellkova, Goran Tinjic, Daria Lavrentieva, Valentina Martinovic, Nejme Kotere, Evis Sulko, Luz Meza-Bartrina, Nadeem Mohammad, Albania DL, ECA Operations, Drejtor GENEC GP , ECCWB Ekipi Manaxherial (ECCWB DMT), WB Docs.

Person kontakti: Drita Dade (numri i brendshëm: 5246 137)

**VENDIM**  
**Nr.878, datë 24.12.2019**

**PËR PËRBËRJEN, ORGANIZIMIN,**  
**VEPRIMTARINË DHE RREGULLAT E**  
**FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT**  
**SHTETËROR TË RINDËRTIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 14, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes dhe të ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Ngritjen dhe organizimin e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, si një organ ndërmënyës për bashkërendimin e punës së ministrave,

institucioneve të tjera përgjegjëse si dhe organeve të vetëqeverisjes vendore, të ngarkuara nga akti normativ nr.9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, për të gjitha veprimtaritë që lidhen me dhe që ndikojnë në përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.

2. Komisioni Shtetëror i Rindërtimit koordinon dhe bashkëpunon me autoritetet përgjegjëse, të ngarkuara nga akti normativ nr.9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, për planifikimin e përdorimit të fondit të rindërtimit në funksion të realizimit të programeve të procesit të rindërtimit, me qëllim përgatitjen e propozimeve që i përcillen për miratim Këshillit të Ministrave.

3. Të gjithë termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me ato të përkufizuar në aktin normativ nr.9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”.





## KREU II PËRBËRJA DHE FUNKSIONIMI

1. Komisioni Shtetëror i Rindërtimit është një organ kolegjal, kryesohet nga ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe ka në përbërje këta anëtarë:

- a) Ministrin e Mbrojtjes;
- b) Ministrin e Brendshëm;
- c) Ministrin e Financave dhe Ekonomisë;
- ç) Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- d) Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- dh) Ministrin e Kulturës;
- e) Ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- ë) Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

- f) Ministrin e Turizmit dhe Mjedisit;
- g) Kryetarin e Bashkisë Tiranë, me kërkesë të tij.

2. Në mbledhjet e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, me kërkesë të kryetarit, marrin pjesë pa të drejtë vote dhe përfaqësues të organeve të ndryshme publike, të biznesit, ekspertë/profesionistë të fushës së mbrojtjes civile dhe zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë si dhe përfaqësues të shoqërisë civile ose drejtues të OJF-ve, me objekt veprimtarie mbrojtjen civile dhe ndihmën humanitare.

3. Vendimet e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit janë të vlefshme kur sigurohet pjesëmarrja e, të paktën, 2/3 të anëtarëve.

4. Në mungesë të kryetarit, mbledhjen e drejton një nga anëtarët e autorizuar nga kryetari ose anëtar i më i vjetër në moshë.

5. Në rast të numrit të barabartë të votave “pro” dhe “kundër”, vota e kryetarit të komisionit konsiderohet përcaktuese.

6. Votimi bëhet i hapur në prezencë të sekretarit të Komisionit, i cili mban procesverbal dhe regjistron votat e anëtarëve të Komisionit.

7. Sekretari i Komisionit caktohet nga ministri i Shtetit për Rindërtimin, ndër punonjësit e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile ose një punonjës tjetër i administratës publike, i cili nuk ka të drejtë vote dhe nuk nënshkruan në vendim.

8. Vendimet dhe procesverbalet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës. Vendimet duhet të jenë të argumentuara dhe, në çdo rast, vota “kundër” duhet të pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes.

9. Vendimet e komisionit përgatiten në dy kopje, të cilat mbahen në sekretariatin teknik të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit.

10. Mbledhjet thirren me kërkesë të kryetarit ose kur e kërkojnë jo më pak se 1/3 e të gjithë anëtarëve të Komisionit.

11. Materialet që do të shqyrtohen në mbledhje u vihen në dispozicion anëtarëve të Komisionit, jo më vonë se 2 ditë nga data e mbledhjes.

12. Komisioni Shtetëror i Rindërtimit ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, Komisioni Shtetëror i Rindërtimit”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

13. Vula e Komisionit ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e përdorimit, të administrimit, të kontrollit dhe të ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet e ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

14. Komisioni Shtetëror i Rindërtimit përfaqësohet nga kryetari.

15. Komisioni Shtetëror i Rindërtimit e ushtron veprimtarinë e tij sipas parashikimeve të këtij vendimi dhe, për aq sa është e mundur, në bazë të legjislacionit në fuqi për organet kolegjiale.

16. E gjithë veprimtaria administrative e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit mbështetet nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, në cilësinë e sekretariatit teknik të tij.

17. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile përballon shpenzimet për funksionet e parashikuara nga ky vendim, nëpërmjet buxhetit të vet ose me financime nga fondi i rindërtimit, të financuara nga buxheti i shtetit, me miratim nga Këshilli i Ministrave.

## KREU III VEPRIMTARIA E KOMISIONIT

1. Komisioni Shtetëror i Rindërtimit, në cilësinë e autoritetit shtetëror përgjegjës për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, ushtron këto kompetenca:

- a) Harton dhe miraton programin e përgjithshëm të rindërtimit;





b) Bashkërendon veprimtarinë e institucioneve shtetërore dhe të subjekteve private, përfshirë dhe donatorët, në përputhje me programin e përgjithshëm të rindërtimit, si dhe me procesin e rindërtimit;

c) Në konsultim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet ministrit përgjegjës për rindërtimin, i propozon Këshillit të Ministrave shpalljen e zonave të reja për zhvillim;

ç) Siguron informimin e publikut dhe transparencën mbi procesin e rindërtimit;

d) Propozon, nëpërmjet ministrit përgjegjës për rindërtimin, pranë Këshillit të Ministrave, përdorimin e fondit të rindërtimit nga njësitë zbatuese dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, përcaktimin e njësive zbatuese për projektet në kuadër të procesit të rindërtimit;

dh) Monitoron periodikisht zbatimin e programit dhe të detyrave të caktuara njësive zbatuese dhe përgatit raporte për Këshillin e Ministrave;

e) Përcjell dhe propozon, nëpërmjet ministrit përgjegjës për rindërtimin, pranë Këshillit të Ministrave, projektvendimet që kanë të bëjnë me çështjet e adresuara nga njësitë zbatuese.

2. Programi i përgjithshëm i rindërtimit hartohet dhe miratohet nga Komisioni Shtetëror i Rindërtimit, brenda 2 muajve nga shpallja e tij.

3. Komisioni Shtetëror i Rindërtimit mund të kontrakttojë ekspertë gjatë hartimit të programit të përgjithshëm të rindërtimit, nëpërmjet procedurave të prokurimit, të parashikuara në kreun VI, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”.

4. Në funksion të përgatitjes së programit të përgjithshëm të rindërtimit, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe çdo institucion tjetër përgjegjës, vë në dispozicion të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit ose të ekspertëve të caktuar të dhënat dhe informacionet e nevojshme.

#### KREU IV

#### SEKRETARIATI TEKNIK I KOMISIONIT SHTETËROR TË RINDËRTIMIT

1. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile kryen funksionin e sekretariatit teknik të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit.

2. Me vendim të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, pranë sekretariatit mund të angazhohen edhe specialistë dhe ekspertë të institucioneve të tjera, për trajtimin e çështjeve të caktuara teknike që kanë nevojë për ekspertizë në fusha të ndryshme.

3. AKMC-ja, përveç detyrave të përcaktuara në aktin normativ nr.9, datë 6.12.2019, ka këto përgjegjësi:

a) Administron të gjithë dokumentacionin që është objekt shqyrtimi dhe vendimmarrjeje në Komisionin Shtetëror të Rindërtimit;

b) Merr masa për të njoftuar dhe organizuar mbledhjet e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit;

c) Ka përgjegjësi për të organizuar, drejtuar dhe bashkërenduar procesin me autoritetet e tjera përgjegjëse, në nivel qendror dhe/ose vendor, me qëllim përgatitjen për shqyrtim dhe miratim të akteve në kompetencë të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit;

ç). Përgatit projektaktet që do të miratohen nga Komisioni Shtetëror i Rindërtimit, pas shqyrtimit të propozimeve të përcjella nga njësitë zbatuese, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e tjera qendrore apo iniciativave të drejtpërdrejta të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit.

4. Projektakti së bashku me dokumentacionin shoqërues përgatiten nga AKMC-ja dhe përpara miratimit, me nënshkrim të kryetarit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, i përcillet për mendim ministrave dhe institucioneve të tjera përgjegjëse, që nuk janë të përfaqësuara në Komision, fusha e veprimtarisë të të cilave preket nga parashikimet e projektaktit.

5. Ministritë dhe institucionet e përcaktuara në pikën 4, të këtij kreu, përcjellin zyrtarisht mendimin e tyre për projektaktin, jo më vonë se 5 ditë pune nga data e marrjes së tij.

6. Projektakti, i cili, për aq sa është e mundur, ka pasqyruar vërejtjet dhe sugjerimet e ministrave dhe të titullarëve të institucioneve të tjera të interesuara, jo më vonë se 2 ditë kalendarike nga thirrja e mbledhjes, u dërgohet dhe një herë për njohje anëtarëve të Komisionit.

7. Në përfundim të procesit të hartimit dhe të bashkërendimit me mendimet e anëtarëve të tjerë e të drejtuesve të institucioneve të interesuara, Kryetari paraqet projektaktin për shqyrtim pranë Komisionit Kombëtar të Rindërtimit, në datën dhe orën e përcaktuar.



8. AKMC-ja mban regjistër protokollit më vete për gjithë veprimtarinë e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

#### KREU V

#### DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Komisioni Shtetëror i Rindërtimit kryen veprimtarinë e tij deri në rindërtimin dhe rehabilitimin e plotë të të dëmtuarve nga fatkeqësitë natyrore apo fatkeqësitë e tjera.

2. Komisioni Shtetëror i Rindërtimit konsiderohet i krijuar në mbledhjen e parë të tij, ku duhet të marrin pjesë të gjithë anëtarët. Ministri përgjegjës për rindërtimin thërret mbledhjen e parë të Komisionit. AKMC-ja, në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për rindërtimin, merr masat për organizimin e kësaj mbledhjeje dhe përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm.

3. Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile, pas përfundimit të funksionimit të tij, kalon në dorëzim të gjithë dokumentacionin përkatës në përgjegjësi të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes dhe ministrit i Shtetit për Rindërtimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

**Edi Rama**

#### URDHËR

**Nr. 451, datë 18.12.2019**

#### **PËR APLIKIMIN VETËM ONLINE TË DISA SHËRBIMEVE TË MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË NGA DATA 1.1.2020**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, vendimit nr. 504, datë 13.9.2017, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë” dhe urdhrit të Kryeministrit nr. 153, datë 25.11.2019, “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm *online* nga data 1.1.2020”,

#### URDHËROJ:

1. Të gjitha dokumentet administrative që shërbejnë si dokumentacion për marrjen e shërbimeve elektronike në portalin *e-Albania*, duke nisur nga data 1.1.2020 do të ofrohen dhe shkëmbehen vetëm elektronikisht përmes Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik.

2. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, si dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë, të përcaktuar në këtë urdhër, të cilët lëshojnë dokumente që janë shoqëruese për aplikimet që do të jenë vetëm *online*, të aplikojnë menjëherë për t'u pajisur me nënshkrim elektronik, nëpërmjet Portalit Qeveritar *e-Albania*.

3. Paraqitja e kërkesave për marrjen e shërbimeve *online*, nëpërmjet sistemit *online*, duke filluar nga data 1.1.2020, bëhet vetëm për shërbimet e listuara në aneksin nr. 1 të këtij urdhri, i cili është pjesë përbërëse e tij.

4. Personat që përdorin Sistemin e Qarkullimit të Dokumenteve të shërbimeve *online*, me qëllim kërkimin dhe/ose ofrimin e dokumenteve shoqëruese, të dokumenteve me nënshkrimin elektronik, autorizohen nga titullarët e institucioneve të varësisë.

5. Ngarkohen titullarët e institucioneve të varësisë, të përcaktuar në këtë urdhër, që brenda datës 20.12.2019, të përcaktojnë dhe të dërgojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme Rregulatore dhe Përputhshmërisë në Infrastrukturë dhe Energji emrat e personave të autorizuar, sipas pikës 4 të këtij urdhri.

6. Ngarkohet Sektori i Teknologjisë së Informacionit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, që në bashkëpunim me AKSHI-n, të trajtojë personat e autorizuar mbi procedurat e ofrimit të shërbimeve dhe aksesimit në Sistemin e Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik.

7. Të gjitha institucionet e ngarkuara për zbatimin e këtij urdhri mundësojnë informimin dhe sensibilizimin e publikut mbi aplikimet e shërbimeve që do të ofrohen vetëm në Portalin Qeveritar *e-Albania*.

8. Ngarkohen drejtorët e drejtorive brenda aparatit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe titullarët e institucioneve të varësisë, që, brenda datës 24.12.2019, të informojnë pranë



adresës elektronike: [sekretariasp@infrastruktura.gov.al](mailto:sekretariasp@infrastruktura.gov.al), mbi konfirmimet për aplikimet e kryera në Portalin Qeveritar e-Albania.

9. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, që, brenda datës 27.12.2019, të raportojë pranë ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, mbi aplikimet e kryera.

10. Ngarkohen të gjitha strukturat e ministrisë dhe institucionet e përcaktuara në këtë urdhër, që nëse është e nevojshme për zbatimin e tij, të përgatisin dhe përcjellin në ministri propozimet për ndryshimet e akteve nënligjore.

11. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Infrastrukturë dhe Energji, Sektori i Teknologjisë së Informacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit dhe Drejtoria e Përgjithshme Detare, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE  
ENERGJISË  
**Belinda Balluku**

#### ANEKSI NR. 1

SHËRBIMET QË MUND TË OFROHEN VETËM ONLINE PREJ DATËS 1.1.2020

| Nr. | Institucioni                              | Titulli                                                                                                                                                     | Afati për kalimin vetëm online |
|-----|-------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------|
| 1.  | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | Aplikim për mbylljen e aktivitetit të shoqërisë në fushën e studimit e të projektimit, dhe/ose të mbikëqyrjes e të kolaudimit                               | 1 janar 2020                   |
| 2.  | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | Aplikim për dublikatë apo zgjatje të afatit të licencës së shoqërisë në fushën e studimit e të projektimit, dhe/ose të mbikëqyrjes e të kolaudimit          | 1 janar 2020                   |
| 3.  | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | Aplikim për ekuivalentimin e licencës së huaj individuale në studim e projektim, dhe/ose në mbikëqyrje e në kolaudim                                        | 1 janar 2020                   |
| 4.  | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | Aplikim për ekuivalentimin e licencës së shoqërive të huaja, në studim e në projektim, dhe/ose në mbikëqyrje e në kolaudim                                  | 1 janar 2020                   |
| 5.  | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | Aplikim për ndryshim ose shtesa të drejtuesit/drejtuesve teknikë të shoqërisë në fushën e studimit e të projektimit, dhe/ose të mbikëqyrjes e të kolaudimit | 1 janar 2020                   |
| 6.  | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | Aplikim për pajisjen me dublikatë të licencës individuale në studim e në projektim, dhe/ose në mbikëqyrje e në kolaudim                                     | 1 janar 2020                   |
| 7.  | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | Aplikim për pajisjen për herë të parë me licencë individuale në studim e në projektim, dhe/ose në mbikëqyrje e në kolaudim                                  | 1 janar 2020                   |
| 8.  | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | Aplikim për pajisjen për herë të parë, me licencë shoqërie në fushën e studimit e të projektimit, dhe/ose të mbikëqyrjes e të kolaudimit                    | 1 janar 2020                   |



|     |                                           |                                                                                                                                                                                                      |              |
|-----|-------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------|
| 9.  | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | Aplikim për pajisje me shtesa në kategoritë e licencës individuale në studim e në projektim, dhe/ose në mbikëqyrje e në kolaudim                                                                     | 1 janar 2020 |
| 10. | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | Aplikim për pajisje me shtesa në kategoritë e licencës së shoqërisë në fushën e studimit e të projektimit, dhe/ose të mbikëqyrjes e të kolaudimit                                                    | 1 janar 2020 |
| 11. | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | Aplikim për reflektimin e ndryshimit ose shtesës së përfaqësuesit/të përfaqësuesve ligjorë, në licencën e shoqërisë në fushën e studimit e të projektimit, dhe/ose të mbikëqyrjes e të kolaudimit    | 1 janar 2020 |
| 12. | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | Aplikim për reflektimin e ndryshimit të emërimit dhe/ose selisë, në licencën e shoqërisë në studim e në projektim, dhe/ose në mbikëqyrje e në kolaudim                                               | 1 janar 2020 |
| 13. | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | Aplikim për rinovimin e kategorive të licencës individuale në studim e në projektim, dhe/ose në mbikëqyrje e në kolaudim                                                                             | 1 janar 2020 |
| 14. | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | Aplikim për rinovimin e kategorive të licencës së shoqërisë në fushën e studimit e të projektimit, dhe/ose të mbikëqyrjes e të kolaudimit                                                            | 1 janar 2020 |
| 15. | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | Aplikim për kalimin e shkallës së vlerësimit të licencës së shoqërisë, nga e dytë në të parë (ndryshim shkalle vlerësimi për licencat e shoqërive) në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme | 1 janar 2020 |
| 16. | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | Aplikim për licencimin e individëve për herë të parë (shkalla e dytë), për ushtrimin e aktivitetit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme                                                 | 1 janar 2020 |
| 17. | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | Aplikim për licencimin e individëve që kërkojnë shkallën e parë (rritje shkalle nga II në I) në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme                                                       | 1 janar 2020 |
| 18. | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | Aplikim për licencimin e shoqërive për herë të parë në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme                                                                                                | 1 janar 2020 |
| 19. | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | Aplikim për ndryshim apo shtesë të vlerësuesve të punësuar në shoqëri në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme                                                                              | 1 janar 2020 |
| 20. | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | Aplikim për ndryshim të emërimit të shoqërisë, ndryshim të drejtuesve ligjorë apo të selisë së shoqërisë në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme                                           | 1 janar 2020 |
| 21. | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | Aplikim për pajisje me dublikatë të licencës individuale në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme (pas humbjes apo dëmtimit)                                                                | 1 janar 2020 |



|     |                                                             |                                                                                                                   |              |
|-----|-------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------|
| 22. | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë                   | Aplikim për rinovim ose dublikatë të licencës së shoqërisë në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme      | 1 janar 2020 |
| 23. | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë                   | Aplikim për rinovim të licencës individuale në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme                     | 1 janar 2020 |
| 24. | Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit                           | Aplikim për marrje dokumenti teknik arkivor gen-plan A4                                                           | 1 janar 2020 |
| 25. | Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit                           | Aplikim për marrje dokumenti teknik arkivor gen-plan A3                                                           | 1 janar 2020 |
| 26. | Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit                           | Aplikim për marrje dokumenti teknik arkivor dosje pronësie                                                        | 1 janar 2020 |
| 27. | Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit                           | Aplikim për marrje dokumenti teknik arkivor fletë projekti                                                        | 1 janar 2020 |
| 28. | Drejtoria e Përgjithshme Detare                             | Aplikim për lëshimin e certifikatës së minimumit për anijet e transportit të mallrave dhe të peshkimit            | 1 janar 2020 |
| 29. | Drejtoria e Përgjithshme Detare                             | Aplikim për regjistrimin e mjeteve lundruese të shërbimeve portuale                                               | 1 janar 2020 |
| 30. | Drejtoria e Përgjithshme Detare                             | Aplikim për regjistrimin dhe pajisjen me Dëshmi Aftësie Drejtimi të mjeteve të vogla lundruese ( <i>skipper</i> ) | 1 janar 2020 |
| 31. | Drejtoria e Përgjithshme Detare                             | Aplikim për regjistrimin dhe pajisjen me pasaporta lundrimi të marinarëve të flotës tregtare                      | 1 janar 2020 |
| 32. | Drejtoria e Përgjithshme Detare                             | Aplikim për regjistrimin dhe pajisjen me pasaporta lundrimi të peshkatarëve                                       | 1 janar 2020 |
| 33. | Drejtoria e Përgjithshme Detare                             | Aplikim për regjistrimin përfundimtar, regjistrimin provizor të anijeve me kontratë <i>bareboat</i>               | 1 janar 2020 |
| 34. | Drejtoria e Përgjithshme Detare                             | Aplikim për regjistrimin e mjeteve të vogla lundruese deri në 15 metra                                            | 1 janar 2020 |
| 35. | Drejtoria e Përgjithshme Detare                             | Aplikim për regjistrimin e motorëve të detit                                                                      | 1 janar 2020 |
| 36. | Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor | Aplikim për transferimin e dosjes (për rinovim lejedrejtimi për ndryshim vendbanimi)                              | 1 janar 2020 |
| 37. | Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor | Aplikim për rinovim Dëshmie të Aftësisë Profesionale (DAP) për mësues teorie                                      | 1 janar 2020 |
| 38. | Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor | Aplikim për rinovim Dëshmie të Aftësisë Profesionale (DAP) për instruktor praktike                                | 1 janar 2020 |
| 39. | Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor | Autorizim për rimarrjen e lejedrejtimit pas humbjes totale të pikëve ose të heqjes së saj                         | 1 janar 2020 |
| 40. | Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor | Aplikim për pajisje me leje drejtimi ndërkombëtare                                                                | 1 janar 2020 |
| 41. | Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor | Aplikim për pajisje me Certifikatë të Kompetencës Profesionale (CKP) për herë të parë                             | 1 janar 2020 |



|     |                                                             |                                                                                                          |              |
|-----|-------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------|
| 42. | Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor | Aplikim për pajisje me Dëshmi Aftësie Profesionale (DAP) për instruktor praktike                         | 1 janar 2020 |
| 43. | Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor | Aplikim për pajisje me Dëshmi të Aftësie Profesionale (DAP) mësues teorie                                | 1 janar 2020 |
| 44. | Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor | Konfirmim për gjendjen aktive të mjetit                                                                  | 1 janar 2020 |
| 45. | Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor | Aplikim për pajisje me certifikatë pronësie të mjetit rrugor në rast humbje apo vjedhjeje                | 1 janar 2020 |
| 46. | Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor | Vërtetim për lejen e drejtimit                                                                           | 1 janar 2020 |
| 47. | Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor | Aplikim për pajisje me lejedrejtimi të kategorisë A1, A2, B1 ose B për herë të parë                      | 1 janar 2020 |
| 48. | Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor | Aplikim për pajisje me leje për ushtrimin e aktivitetit për përgatitjen e kandidatëve për drejtues mjeti | 1 janar 2020 |
| 49. | Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor | Aplikim për rinovim Dëshmie Aftësie Profesionale (DAP) për makineri të rënda                             | 1 janar 2020 |
| 50. | Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor | Aplikim për pajisje me Dëshmi të Aftësisë Profesionale (DAP) për makineri të rënda për herë të parë      | 1 janar 2020 |

### VENDIM Nr. 4 datë 20.12.2019

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”. të ndryshuar, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret Shtetëror’”, KDZH-ja, e ngritur me urdhrin nr. 389, datë 20.11.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave, u mbledh me datë 20.12.2019, dhe pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Sektori i ish-Arkivit Qendror të PPSH-së,

#### VENDOSI:

1. Deklasifikimin plotësisht të informacioneve (dosjeve) të klasifikuara “Sekret shtetëror” si më poshtë :

- Fondi 14/APSTR, viti 1986

Dosjet nr. 1, 2, 4, 5, 6, , 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 21, 22, 23, 24, 25, 32, 38,

Faqe|14982

39, 40, 41, 42, 44, 45, 50, 52, 54, 58, 60, 62, 65, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84, 85, 86, 87, 88, 89, 90, 92, 93, 94, 95, 97, 98, 100, 101, 102, 104, 105, 106, 109, 110, 111, 112, 113, 115, 116, 117, 118, 121, 123, 124, 125, 126, 127, 128, 129, 132, 133, 135, 136, 137, 141, 142, 144, 145, 147, 148, 150, 151, 152. Niveli i klasifikimit “Sekret”. 153. Niveli i klasifikimit “T. sekret”. 154, 158, 159, 160, 162, 163, 164, 165, 166, 167, 169, 170, 171, 175, 177, 183, 184, 185, 186, 188, 189, 190, 191, 193, 195, 196, 197, 198, 199, 200, 201, 203, 204, 207, 209, 210, 211, 212, 213, 214, 217 218, 222, 223. Niveli i klasifikimit “Sekret”. 224. Niveli i klasifikimit “T. sekret”. 225. Niveli i klasifikimit “Sekret”. 226. Niveli i klasifikimit “T. sekret”. 230, 231, 234, 235, 236, 237. Niveli i klasifikimit “Sekret”. 238. Niveli i klasifikimit “T. Sekret”. 239, 240, 244, 246, 247, 248, 249, 252, 253. Niveli i klasifikimit “Sekret”. 255, 256, 257, 258. Niveli i klasifikimit “T. sekret”. 259, 260, 261, 262, 263, 264, 265, 266, 271, 273, 276, 278, 280, 283, 285, 289, 290, 291, 293, 295, 301, 307, 309, 310, 313. Niveli i klasifikimit “Sekret”. 317.



Niveli i klasifikimit “T. sekret”. 319, 321, 325, 328, 330, 331, 332, 333, 334, 336, 337, 338, 342, 343, 344, 345, 347, 349, 350, 352, 353, 354, 355, 360, 362, 363, 364, 365, 360, 362, 363, 36, 365, 366, 367, 368, 376, 377, 378, 379. Niveli i klasifikimit “Sekret”. 380. Niveli i klasifikimit “T. sekret”. 381. Niveli i klasifikimit “Sekret”. 382, 383. Niveli i klasifikimit “T. sekret”. 384, 385, 386, 387. Niveli i klasifikimit “Sekret”. 388, 389, 390,. Niveli i klasifikimit “T. sekret”. 393, 395. Niveli i klasifikimit “Sekret”. 396. Niveli i klasifikimit “T. sekret”. 398, 399, 400, 401, 403, 404, 405, 406, 407, 408, 409, 410, 411, 412, 413. Niveli i klasifikimit “Sekret”. 414. Niveli i klasifikimit “T. sekret”. 415, 416. Niveli i klasifikimit “Sekret”. 417. Niveli i klasifikimit “T. sekret”. 418, 419, 420, 421, 422, 423, 424, 425, 426, 427, , 429, 430, 431, 32, 433. Niveli i klasifikimit “Sekret”. 434. Niveli i klasifikimit “T. sekret”. 435, 436, 437, 438, 439, 44, 441, 442, 443, 445, 446, 447, 448, 449, 450, 451, 452, 453, 454, 455, 456, 457, 458, 459, 460, 461, 62, 463, 464, 465, 466, 467, 468, 469, 470, 471, 472, 473, 475, 476, 478, 479, 480, 481, 482, 483, 484, 485, 486, 87, 488, 489, 490, 491, 492, 493, 496, 497, 498, 499, 500, 501, 502, 503, 504, 505, 506, 507, 508, 509, 510, 511, 512, 513, 514, 515, 516, 517. Niveli i klasifikimit “Sekret”. 518. Niveli i klasifikimit “T. sekret”. 808, 809, 816, 819, 820, 821, 830, 832, 833, 834, 836, 841, 850, 851, 852, 854, 860, 861, 863, 864, 865, 870, 871, 874, 878, 879, 880, 881, 883, 884, 885, 886, 888, 894, 901, 902, 903, 904, 905, 907, 911, 913, 920, 922, 923,

924, 927, 932, 933, 938, 941, 945, 946, 947, 950, 951, 956, 958, 960, 966, 970, 974, 977, 978, 979, 981, 983, 984, 985, 987, 992, 995, 1001, 1011, 1018, 1019, 1036, 1042, 1043, 1048, 1050, 105, 1059, 1062, 1070, 1072, 1082, 1083, 1084, 1085, 1086, 1087, 1088, 1089, 1092, 1101, 1105, 1109, 1112, 1119, 1121, 1122, 1123, 1126, 1133, 1137, 1142, 1143, 1144, 1147, 1148, 1150, 1154, 1162. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Dosjet deklasifikohen plotësisht, sepse kanë humbur vlerën dhe qëllimin për të cilin janë klasifikuar, siç përcaktohet në nenin 4, pika “b”, e VKM-së nr. 662, datë 15.11 .2017.

2. Përjashtimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” nga deklasifikimi si më poshtë:  
- Fondi 14/APSTR, viti 1986

Dosjet nr. 27, 43, 63, 66, 67, 68, 70, 130, 131, 138, 143, 168, 173, 174, 179, 180, 181, 221, 243, 267, 268, 269, 270, 277, 286, 287, 288. Niveli i klasifikimit “Sekret 292. Niveli I klasifikimit “T. sekret”. 296, 297, 300, 302. Niveli i klasifikimit “Sekret”. 304. Niveli i klasifikimit “T. sekret” 306, 311, 312, 315, 322, 323, 324.

3. Ngarkohet sekretari i KDZH-së për zbatimin e këtij vendimi.

4. Një kopje e bibliografisë t’i dërgohet DSIK-së, si dhe për botim në Fletoren Zyrtare.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Ardit Bido**

|  |                 |
|--|-----------------|
|  | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 1176 lekë